ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 11 DHJETOR 2021. NUMËR 160 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Veç jehonës nëpër vendet ku u ekspozuan, krijimtaria e autorëve europianë ka një vlerë të veçantë për historinë dhe kulturën shqiptare. Tablotë më të hershme të piktorëve britanikë, francezë, austriakë, gjermanë, italianë apo nga kombësi të tjera u realizuan pikërisht në kohën kur nga piktorët vendas mungonin imazhe nga jeta e përditshme.

RIZBULIMI I SHQIPËRISË *nga* ARTISTËT EUROPIANË

Nga Ferid HUDHRI

ARTI AUTONOM I FJALËS SË ZEF ZORBËS

Nga Joachim Lanksch (fq. 8)

Në kujtim të shkrimtarit Dhimo Tarusha

SHKRIMTAR VËNDËS

Nga Mihal Disho (fq. 8)



PJETËR BOGDANI, PRIJËS SHPIRTËROR, SHKRIMTAR DHE STRATEG POLITIK

Nga Ndue Ukaj (fq. 6)

Periudha pas vdekjes së Gjergj Kastriotit deri te fillimet e Rilindjes Kombëtare, në historinë tonë kulturore e politike është mjaft e varfër. Tokat e Arbrit u plandosën nën robëri të rëndë, gjendja e popullit ishte e mjerueshme dhe zhvillohej një proces i dhunshëm i transformimit...

SHËNIME PËR LIBRAT

PËRSE VAZHDON TË RIBOTOHET ROMANI "TË ÇMENDUR NË PARAJSË" I VIRION GRAÇIT?

Nga Ermira Alija (fq. 19)

Romani "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin" i Besnik Mustafajt

JERMI I TIRANËS SË VITIT 2020 NËN TIRANINË E PANDEMISË

Nga Granit Zela (fq. 9)

Vëllimi poetik "Një e tretë dashuria"

UNIVERSI DHE ZËRI DASHUROR NË LIRIKËN E PREÇ ZOGAJT

Nga Emi Krosi (fq. 10)

Përmbledhja "Në botën magjike të Henrit" e Anila Mullahit (Elezi)

LETËRSI PËR FËMIJË NGA NJË STUDIUESE E NJOHUR

Nga Eni Myrtollari (fq. 13)

ANTON PASHKU DHE NGJYRESAT SHKRIMORE TË TREGIMIT

Nga Behar Gjoka (fq. 5)

FANTAZMA E ÇMIMIT NOBEL

Nga G.G. Márquez (fq. 18)

Psikika e ringjallur nga puthja e Kupidit

Nga Dr. Bledar Kurti

(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Ivan Bunin (fq. 20)
Ida. Smerald. (dy tregime)

Flurans Ilia (fq. 17)
Tjetri (tregim)

Enver S. Morina (fq. 16)
Njollat e hirit pas shiut

Mehmet Elezi (fq. 13)
Thesi (tregim)

Shazim Mehmeti (fq. 15)
Vera e fluturave (roman në proces)

Shqiponja Axhami (fq. 14)
Ne shpiknin përralla (poezi)

KADAREJA DHE ROMANI MODERN SHQIPTAR

Nga Pof. Dr. Klara Kodra (fq. 12)

Duke lexuar Zija Çelën

SHKRIMTAR I ABSOLUTES SË BRENDSHME

Nga Oana Anca Mihaela Glasu (fq. 11)

RIZBULIMI I SHQIPËRISË *nga* ARTISTËT EUROPIANË

Nga Ferid Hudhri

Ndryshe prej përshkrimeve të udhëtarëve, rrëfimeve nëpër libra, revista e botime të tjera, si dhe relacioneve për kancelaritë e kohës, shqiptarët e shekujve XVII-XX u paraqitën në pamjen e tyre më reale, më të plotë dhe më të bukur në veprat e piktorëve europianë. Përmes vizatimeve, gravurave, litografive, akuareleve apo tablove me ngjyra vaji, artistë nga vende të ndryshme sollën para syve të gjithë botës imazhe të realizuara direkt në mjediset ku jetonin shqiptarët.

Krahas artistëve që erdhën posaçërisht për të pikturuar, të tjerë që nuk mundën të vinin fizikisht, i huajtën kostume shqiptare nga kolegët, u mbyllën nëpër studio dhe me përkushtimin dhe intuitën e krijuesve të vërtetë realizuan disa nga tablotë më të bukura. Bashkë me veprat që u ekspozuan në sallonet e Parisit, të Londrës dhe qyteteve të tjera europiane, në të njëjtën periudhë, imazhet nga bota shqiptare u riprodhuan edhe në litografi, në katalogë dhe në albume arti. Që nga ajo kohë disa prej krijimeve me temë shqiptare u vendosën nëpër galeri, muze dhe koleksione nga më të njohurit nëpër botë.

Veç jehonës nëpër vendet ku u ekspozuan, krijimtaria e autorëve europianë ka një vlerë të veçantë për historinë dhe kulturën shqiptare. Tablotë më të hershme të piktorëve britanikë, francezë, austriakë, gjermanë, italianë apo nga kombësi të tjera u realizuan pikërisht në kohën kur nga piktorët vendas mungonin imazhe nga jeta e përditshme.

Ishte koha kur shqiptarët për disa shekuj mbetën nën pushtetin e Perandorive të Lindjes, ku krijimtaria artistike, e përqendruar kryesisht në pikturimin e ikonave dhe afreskeve, sipas kanoneve të artit Pasbizantin, apo arabeskave e ornamenteve floreale të stilit oriental, nuk arriti të pasqyrojë jetën reale të njerëzve.

Të ndodhur në skajin më të largët të Perandorisë Otomane, shqiptarët ndonëse për pak shekuj u ndjen gati të harruar, gjithsesi, ata patën fatin të ishin pranë portave të Perëndimit, rrjedhimisht më pranë studiove të piktorëve dhe skulptorëve europianë, ku aspekte të jetës së përditshme përjetësoheshin në tablo, statuja e monumente, si dhe në gjini të tjera të artit. Për fatin e mirë të saj, hapësira shqiptare u vizitua më shpejt dhe më shpesh nga piktorët dhe skulptorët europianë, krahasimisht me vendet e tjera më në thellësi të perandorisë. Kështu, boshllëku që ishte krijuar prej disa shekujsh nga mungesa e tablove prej artistëve vendas u plotësua prej veprave e autorëve të ndryshëm që erdhën nga Europa.

Nga krijimet më të hershme klasifikohen hartat e venecianëve gjatë shekullit XV. Siç dihet në ato skicime të thjeshta nuk paraqitej vetëm vija bregdetare apo kufizimet e qyteteve me emrat e lumenjve dhe liqeneve, por vizatoheshin kështjella, kisha, shtëpi, kodra me pemë, anije në breg të detit si edhe objekte të tjera. Duke dhënë një përfytyrim real figurativ, ato mund të përcaktohen si imazhe të moçme për trojet e banuara nga shqiptarët gjatë shekullit të zbulimeve dhe udhëtimeve të mëdha gjeografike. Nga ajo periudhë ruhen pamjet e hershme të Durrësit (Epidamno, Durazzo), Butrintit (Buthrōtum), Vlorës (Valona), Shkodrës (Scutari), Kaninës (Canina), si dhe të qyteteve apo krahinave të tjera.

Por korpusi më i madh i krijimeve të artistëve europianë iu kushtua qëndresës shqiptare ndaj perandorisë më të madhe të kohës. Imazhi i Gjergj Kastriotit Skënderbeut (1405-1468) është përjetësuar në qindra vizatime, gravura, litografi, tablo, qeramika, medalione, statuja dhe monumente që ndodhen nëpër muze, kështjella, galeri, sheshe qytetesh apo koleksione të ndryshme publike dhe private. Figurën e Skënderbeut e kanë vizatuar dhe pikturuar disa nga autorët më të shquar të artit europian si Gentile Bellini, Rembrandt Van Rijn, Jorg Breu, Cristofano dell'Altssimo, Jost Amman, Joris Hoefnagel, Aliprando Capriolo, Antonio M. Crespi, Francesco Zucchi, si dhe shumë autorë të tjerë të njohur.

Pas tablosë "Mbrojtja e Shkodrës" nga Paolo Veronese ku paraqiten luftimet për ruajtjen e kështjellës së fundit antiosmane në Shqipëri, duket sikur humbi edhe interesi i artistëve ndaj banorëve që mbetën nën robërinë e pushtuesve. Ndërsa me të larguarit në bregun tjetër të Adriatikut, me arbëreshët ndodhi e kundërta. Artistë italianë dhe kolegë të tyre nga vende të tjera të Europës në kontaktet me shqiptarët e sapo ardhur gjetën motive të reja, të bukura dhe të veçanta për tablotë e tyre. Kur pikturonte në Sicili, artisti francez Jean Houël shkruante se *arbëreshet vishen gjithë madhështi e shkëlqim* dhe se ato *veshje i ruajnë nga atdheu i tyre i lashtë*. Ndërkohë që autorët vendas B. Pinelli, M. Vito, A. Cefaly, S. Gatta, E. Bergler e shumë të tjerë prej kohësh vazhdonin të pikturonin dhe të ekspozonin në Itali dhe nëpër vende të tjera tablo me motive nga jeta e arbëreshëve. Kështu për shumë e shumë vite imazhet e shqiptarëve u paraqitën në artin botëror vetëm përmes pikturimeve të realizuara në Itali. Disa nga portretet me titujt "Albanese", "Albanesen", "Albanaise", "Albanians" që ruhen edhe sot nëpër muze të njohur të botës, i takojnë kësaj periudhe.

Kjo vazhdoi deri nga fillimi i shekullit XVIII kur atdheu i Skënderbeut ende dukej tepër e largët edhe për fqinjët më të afërt europianë. Siç shprehej historiani anglez Edward Gibbon (1737-1794), Shqipëria ishte *një vend që* duket *nga Italia e që* është *i njohur se brendësia e Amerikës*. Por nga mesi i shekullit XVIII, artistët europianë u rikthyen përsëri në trojet shqiptare. Në periudhën midis shekujve XVIII-XIX shënohet koha me krijimtarinë më të pasur. Përmes veprave të shumta që u realizuan gjatë atyre viteve mund të themi se u bë *Rizbulimi i dytë i Shqipërisë* për europianët, të cilët thuajse e kishin harruar që nga koha e qëndresës antiosmane. Në trojet shqiptare zbritën edhe autorë të shquar të romantizmit europian. George Byron, i pikturuar me rroba shqiptare nga Thomas Philips dhe nga disa artistë të tjerë, u bë frymëzuesi i temës shqiptare në artin europian. Eugène Delacroix, Alexandre Colin, Richard Woodville ishin ndër të parët artistë që u nxitën direkt nga vargjet këtij poeti kushtuar shqiptarëve.

Albert Kretschmer, *Dasma shqiptare*, akuarel i vitit 1906

Artistë të tjerë europianë i pikturuan shqiptarët me veshjet e tyre karakteristike kudo që i takuan, gjatë udhëtimeve nëpër të gjitha vendet e perandorisë otomane. Egjipti i shekullit XIX për disa vite rresht dukej si një studio arti në natyrë, për pikturimin e tipave burrërorë me fustanellën e gjatë dhe jelekët e qëndisur me ar. Nën ndikimin e orientalistit të njohur Léon Gérôme, shqiptarët e atjeshëm u bënë po aq të pranishëm edhe në tablotë e artistëve Antoine Montfort, Charles Bargue, Joseph Benwell, Etienne Billet, Alexandre Bida, Arthur Bridgman, Albert Franke dhe autorëve të tjerë.

Shqiptarët me veshje tradicionale janë pikturuar edhe nëpër shumë vende të ndryshme të Lindjes, si në Turqi nga piktorët Van Mour, Alexandre Decamps, Thomas Allom, Etienne Vernet, Thomas Allom, Amedeo Preziosi, Charles Parsons, në Damask nga Charles-Théodore Frère në Maltë nga Charles Brockdorff në Delhi nga Louis Noe, në Rumani nga Costantin Lecca dhe Károly Szathnáry, në Venedik nga Mikhail Scotti, në Trieste nga Francesco Beda, si edhe nëpër vende të tjera të Mesdheut dhe të Ballkanit nga Theodor Valerio, Jaroslav Cermak, Louis Papety, Joseph Cartwright dhe artistë të tjerë.

Por numrin më të madh e përbëjnë tablotë që u krijuan për shqiptarët në trojet helene. Shkrimtari dhe eseisti francez Jacques Lacarrière, një nga njohësit më të mirë të historisë greke, kur shkruan se *në tablotë me temë nga Greqia gjenden edhe figura shqiptarësh, që dallohen nga veshjet karakteristike* (Tsigakou, F.: *La Grèce retrouvée*, f. 10, Paris, 1984), ka parasysh jo vetëm pikturat e shumta të artistit gjerman Peter von Hess, por dhe shumë e shumë vepra të tjera nga Thomas Hope, Edward Doduell, Carl Hallerstein, Apollodore Callet, Francesco Hayes, Ludovico Lipparini, Charles Gleyre etj, ku shqiptarët janë gjithnjë të pranishëm.

Shumë vite më vonë, gjatë luftrave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore nëpër trojet shqiptare erdhën edhe mjaft artistë nga vendet ndërluftuese. Kjo dëshmohet me veprat shumta që ruhen nga ajo periudhë. Në vitin 1918 u hap në Shkodër ekspozita me portrete dhe peizazhe të krijuara prej piktorëve austro-hungarezë Armin Horovitz, Pravotinski dhe László Beszédes, që është

e para veprimtari e këtij lloji në trojet shqiptare.

Qetësia dhe stabiliteti i përkohshëm i krijuar në vitet e mbretërisë solli më shumë artistë nga Europa. Pas ekspozitave të para të hapura në Shkodër (1918) dhe në Korçë (1932), kryeqyteti u kthye në qendrën artistëve të huaj që vinin për të pikturuar dhe ekspozuar në trojet shqiptare. Në Tiranën e vitit 1937 u organizua konkursi i parë ndërkombëtar për monumentin e Skënderbeut, ku morën pjesë disa artistë të njohur nga Europa. Çmimin e parë e mori skulptori kroat Antun Agustinčić. Gjatë atyre viteve u realizuan edhe disa vepra të tjera monumentale në skulpturë, në mozaik dhe në relieve për institucionet më të rëndësishme të vendit, prej artistëve italianë Alfredo Biagini, Giulio Rosso dhe Gianni Remuzzi.

Edhe gjatë viteve të Lufts së Dytë Botërore nuk u ndërpre krijimtaria e artistëve të huaj. Vetëm në dy nga veprimtaritë më të rëndësishme, për konkursin «Çmimi Shqipëria» (Premio Albanese, 1939) dhe për pavionin shqiptar në Panairin Fiera dell' Levante (Bari, 1939) u realizuan qindra peizazhe, portrete, tablo, skulptura, relieve e vepra të tjera me temë shqiptare. Prej artistëve italianë u hapën gjithashtu disa ekspozita vetjake me peizazhe e portrete në disa qytete të Italisë si dhe në Tiranë. Në vitin 1940 u ngrit monumenti i parë i Skënderbeut në sheshin Albania, pranë Koloseut në Romë.

Pas vitit 1945 Shqipëria i shkëputi të gjitha lidhjet me artistët nga vendet e perëndimit. Dyert ishin të hapura vetëm për piktorët nga Bashkimi Sovjetik dhe shtetet e tjera të bllokut komunist të Lindjes. Gjatë kësaj periudhe u organizuan më shumë ekspozita dhe veprimtari të tjera të përbashkëta midis artistëve. Në shtator të vitit 1955 në portin e Durrësit zbritën 19 piktorë dhe skulptorë nga Polonia. Pas pikturimeve nëpër krahina të ndryshme të vendit, në tetor të po atij viti artistët polakë hapën në Tiranë ekspozitën me 100 peizazhe, portrete, tablo, etyde, vizatime me laps dhe tush. Por ekspozita më e madhe me vepra arti kushtuar Shqipërisë u hap në Moskë në vitin 1959 nga piktorët Evgeni Zaicev, Juri Reiner dhe Grigor Khandjan. Aty u ekspozuan 215 piktura. Kjo është gjithashtu ekspozita më e madhe me temë shqiptare që është organizuar deri më sot nga artistët e huaj.

Gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar, kur Shqipëria u rihap përsëri me të gjitha shtetet, rifilloi ardhja e artistëve nga vende të ndryshme. Në Tiranë dhe qytete të tjera u organizuan disa veprimtari të përbashkëta me artistët vendas, krahas konkurseve ndërkombëtare apo ekspozitave vetjake nga artistët e huaj. Dy dukuritë më të rëndësishme të këtyre viteve, Bienalja e Akuarelit dhe Muralet (pikturimet në fasadat e pallateve), kanë shënuar pjesëmarrjen më të madhe të artistëve të huaj në trojet shqiptare.

Në çdo etapë të historisë së trajtimit të temës shqiptare, me gjithë veçoritë karakteristike për llojin e punimeve apo stilin artistik, i përbashkët dhe i dukshëm është përkushtimi i artistëve ndaj bukurive së natyrës. Të shumtë janë peizazhet e realizuara në çdo periudhë, po ashtu i shumëllojtë është edhe këndvështrimi artistik i autorëve. Admirimin e tyre për natyrën e Shqipërisë artistët kanë shprehur edhe përmes ditarëve, letrave apo shënimeve të ndryshme.

Vlerësimet se Shqipëria "është një vend i mrekullueshëm për artistët, se kostumet shqiptare *janë shumë piktoreske*"[1] se "*vështirë* mund të gjendet një vend, vetëm nëntë ditë larg nga Parisi që të jetë kaq piktoresk sa Shqipëria, se për artistët është një vend mbi gjithë të tjerët»[2] apo "*se vështirë të gjesh skena më madhështore dhe më hijerënda se sa këto të këtij vendi të famshëm*»[3], tërhoqën më shumë vëmendjen e artistëve europianë gjatë shekujve XVIII-XIX për të pikturuar nëpër trojet shqiptare. Bukuritë e natyrës janë evidentuar edhe në vitet më të vështira të luftës. Poeti çek Stanislav Neumann në ditët e Luftës së Parë Botërore, kur

Antal Ligeti, *Grua shqiptare me veshje të kuqe*, 1845

pikturonte akuarelet e tij nga rrethinat e Elbasanit, i shkruante së shoqes «*në se do të mundesh* të shkosh në Shqipëri do të shohësh bukuri të mahnitshme të natyrës»[4]. I njëjti vlerësim shprehet edhe shumë vite më pas, kur piktorja japoneze Kimiko Amabe shkruan nga Tokio "*se gjatë qëndrimit në Shqipëri ditët ishin plot emocione nga peizazhet e atij vendi të bukur, ndoshta më i bukuri në botë*».[5]

Krahas tablove më të bukura si «Mali i Tomorit» dhe «Bregdeti i Shqipërisë» (nga Edward Lear), në historikun e krijimeve artistike me temë shqiptare cikli i peizazheve kushtuar Maleve Acrokeraune vlerësohet si më i madhi në numër, më i larmishëm në teknikat piktorike dhe është realizuar nga disa prej autorëve të njohur të artit. Nga pikturimi i atyre maleve të lartë nis edhe kontakti i parë i shumë artistëve europianë që erdhën me për të rizbuluar botën shqiptare.

Le të shohim konkretisht kur dhe si u realizuan veprat nga filloi rizbulimi i Shqipërisë.

Vargmali i bregdetit të Jugut, prej shumë e shumë vitesh ka qenë peizazhi që i tërhiqte udhëtarët e huaj, kur kalonin pranë bregut perëndimor të trojeve shqiptare. Nga ai këndvështrim u realizuan edhe tablotë e para që e paraqitën Shqipërinë nëpër ekspozitat apo albumet e artit, në disa prej kryeqyteteve europiane midis shekujve XVIII-XIX. Gjatë periudhës së pushtimit otoman, në pamundësi për t'u futur në brendësi të vendit, imazhin e bukur e madhështor të maleve Akrokeraune (apo maleve të Vetëtimës, siç quhen nga vendasit), artistët e huaj e pikturuan nga bordet e anijeve apo nga ishulli i Korfuzit. Edhe në kohët e mëvonshme, gjatë viteve të komunizmit, kur Shqipëria u vetëmbyll, përsëri vetëm nga ai këndvështrim u realizuan peizazhet me malet e larta të Jugut. Siç duket, andej nga deti është këndi më i përshtatshëm dhe më i bukur për pikturimin e tyre.

Faqja perëndimore e malit të Çikës, që ngrihet mbi fshatrat Palasë, Dhërmi e Vuno, e çarë nga përrenj të thatë e humnera të thella, me pak gjelbërim në pjesën e ulët, duket më madhështore kur e vështron nga larg, në distancë prej bregut të detit. Nga ky këndvështrim janë më të dallueshme edhe vetëtimat që shkrepin mbi kryet e majave të larta, në ditët me shi. Sipërfaqja horizontale e detit atje duket si një bazament i sheshtë, prej nga ngrihet si një amfiteatër gjigant, deri në lartësinë 2040 m, vargmali shkëmbor i Jugut shqiptar. Këto janë Malet e Vetëtimës apo Malet Akrokeraune, siç njihen nga të huajt.

Andej nga vështrohet pamja e tyre më magjepsëse, po andej janë bërë edhe përshkrimet më të hershme për këtë monument të bukur të natyrës. Nga ana e detit i filluan përshkrimet e para edhe gjeografët e periudhës antike, Straboni e Ptolemeu, ndërkohë që madhështia e Maleve Akrokeraune u bë e pranishme në krijimtarinë e disa prej autorëve më të shquar të letrave botërore, si te Homeri, Horaci, Eskili, Virgjili, Klaudiani dhe Bajroni, duke i cilësuar si "*male vigane që kufizojnë thellësitë e qeta*" (Klaudian, epigrama LXXXV), apo si male "*madhështore* [që] *lartësohen para syve/ si amfiteatër vullkanik natyre*" (Bajron, Çajld *Harold*, strofa 51) etj. Virgjili, duke i përmendur te *Eneida* (pjesa e III), shkruan "*Pranë shkëmbinjve të Keraunias vazhduam udhëtimin tonë/ Rruga më e shkurtër për në bregdetin italian...*" (sipas përkthimeve nga R. Kadia). Shumë vite më pas, nga përcaktimi "Kopsht shkëmbor", që u bëri këtyre maleve anglezi Paul Edmonds, mori titullin eseja e njohur e Konicës për Shqipërinë. Pasi

Edward Lear, *Duke vështruar Malet e Shqipërisë nga Korfuzi*, akuarel, 1852

Daniel Sweeney, *Shqiptarja*, akuarel i vitit 1932

përshkruan shtrirjen e maleve Akrokeraune vetë Konica ka nënvizuar se "*madhështia e tyre i ka bërë përshtypje të madhe natyralistit romak, Plinit Plak, sa dikur në shkrimet e tij ai thotë për to: "Ato janë të harkuara si një teatër", ndërsa në ditët tona,-* vazhdon Konica, *madhështia e tyre rripa-rripa i ka dhënë Shqipërisë përcaktimin e goditur "Kopsht shkëmbor i Europës Juglindore".*[6]

Gjenden edhe shumë përshkrime apo citime të tjera për malet Akrokeraune, ndërkohë që përjetësimet më të bukura për to janë bërë në art. Imazhet më të hershme piktorike që njihen deri tani u takojnë viteve të para të shekullit XIX. Akuareli "Malet shqiptare nga Korfuzi" u realizua prej piktorit William Haygarth në vitin 1810. Origjinali ndodhet në bibliotekën Genadio, në Athinë. Ndërsa në Muzeun Britanik në Londër ruhen dy vepra për malet Acroceraune; një vizatim dhe një akuarel nga piktori, arkeologu dhe udhëtari i njohur Sir William Gell. Artisti tjetër britanik H. W. Williams, gjatë udhëtimit nga Italia për në Greqi, në vitin 1819 i vëzhgoi që nga larg dhe i befasuar prej pamjes së tyre, vizatimin e parë e bëri që nga bordi i anijes. Ndonëse në plan të parë, si dhe në pjesën më të madhe të gravurës, paraqiten marinarë dhe objekte të ndryshme në mjediset e kuvertës, titulli i veprës ka ardhur nga malet e larta të bregut shqiptar, të vizatuara në sfondin e tablosë. Më pas, piktori që kishte ardhur për të pikturuar pamje nga Italia dhe Greqia, u afrua me anije pranë brigjeve të Vlorës e Himarës. Prej andej realizoi dhjetëra vizatime, mbi bazën e të cilave u dha formë tri gravurave të tjera që i titulloi: *Panoramë malore në Shqipëri, Gjiri i Vlorës (Gulf of Avlona), Bregdeti i Shqipërisë së Jugut.* Një vit më pas, kur u kthye në vendlindje, Williams, bashkë me librin *Udhëtime në Itali, Greqi dhe ishujt jonianë* (*Travels in Italy, Greece and the Ionian Islands, Edinburg,* 1820), botoi edhe gravurat e frymëzuara nga malet Akrokeraune. Pas nëntë vjetësh, më 1829, Williams i botoi përsëri në përmasa më të mëdha, ku ndihet më qartë tashmë mjeshtëria e piktorit në shëmbëllimin e disa peizazheve epike, ku deti i dallgëzuar që përplaset mbi shkëmbinjtë pranë maleve të larta me shkreptimat e rrufeve mbi krye, të krijon më shumë madhështi.

Pak vite më pas u realizua tabloja më e bukur në ngjyra vaji, që është krijuar deri tani me këtë motiv. Aty jepet më qartë ideja e maleve në formën e një amfiteatri natyror, siç është quajtur nga disa udhëtarë. Autori i kësaj pikture është anglezi Edward Lear. Para se të vinte në Shqipëri, për të pikturuar *malet e larta që kufizojnë thellësitë e qeta*, artisti anglez ishte njohur me madhështinë e tyre. Pas gravurave të Williams-it, të cilat i kishte parë në Londër, malet Akrokeraune i kishte vështruar edhe gjatë kohës kur pikturonte në Korfuz. Madje, që andej ai kishte realizuar edhe disa nga vizatimet, akuarelet e litografitë e para me atë motiv. Në ditarët e shkruar gjatë udhëtimit nëpër trojet shqiptare (*Journals of a Landscape Painter in Albania & c.* London, 1851), Lear tregon interesimin e veçantë dhe dëshirën për të arritur sa më shpejt pranë

Pompeo Marchesi, *Monumenti Tarketa*, 1835, Duomo, Milano

tyre. Në faqet e para të ditarit, sapo niset nga Durrësi, ai shkruan: *...të shkoj drejt jugut duke i rënë nga bregu, do të futem* në Vlorë dhe prej andej në *Akrokeraunia*. Ndërkohë, gjatë gjithë rrugës mblidhte të dhëna, bisedonte me të zotët e shtëpisë ku bujti natën e parë në Vlorë dhe në pasditen e 21 tetorit, kur arriti pranë maleve të larta, që i kishte parë nga Korfuzi, nuk u përmbajt nga emocioni dhe filloi të shkruante: *...Çfarë bukurie! Në skajin e ngushtë të gjirit hapet një pamje e mrekullueshme, me detin si liqen i palëvizshëm dhe i errët nën murin e lartë të maleve të territorit të Himarës. Tragjasi, që mund të quhet edhe porta për në malet Akrokeraune, ngrihet mbi një lartësi mu përpara nesh, kurse mbi gjithë peizazhin mbizotëron maja madhështore e Çikës, e mbuluar nga dëbora. Maja më e lartë e Çikës duket qartë nga Korfuzi, kurse në Jug të saj shtrihen fshatrat e Himarës. Nuk më kujtohet të kem parë shpesh pamje më sublime e më të veçuar nga bota se kjo.* Pasi tregon për skicat që bëri nga ajo pikë, duke i përshkruar *pamjet më mbresëlënëse të një natyre të egër që nuk e kishte parë që kur ishte në Kalabri*, Lear shpërthen duke iu drejtuar kolegëve të tij artistë: *Shkoni o piktorë të vizitoni malet Akrokeraune! Po nuk shkuat atje, nuk keni për të mësuar për shkallët më madhështore të piktoreskes së egër, por klasike, qoftë ilire apo epirote, qofshin njerëz apo male; por shkoni, ama, me një udhërrëfyes të mirë... Malet Akrokeraune janë toka të pashkelura nga këmba e udhëtarit dhe mund të mos jenë fort të përshtatshme për një turist të vetmuar* (f. 121,157, 160, sipas përkthimit të M. Nishkut). Nga gjithë pikturimet nëpër Shqipëri, pas qytetit të Beratit dhe malit të Tomorit, imazhet e maleve Akrokeraune janë më të pranishme midis vizatimeve dhe akuareleve të Lear-it.

Pesë vjet më pas, më 1853, drejt *maleve rripa-rripa të Jugut shqiptar*, u nis për t'i pikturuar edhe një autor tjetër britanik. Ndërkohë që i afrohej Korfuzit, piktorit Henry Cook i mbetën sytë nga malet në bregun e Shqipërisë dhe duke shprehur admirim për to, i quajti *male të bukura dhe më interesantet që ka parë.*[7] Pasi i pikturoi në distancë, nga ishulli grek, Cook iu afrua me anije bregut shqiptar dhe realizoi disa litografi me pamjen e maleve. Në të njëjtën kohë ai qëndroi edhe në Butrint, ku krijoi litografinë e tij më të bukur.

Nga kërkimet e deritanishme, këta janë pesë nga piktorët më të hershëm që pikturuan malet e larta të Jugut. Artistë të tjerë që udhëtuan në këtë periudhë, si C. Cockerell, J. Cartwright, L. Dupre, si dhe P. Beresford, ndonëse kaluan dhe pikturuan deri në Butrint dhe krahina të tjera përreth, nuk krijuan ndonjë vepër për malet Akrokeraune. Ndoshta për arsyen se në tokën shqiptare ata u futën përmes Greqisë, pa kaluar nga bregdeti i Jugut, andej nga duket pamja e tyre madhështore.

Rreth viteve 1884-1885 u realizua një peizazh i bregdetit të Jugut edhe nga mbretëresha Aleksandra, bashkëshorte e mbretit Edward VII, mbret i Britanisë së Madhe. Kjo tablo, e pikturuar gjatë një udhëtimi me jahtin mbretëror pranë bregut shqiptar, ruhet në Koleksionin Mbretëror të Anglisë (Royal Collection Trust, London). Në atë koleksion të pasur ruhet një nga peizazhet më të bukura me këtë temë nga piktori i njohur Carl Ross. Tabloja e këtij artisti gjerman është pikturuar nga ishulli i Korfuzit.

Thuajse të gjitha pikturat e tjera të artistëve të huaj që njihen deri tani, janë realizuar gjatë udhëtimit pranë brigjeve shqiptare apo nga Korfuzi. Madje, edhe piktori i njohur John Frederick Lewis, për të cilin është shkruar se *ka pikturuar edhe në brendësi të trojeve shqiptare,* malet Akrokeraune i pikturoi nga Korfuzi, në vitin 1840 (disa vjet përpara krijimeve të njohura të E. Lear-it dhe H. Cook-ut). Në arkivin e muzeut *Viktoria dhe Albert* në Londër, krahas akuarelit nga Butrinti prej piktorit H. Sandham, ruhet edhe një peizazh nga Korfuzi, ku, siç shihet në tablo dhe siç përshkruhet në skedën e veçantë të kësaj vepre, *janë pikturuar malet shqiptare që duken në horizont (Fondi: Sandham, dosja 61,* Victoria & Albert Museum, London).

Nga i njëjti këndvështrim janë realizuar edhe tablotë e artistëve Karl Krazeisen (1827), William Linton (1830), Otto Wagner (1831), Eugène Peytier (1831), William Page (1832), Clarkson Stanfield (1832), Edward Finden (1832), G. F. Sargent (1832), Peter William Hamilton (1834), Thomas Cromek (1934), Jean Pourvoyer (1835), Joseph Benetly (1839), Orrin Smith (1841), Pierre E. Grandsire (1878), Joseph Schranz (1877), Lordi Windsor (1882), Ernest Edward Briggs (1909), Michael Zeno Diemer (1929), James Tristram Ellis, Tuxen Lauritis, Patrik Leonard (1985), Valerio Adami (1990). Kështjella në Korfuz, me malet shqiptare në sfond, është motivi i disa veprave të reja nga artistët e ditëve tona, si të anglezëve Anne Durham (1993), William Serridge (2003), Sara Williams (2004), piktores polake Anna Witkowska (2005), që banon në Korfuz dhe artistit britanik Julian Baley (2012).

Ndërkohë që artistë nga bota vinin dhe vazhdojnë të vijnë në tokën greke për të pikturuar malet shqiptare, do të ishte e pamundur dhe e mangët që vetë piktorët grekë të mos kenë qenë të frymëzuar prej *maleve të bukura dhe interesante* që shihen vazhdimisht nga ishulli i tyre. Nga kërkimet e deritanishme, Agelos Giallians ka realizuar një nga imazhet më të veçanta që është krijuar për ato male. I ka pikturuar në çastin e perëndimit të diellit, kur rrezet e fundi, me ngjyra të praruara midis së verdhës dhe portokallisë, u japin këtyre maleve madhështore një ndriçim të veçantë që krijon përfytyrimin e flakëve të ndezura që duken sikur ngrihen nga deti.

Kohët e fundit, me rritjen e teknologjisë digjitale, kur fotografimet në distancë arrihen me cilësi të lartë teknike, janë realizuar shumë foto të bukura artistike, ku malet Akrokeraune, të vështruara nga Korfuzi, shfaqen si një mrekulli e rrallë natyrore. Nën efektin e dritës që merr nuanca të ndryshme nga refleksi i detit, si dhe nga ndriçimi i diellit mbi malet e larta, apo mjegulla e mëngjesit, që ndan sipërfaqen e ujit nga masa shkëmbore, krijohen imazhe nga më të larmishmet dhe shumë tërheqëse. Stephen Cotterell dhe Paul Cohan janë dy nga fotografët e ditëve të sotme, të cilët kanë realizuar disa nga fotot më të bukura të atyre maleve.

Nga ndjesia që përftohet kur sheh pikturimet dhe fotografimet e mësipërme, të duket sikur shprehja e njohur *madhështia e një mali të lartë kuptohet më mirë kur e sheh nga larg,* është krijuar pasi janë soditur veprat e artit që paraqesin madhështinë e maleve Akrokeraune, të pikturuara nga largësia e bregdetit, apo ishulli i Korfuzit. Për banorët vendës, pikturat dhe fotot që përmendëm sjellin imazhet më magjepsëse që ata, për fat të keq, nuk kanë mundur t'i kundrojnë në përmasën e tyre të madhërishme kur kanë kaluar poshtë apo pranë dhe jo përtej e përballë tyre. Ndoshta ky është edhe shpjegimi më i saktë për mungesën e deritanishme të tablove me këtë motiv nga artistët shqiptarë, të cilët banojnë dhe pikturojnë në brendësi apo nën hijen e maleve Akrokeraune.

---

1. Best, J.: *Excursions in Albania*, f. 200, London, 1842.
2. Mayhew, A.: *In Albania with the Gegs*, Scribner's Monthly, vol. XXI, f. 377, New York, 1881.
3. Lear, E.: *Journals of a Landscape Painter in Albania & c.*, f. 88, London, 1851.
4. *Intervistë me gruan e S. Nojmanit*, gazeta *Drita*, 30 prill, f. 3, Tiranë, 1961.
5. Amabe, K.: *Shqipëria, vendlindja ime e dytë*, gazeta *Drita*, Tiranë, 1 dhjetor 1985.
6. Konica, F.: *Veprat*, vëll. 2, f. 386, Botimet Dudaj,Tiranë, 1993.
7. Cook, H.: *Ionian Islands, Greece and Constantinople*, f. 4-5, London, 1853.

ANTON PASHKU
dhe ngjyresat shkrimore të tregimit

Nga Behar Gjoka

Në kushtet e shkrimit dhe realizmit të prozës letrare, si shenjëzim gjuhësor dhe estetik, që veçmas përçon tregimi fantastik, në shumicën e teksteve shpalon një situatë vetjake, të parashtrimeve artistike. Shkrimtari, i sprovave kërkimore të shprehësisë letrare, pikërisht në këtë fakturë ligjërimi, gjendet në rrezikun serioz të lëvrimit të prozës, kryesisht në hullinë e shpalimit modern. Me krijimtarinë e gjerë letrare, në kuptimin e zhanreve të prozës, që krahas tregimit fantastik, për të rritur dhe fëmijë, ku tek tipi i prozës për fëmijë, krahas tregimit ndeshim edhe skicën letrare, i shkrimit të dramatikës moderne, njëherit autor i romanit OH, ndërkaq që evidentohet se gjithë tekstet e autorit së bashku zbulojnë tiparet e shkrimit letrar, të ngjyresave të mirëfillta moderne. Me këto shenja, të përveçme shkrimore, ka krijuar një udhë të vetën të shqiptimit letrar, në hullinë estetike, ndonëse ndikimi i teksturës së autorit, së paku nisur nga moria e teksteve, si dhe nga qasjet studimore, lidhet më tepër me shkrimin e prozës së shkurtër, gjë që buron nga thelbi fantastik i saj, mirëfilli i një tipologjie moderne, madje tepër të rrokshme. Megjithatë, dija letrare, në lidhje me kahjet e lavrimit modern, sjellë një përfundim të pazakontë:

Modernizmi buron si reaksion ndaj utilitarizmit pozitivist dhe si vazhdimësi e romanticizmit të vonuar.[1]

Pra, modernizmi në thelbin e vet, si frymë dhe tekst, pavarësisht zhvillimit në kohë dhe hapësirë, është një formë e shprehjes intelektuale me nuanca të rrokshme të romanticizmit dhe natyralizmit, gjë që tregon se bart në hapësirën e teksteve ëndrrën dhe zhgjëndrrën, me gjasë një rebys të dyzuar, pra vetë botën ideale të qenies, e cila përthyhet në hapësirën e teksteve të tregimeve. Përgjithësisht, kjo tipologji shkrimore, është në kërkim dhe shqiptim të risive, mbi të gjitha të rrugëve të përftimit të imagjinatës dhe imagjinares, e cila ndërkaq mundëson sendërtimin e një bote moderne dhe fantastike, në brendi dhe formë, në botëperceptim dhe figurimin unik. Emërtimi si tregime fantastike, i kryer me vetëdije estetike, pohuar nga vetë autorit qysh në krye të herës, realizuar në tekste, dëshmon praninë e disa elementeve, të ngjizura në shpalimin letrar, në prozën e shkurtër, nga ana e Pashkut:

Së pari: Ky mjeshtër i lëvrimit të prozës,[2] sidomos i tregimit, nuk i ka shkëputur marrëdhëniet me paraardhësit e tij në letrat shqipe, si dhe me rrafshet e oralitetit, duke endur kështu një situatë letrare, ku ndërthuren tekstet, paratekstet dhe intertekste, madje duke mundësuar formësimin e poetikës moderne të prozës së shkurtër, me mbizotërim të në topikës së tregimit fantastik. Kjo rrethanë e pranisë estetike, të ndërlidhjes me prozën orale dhe të kultivuar, po ashtu është e dukshme me prozën e shkurtër të Koliqit dhe Kutelit, dy parafytyrat e ngjashme në poetikën rrëfimore të endjes së prozës së ngjyrave fantastike. Ndërlidhënia e përafërtë në tematikë dhe atmosferë, konceptim dhe strukturimin e prozës së shkurtër, vjen si vijim organik i shkrimit letrar, brenda të njëjtës letërsi, pra në vatrën e letërsisë shqipe, pavarësisht kohës dhe hapësirës. Ndërkaq, tregimet fantastike, më tepër shpalohen si rast i veçuar, në konvergimin e varianteve të ndryshme letrare dhe gjuhësore, që ndërkaq e zgjerojnë hapësirën e verifikimit të veprës letrare të Pashkut. Në disa nga tekstet e tregimeve fantastike, gjallojnë bashkarisht, vlerat që bart gegnishtja dhe toskërishtja, po kaq gjuha e njësuar, pra gjuha shqipe me mozaikun e vetë përbamës, në pentagrimin gojor dhe të shkruar.

Së dyti: Përftimi i një rrugine të përveçme, si frymë dhe magji, në kuptimet e shumëfishta të shkrimit letrar. Ritmika e shkrimit, pra si thurje e prozës, në pozicionet rrëfimore, që shpesh fanitet si një muzikë e qartë, me gjithë pentagramin e vetë, sidomos hapësirat e tregimit fantastik, shënon një majë unike në letrat shqipe. Kualiteti shkrimor, mëton se është nga rastet e pakta, që vjen si një kontribut, i cili kurrësesi nuk lidhet me praninë e shkollave dhe shkollëzave shqipe, që më tepër vizatohen nga akademizmi për nevoja didaktike, kryesisht si një hamendësim pa faktologji, se sa përfaqësojnë fakte të dokumentuar nga burimet arkivore. Me tipologjinë e tregimeve fantastike Anton Pashku, ka vitalizuar amën e përrallave, tharmin fantastik, porse duke shkëputur përfundimisht penjtë prej tyre, në poetikën e rrëfimit dhe të skalitjes së personazheve, si dhe duke lënë një vragë të thellë në ligjërimin e shqipes, si një ligjërim letrar i pazakontë.

Së treti: Në shkrimin e tregimit, me natyrë fantastike si lavrim, bie në sy paraqitja me dy variante dhe versione, gjuhësore dhe letrare, aspekt që pothuajse nuk është përmendur e jo më interpretuar në studimet e shqipes, sa i përket kësaj dysie shkrimore, kur ligjëroi në zhanrin e tregimit. Kjo situatë e shkrimit letrar, me dy variante gjuhësore, e cila gjendet në botimet e ndryshme të prozës së autorit, fillimisht në gegnisht, e mandej e shkruar nga vetë autori në gjuhën e njësuar, përbën një moment që kërkon vëmendje dhe interpretime të thelluara, në rrafshet gjuhësore dhe estetike. Kjo rrethanë ndërkaq ka shënuar edhe realizimin e dy versioneve letrare, të cilat tashmë duhet të njihen më në thellësi, si dhe të zbërthehen në vlerat stilistike, që përçojnë secili prej varianteve gjuhësore dhe versioneve letrare. Universi shkrimor i pranishëm, gjuhësor dhe letrar, në realizmin e tregimeve fantastike, që ka endur shkrimtari, përfaqëson hullinë e bashkëlidhjes së varianteve gjuhësore, e cila do të duhet hulumtuar në situatën e plotë, të sendërtimit të saj.

Së katërti: Në realizimin e prozës për fëmijë, ndonëse gati-gati të pacekur nga studimet letrare, me disa tipe dhe lloje letrare, të përcaktuara nga autori, si skica dhe tregime, zgjerohet gama e teksturës së shkrimit letrar prej autorit. Këto tekste të prozës së shkurtër për fëmijë, faktikisht e pasurojnë me tepër pentagramin e zhanreve të lëvruara prej autorit, por njëherit shënojnë një gjurmë të shkrimit me kualitet letrar të kësaj tipologjie shkrimi. Proza për fëmijë, pra e gjithë hapësira tekstologjike, është shkruar në variantin e gegnishtes, që do të thotë se i përkasin periudhës fillimtare të shkrimit letrar të autorit. Mbi të gjitha, proza për fëmijë, vjen e derdhur gjuhësisht në një situim të përveçëm, në hapësirat e teksteve, si një atmosferë befasuese, në rrëfim dhe shprehësi letrare, si dhe në thelbin e vetë, më shumë është vijim i natyrës fantastike, një pasuri e prozëshkrimit, e cila i kapërcen tridhjetë prozat e shkurtra për fëmijë, një pjesë e vyer e trashëgimisë letrare të autorit.



Në prozëshkrimin e shkrimtarit, në hapësirat e romanit OH, si dëshmi e lavrimit modern, ndonëse e përngjyrosur me nota të rrokshme fantastike, sidomos në tregimet fantastike, të një proze të shumëngjyrtë, si dhe të prozës për fëmijë, me ngjyrime të shumëfishta, të natyrës etike dhe estetike, të bashkëlidhjes së ligjërimit të varianteve të gegnishtes dhe të nivelit të njësuar, çka natyrshëm ka promovuar invariantin ose versionin letrar dhe gjuhësor. Në fund të shtjellimit të vlerësisë së prozës së shkrimtarit, merr vlerë zbërthimi i vlerave të shumta stilistikore, që madje na shpie gjer te stili i përveçëm që ka sendërtuar në të gjithë veprën letrare. Fusha e gjerë e stilistikës, hapësira përfaqësuese e saj, pamëdyshje me të dyja anët, pra me stilistikën gjuhësore dhe atë letrare, gjithnjë sipas teorive letrare, të shpie deri te elementi kryesor, që është stili i shkrimtarit, një term të cilin Xhevat Lloshi e formulon kështu:

Stili është veçantia e një tërësie gjuhësore të organizuar në një mënyrë, që ia jep ligjërimit këtë veçanti...[3]

Bazuar në këtë ide, të qasjes teorike mbi vlerat stilistike, që vjen pas një përvoje të gjatë studimore dhe në lamitë e përkthimit të studiuesit Xhevat Lloshi, për atë moment që simbolizon një vepër letrare, pra stilin e autorit, tashmë hetimi i këtyre vlerave, ka një pikë reference, tiparet më të spikatura të krijimtarisë së autorit, gjetjen dhe analizën e këtyre mjeteve që kanë mundësuar hartimin në atë nivel të ngritur artistik të tregimeve fantastike, të romanit OH, si dhe të tragjedive moderne, në këtë formë të shqiptimit letrar.

Shkëputur nga libri Hejza e Pashkut, *në proces botimi*

[1] Lengua Castellana II, Instituto Machado, 2015, faqe 221.

[2] Nga studimet letrare dhe leximet e vazhdueshme, si dhe nga përcaktimet e bëra përqark veprës letrare, Anton Pashku është përcaktuar si njëri prej lëvruesve modern të tregimit fantastik dhe të tipologjisë moderne të romanit OH.

[3] Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Sh. B Albas, Tiranë, 2012, faqe 11.

PJETËR BOGDANI, PRIJËS SHPIRTËROR, SHKRIMTAR DHE STRATEG POLITIK

Nga Ndue Ukaj

Periudha pas vdekjes së Gjergj Kastriotit deri te fillimet e Rilindjes Kombëtare, në historinë tonë kulturore e politike është mjaft e varfër. Tokat e Arbrit u plandosën nën robëri të rëndë, gjendja e popullit ishte e mjerueshme dhe zhvillohej një proces i dhunshëm i transformimit të nevojave shpirtërore, kulturore e sociale. Përgjatë kësaj kohe të gjatë e të errët, të pakta janë ato shkëndija drite që u munduan ta davaritnin errësirën e thellë të padijes e të varfërisë, dhe ato pak shkëndija kryesisht lidheshin me organizmin e klerit katolik që ishte diga kryesore e rezistencës kundër pushtuesve turq.

Pjetër Bogdani është përfaqësuesi më i madh i krejt kësaj periudhe. Ai veproi si argjipeshkëv, shkrimtar, strateg politik dhe ushtarak dhe kudo la gjurmë pozitive. Përballë gjendjes së mjerueshme të popullit të tij, atij i ra barrë e rëndë: të ishte prijës shpirtëror, politik, ushtarak dhe të përhapte dituri përmes librit; detyra këto që i kreu me shumë dashuri përgjatë jetës së tij, duke u lënë breznive të ardhshme një vepër me vlera të pashlyeshme kulturore, letrare, filozofike dhe gjuhësore.

Nuk dihet me saktësi viti i lindjes së tij, por dihet se ka lindë ndërmjet viteve 1618-1630 dhe i përket derës së shquar të Bogdanëve të mirënjohur në hierarkinë kishtare të kohës, kurse dihet se vdiq me 6 dhjetor 1689. Në parathënie të librit të tij, ai shkruan se ishte prej Gurit të Hasit të Prizrenit ku para tij ishte ngjizur një kulturë e shkrimit shqip dhe e rezistencës kundër turqve.

Duke parë dhe përjetuar gjendjen e mjerueshme të popullit të tij, ai u lidh fort me të dhe e njësoi fatin e tij me fatin e popullit të tij. Dhe zbriti prej elteri ku predikonte dashurinë dhe mirësinë kristiane, u ngjit në male dhe zbriti në fusha, udhëtoi nëpër qendrat e mëdha të Europës së atëhershme, për të kërkuar përkrahje dhe aleatë për ta mbrojtë popullin e tij. Punoi fort që t'i bashkonte shqiptarët në një kryengritje të armatosur kundër pushtimit turk, i cili, siç shkruante vetë ai, dvarte gjuhë, dije dhe kulturë.

Bogdani udhëtoi shumë dhe përshkoi qytete e vende, duke kërkuar dije e kulturë dhe u bë doktori i filozofisë dhe teologjisë. Në Itali - që atëbotë ishte kryeqendër e kulturës europiane - ai mësoi për artin dhe kulturën, për poezinë dhe filozofinë, për historinë dhe dije tjera humane, të cilat i sublimoi dhe i artikuloi me kompetencë shkrimore në librin monumental, "Conues prophetarum"- "Çeta e profetëve", të botuar me 1685.

Të dhënat biografike e historiografike tregojnë se për shkak të sëmundjes nuk arriti të realizonte përpjekjen e përbashkët me Pikolominin për t'i dëbuar turqit nga tokat e Arbnit. Atëbotë, ushtria e gjeneralit austriak ishte nisur në drejtim të Shkupit, po nuk arriti të hynte në qytet, sepse qytetin e kishte marrë epidemia e murtajës. Por, të dhënat thonë se në këtë kohë, Bogdani ia siguroi ushtrisë së Pikolominit rreth 6000 shqiptarë dhe bashkë me të niset për në Prizren, ku shpartallohen nga sëmundja e murtajës dhe forcat turke. Bogdani sëmurët nga murtaja dhe vdes. Pas vdekjes, siç njoftoi nipi i tij, Gjergj Bogdani, turqit dhe tatarët, trupin e tij e nxorën nga varri dhe ua hedhën qeneve në mes të piacës së Prishtinës. Këtu mbaron veprimtaria tragjik e jetës dhe tij dhe fillon jetën vepra e tij shelbuese kulturore, si zgjatim i frymës - si kujtesë dhe identitetit - që u përcoll brez pas brezi.

Bogdani është shkrimtar pa varr dhe historia e mungesës së varrit të tij është histori thellësisht tragjike. Të njëjtin fat tragjik para tij e kishte Gjergj Kastrioti dhe pas tij, Gjergj Fishta. Pra, te tretë këta i bashkon fati i përbashkët i pasvdekjes - mungesa e varreve.

Shkrimtari Ismail Kadare, te novela "Raporti i fshehtë" ka shkruar për fenomenin e mungesës së varrit të Gjergj Kastriotit, duke tërheqë një paralele mjaft domethënëse mes mungesës së varrit të heroit tonë kombëtar dhe mungesës së varrit të Jezu Krishtit. Për ta përforcuar idenë e novelës, Kadareja shkruan: "Zbrazëtia e varrit dëshmon shenjtërinë." Një shenjtëri të tillë e dëshmon edhe jeta dhe vepra madhore e Bogdanit.

Historiografia letrare shqipe tregon se vepra e Bogdanit pati jehonë të jashtëzakonshme kulturore dhe ndikoi fuqishëm në konsolidimin e letërsisë dhe gjuhës shqipe. Të dhënat që japin studiues e njohës të veprës së tij thonë se vepra u shpërnda në institucionet e kohës, ipeshkvi, famulli e "deri te njerëz të thjeshtë e të prujtë, të cilët e dijshin përmendsh Bogdanin e dijshin me çekë soje copa të tana përmendsh." Kjo vepër po ashtu pati sukses të madh në Itali, ku u rishtyp tri herë. Gjithashtu dihet se ajo njihej ndër arbëreshet, e më vonë nga rilindësit e rëndësishëm, Naimi, Mjeda, Konica, etj. Ajo u lexua dhe u botua disa herë, duke u kthyer në pasuri të përbashkët kulturore për të gjithë shqiptarët.

Martin Camaj thotë se në "Shkodër Cuneus Prophetarum ka qenë lexuem dhe studjuem në çdo kohë dhe ka ndikue thellësisht në gjuhën dhe stilin e shkollës letrare shkodrane. Mark Harapi (përkthyesi mjeshtror i romanit "Të fejuemit" të A. Manzonit) e pat botue gati krejt te Lajmëtari i Zemrës së Krishtit (vjetët 1941-1943), me shtesë komentimesh morfologjikë, si mbi përemnat dhe tjera pjesë të ligjeratës."

Ndërkaq, nga relacionet me vleftë historiografike e letrare të Bogdanit kuptojmë se bredhja ishte fati i tij. Ai vazhdimisht bredhte; herë duke kërkuar vendstrehim nga persekutimi dhe përndjekja që i bënin turqit; herë për të kërkuar aleatë e miq për të organizuar kryengritje kundër pushtimit turk; e herë- herë duke kërkuar mbështetës për ta botuar librin e tij, me të cilin dëshironte të ndriçonte mendjet e bashkëkohësve të tij.

Përballë mëkatit dhe padijes që shtriheshin frikshëm në atdheun e robëruar, Bogdani e dinte se armë më të fuqishme se libri s'kishte. Dhe përmes librit donte të nxiste vetëdijesimin kulturor dhe shpirtëror të shqiptarëve të shtypur, sepse, siç dëfton vetë ai, vendi "dergjej në një robëri të errët i verbuem me dy palë mjegulla të zeza mbi faqe, që janë mëkati, e padija sepse ishte dvarë dija e urtia."

Në parathënien të librit, "Të primitë përpara letrarit", Bogdani në formë programatike e misonarike tregoi filozofinë e tij për librin, konceptet themelore për dijen, religjionin, kulturën dhe përparimin.

Vërtet, ai misionin e vokacionin, në jetë dhe vepër i njëjtësoi me misionin e shenjtë të kulturës e të librit, të letrarëve dhe të doktorëve. Dhe duke qenë në kontakt me qendrat e mëdha të kulturës së kohës, ku lulëzonte humanizmi, dija e përparimi, ku zhvillohej letërsia e piktura, ai e dinte se duhej të kultivohej bukuria e giuhes. Dhe kjo ishte njëra nga shtytjet e forta intelektuale që e nxiti atë të shkruante një vepër për Arbninë dhe popullin e tij.

Luigj Marlekajt, njohës i shkëlqyer i veprës së tij dhe i Shqipërisë së kohës së tij, në studimin monografik "Pjetër Bogdani e Shqipnia e kohës se tij", citon sundimtarët osmanë që thoshin se "ai qe nuk len këtë vend te bahet turk". Kjo e dhënë tregon një punë kolosale të një korifeu të madh; të një njeriu të përkushtuar për ideale të larta e sublime. Prandaj, "Conues prophetarum", sot e gjithë ditën mbetet Çetë e madhe e kulturës shqiptare.

Duke e pasur parasysh kontekstin kohor dhe raportin e autorit me jetën politike, kulturore e fetare, shohim se kjo vepër unike është shkruar me një qëllime të lartë misionar e shëlbues, për ta mbrojtë dhe pasuruar gjuhën dhe rrjedhimisht për ta ndihmuar kulturën e arbnore. Prandaj, siç kanë pohuar shumë njohës e studiues, kjo vepër qëndron në themelet e kulturës shqiptare dhe që nga botimi i parë e gjer me sot ka ushtruar ndikim të madh në krejt historinë e kulturës shqiptare. Shembullin më tipik e gjejmë te figura e Ibrahim Rugovës, i cili idealet e Bogdanit i studioi dhe i ndoqi gjatë veprimit të tij letrar e politik, duke u bërë dishepull besnik i idealeve të tij në shkrim dhe veprim.

Bogdani, konteksti kulturor dhe letërsia shqipe

Letërsinë shqipe në të gjitha periudhat letrare e kanë karakterizuar temat e mëdha, të ndërlidhura me ekzistencën kombëtar, etninë dhe çështjen robërisë. Duke e njohur këtë aspekt, Eqrem Çabej, karakteristikë të letërsisë shqipe nënvizon ngjyrën politike të shkrimtarisë. Çabej e përligj mendimin e tij duke thënë se: "poetit si një prisi shpirtëror i

ka rënë këtu zakonisht dhe barra e apostullit nacional, atij këtu i është duhur shpeshherë të ndërrojë pendën me pushkë." Kjo referencë dhe mendimet e Çabejt se literatura shqipe është dominuar nga politika dhe nacioni, me kohë janë bërë pikënisje për të kuptuar kontekstin letrar dhe kodet e përgjithshme kulturore të zhvillimit të letërsisë shqipe, si veprimtaria shpirtërore më aktive që ndihmoi emancipimin dhe ekzistencën kombëtare, e në të cilën betejë Bogdani rezulton të jetë njëri nga protagonistët më origjinal, më të veçantë dhe më përfaqësues.

Dihet se Bibla përbën një realitet kulturor dhe letrar në gjithë sistemin letrar perëndimor, për faktin e mirënjohur të cilin e përmend edhe shkrimtari i madh, T. S. Eliot, i cili flet për influencë letrare të këtij libri, ndërkaq, në vazhdën e këtyre mendimeve dhe të kësaj tradite, teoricieni i njohur i letërsisë, Northrop Fray, shkruan se "letërsia perëndimore ka qenë e ndikuar nga Bibla më shumë se nga çdo libër tjetër."

Letërsia shqiptare duke qenë njëra nga letërsitë e kontinentit europian, pa dyshim se u influencua nga Bibla dhe ligjërimi biblik. Si pasojë e rrethanave të vështira ekzistenciale, letërsia shqipe ka tipare specifike, të cilat e shquajnë dhe e bëjnë të dallueshme, sikundër në aspektin tematike, po ashtu në atë ligjërimor e ideor. Ajo u zhvillua brenda truallit të letërsisë europiane, mirëpo, për dallim nga letërsitë tjera, ajo pati preokupime specifike kombëtare, e këndej pari, natyrshëm tematikë e dimensione ligjërimore specifike, që u kushtëzuan nga rrethanat komplekse nëpër të cilat kaloi kombi ynë. Këto raporte, kushtëzuan marrëdhëniet e brendshme të letërsisë shqipe - mes shkrimtarëve dhe shoqërisë - në një mjedis ku shkrimtarëve iu deshtë të ishin njëkohësisht prijës, edukatorë, dijetarë dhe shkrimtarë.

Pas vdekjes së Skënderbeut, përgjatë shekujve të robërisë e deri në shekullin XX, letërsia shqipe kreu një funksion, të cilin Northrop Fray e përkufizon si "funksion që nuk ka qenë në rend të parë estetik." Në këtë aspekt, vepra e Bogdanit është rrjedhojë e kësaj gjendje dhe reflektim i autorit kundrejt kësaj gjendje.

Cuneus Prophetarum: Çeta e kulturës shqiptare

Bogdani nga njohës e studiues të veprës së tij është vlerësuar si korife i shkencës dhe arteve shqiptare.

Vlen të përmendet se në kohën e tij, në Europë, letërsia krijohej dhe formësohej brenda koncepteve të renesancës, sidomos pas shkëlqimit të letërsisë së madhe me autor si Dante Ahlighieri (1265-1321), ndërkohë që vendi i Arbrit ishte plandosë në një robëri të rëndë, pasojat e së cilës ndiheshin më së shumti në kulturë. Kjo frymë e krijuar matanë Adriatikut, mjerisht nuk arriti të depërtonte te shqiptarët. Megjithatë, lëvizja për rezistencë kulturore arbnore kundrejt pushtuesit që dergjte dije e kulturë, mori kthesë pozitive me Bogdanin, i cili në përkim me filozofinë dhe konceptet e mesjetës shkroi veprën monumentale, Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve). Kjo vepër u botua në shqip dhe italisht në vitin 1685 dhe vlerësohet njëherësh si vepra me e përkryer e shekujve të parë të letërsisë shqipe. "Çeta e profetëve", ashtu siç e ka përkufizuar Ibrahim Rrugova është vepër bazë në humanistikën shqiptare.

Vepra si kompozicion dhe si strukturë i përgjigjet me përpikëri konceptit organizues dhe kompozicional të Biblës, dukuri këto, të cilat i kanë vlerësuar studiues të shumtë që janë marrë me studimet bogdaniane.

Libri është i ndarë në dy pjesë, ashtu siç është e ndarë Bibla në Besëlidhjen e Vjetër dhe në Besëlidhjen e Re.

Bogdani, ndryshe nga autorët pararendës është autor origjinal që shkroi një vepër origjinale, duke e zbatuar strukturën e Biblës dhe duke u bazuar në të. Në aspektin tematik, libri i parë është analog me Besëlidhjen e Vjetër, ku ritregohet kronologjia e Krijimit të rruzullimit sipas modelit biblik, dhe narracioni i veprës prej zanafillës rrjedh deri te ardhja e Mesisë. Në këtë pjesë, Bogdani paraqet kronologjitë profetike. Pjesët e kësaj, autori i quan ligjërata. Libri i dytë, ndërkaq, shfaqet analog me Besëlidhjen e Re dhe mund të kuptohet edhe nga vetë titulli, Jeta e Jezu Krishtit. Madje, në këtë pjesë, edhe numri i ligjëratave është i njëjtë me numrin e librave biblikë. Bogdani ritregon jetën e Krishtit, momente të rëndësishme të jetës së tij, nga gjeneza familjare, shfaqja-lindja, vepra, dënimi-vdekja-kryqëzimi, ngjallja dhe rishfaqja e tij. Kurse, pas këtyre teksteve/ligjëratave, kemi një tekst për Antikrishtin, i cili, me aludimet e forta, ndërlidhet me kontekstin shoqëror të Arbërisë së tij dhe me besimin e pushtuesve.

"Çeta e Profetëve" si formë shkrimi është shkruar kryesisht në prozë dhe hapet me disa poezi të bukura kushtuese, gjë që ishte praktikë e kohës.

Librit, siç e përmendëm më sipër i paraprinë një parathënie domethënëse "Të primit përpara letrarit", ku autori tregon erudicionin letrat, filozofik e telogjik dhe shpalos synimet qëllimore të veprës si dhe tregon në ç'kontekst të zymtë kulturor ishte ngjizë vepra, meqë dritën e atdheut të tij e kishin errësuar padija e mëkati. Ndaj, kërkohej dija e urtia, dhe Bogdani e dinte se ajo nxitej përmes librit, prandaj, sipas autorit duhej riaktualizuar Bibla, që për konceptin mesjetar ishte libri më i përkryer, sepse autori i saj ishte Hyji i përkryer. Dhe nëpërmes librit, autori si prijës dhe bari, donte të prekte zemrat e njerëzve që të vetëdijesoheshin "që të mos lënë dijen dhe gjuhen e dheut të zhduket, por sikur lufton gjithë dheu e bota për vet, po duke u lartësuar nga urtësia."



Pra, kjo vepër, duke u shfaqur analoge me modelin e shkrimit biblik është një hipertekst i tij.

Përveç ligjëratave dhe tregimeve biblike, te vepra e Bogdanit kemi një cikël poezish, të njohura si "Këngët e Sibilave". Sibilat ishin profetesha pagane dhe paralajmëronin ardhjen e Mesisë. Në poezinë e Bogdanit, Sibilat paraqiten me veshje etnike dhe kanë tipare të vajzave arbnore. Në fakt, ashtu siç ka vlerësuar Rugova," Bogdani ka realizuar disa nga metaforat më të formësuara dhe më të bukura në poezinë shqipe". Poezia e Bogdanit shquhet për ndërlidhnin me ambientin konkret shqiptar dhe personifikohet me figura jetësore të autorit.

Poezia e tij ka një skemë të rregullt rimash, që vargut i japin një muzikalitet rrëmbyes poetik. Bogdani i kontekstualizon Sibilat nëpërmes topikës dhe figurës idiomatike shqipe.

Te pjesa e poezisë, e gjejmë dhe një vjershë të pastër kosmogonike, "Krijimi i Rruzullimit."

Botën e pasur dhe sistemin poetik të Bogdanit e çmonte edhe poeti i mirënjohur Lasgush Poradeci, i cili shkroi: "Tekstin e Bogdanit e citova pas disa shënimesh që kam marrë në Vienë, Vjeshtën e 1924-ës, kur pata gëzimin t'i-a shikoj me sy...t'i-a çik me dorë...t'i-a studioj dhe t'i-a përpij "Conneus"-in në shpirtin t'im për të parën herë. Përveç shënimesh të tjera gjuhësore që më qëndruan për zemre, kam kopjuar një poezi kozmogonike, e cila, nga pikëpamja e koncepcionit origjinal, e idesë së fuqishme dhe e formës së veçantë të saj jam i mendimit se duhet konsideruar si një monument letrar jo vetëm i gjuhës shqipe, por i republikës letrare përgjithësisht. Kozmogonia e të madhit shqiptar i-u bën ballë, me cilësit' e veta, kozmogonisë asiriane (babilonase) ashtu sikundër këtë e shohin në Biblën hebraike, dhe kozmogonisë indike, ashtu sikundër këtë na e çfaqin Vedat e shenta. Kur të vij aty, do t'a rrëfej poezinë e Bogdanit, që të gjykosh më mirë vetë mbi vleftën e saj."

Pra, vepra e Bogdanit u çmua dhe u vlerësua në shekullin e krijimit, pastaj nga rilindësit, mirëpo kulmi i influencës së saj u shfaq ne platformën e kulturore dhe politike të Ibrahim Rugovës në shekullin XX. Ne fakt, Rugova u bë dishepull i Bogdanit dhe e ndoqi ëndrrën e tij në fushën e mendimit dhe të veprimit. Këto dëshmi tregojnë se Bogdani nuk shkroi dosido vepër, por një vepër madhështore, një kryevepër, që përbën bazën e letërsisë shqipe deri te fillimi i Rilindës Kombëtare kur u botua vepra "Milosau" e De Radës, me 1836.

ARTI AUTONOM I FJALËS SË ZEF ZORBËS

Nga Hans - Joachim Lanksch

Zef Zorba, i cili vdiq më 1993 në Shkodër, 73-vjeçar që i takonte qarkut të shkrimtarëve shqiptarë klandestinë, e përfundoi më 1989 veprën e vet poetike, nji vëllim poezish që u botua vetëm më 1994 dhe që përmban vjersha nga vjetët 1945-1980, të shkruara fshehtazi në burg (1946-1951) ashtu edhe pas dënimit. Edhe me pretendimet e tyne artistike dhe me realizimin e tyne artistik, 54 poezitë e librit e deklasifikojnë vargëzimin e prodhuem nga shumëshkrues notorë dhe me bekimin e Parisë, përfitim ky që e shkoi nga letërsia europiane dhe rrjedhat e zhvillimit të saj pjesën ma të madhe të letërsisë së shkrueme zyrtarisht në Shqipni.

Krahas me shkrimtarët në diasporë (Martin Camaj) dhe me autorë të tjerë klandestinë si Kasëm Trebeshina, Daut Gumeni, Primo Shllaku, Zorba i takon një qarku të vogël shkrimtarësh në Shqipni që, artistikisht dhe moralisht, e rimerrshin fillin e këputun të vazhdimësisë së letërsisë shqiptare dhe e rimëkambshin lidhjen me rangun e saj të naltë që e kishte fitue me autorë si Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi.

Ndërsa poezitë jopathetike, jopompoze të Zorbës në shikim të parë duken të thjeshta, madje edhe lexuesi serioz dhe i rrahun në lamin e poezisë e ka të vështirë me gjetë shtigje afrimi deri te ato. Poetikes artvrasëse socrealiste të "tipikes", Zorba i kundërvë nji poetike të përjetimit, të bashkëpërjetimit e të zhytjes së vetvetes në tekst tek lexuesi bahet bashkautor, nga lexuesi kërkohet me u ba bashkautor dhe jo konsument i tekstit. "Kalitjes ideologjike" d.m.th. indoktrinimit Zorba ia kundërve nji individualizëm rigoroz.

Tekstura e poezisë së tij asht eliptike, e përqëndrueme në qënësoren dhe e ngjeshun deri në abstrahim. Poezia e Zorbës të bahet si simoter letrare e pikturës abstrakte. Poeti i end tingujt, ritmet, tonalitetet, rezatimet e fjalëve në tekstet e vet fjalepake ne tabllo te pikturueme me fjalë, tabllo që janë konkrete vetëm në dukje dhe që veprojnë deri në shtresat e nënvetëdijshme. Vjershat e Zorbës janë art autonom i fjalës, art që ushqehet nga substanca fizike e shpirtnore e fjalës.

Në ciklin "Fugat e fundit" poetit ia doli me krijue nji sintezë unike në letrat shqipe, atë të muzikës e letërsisë, cikli "Mbresat e rrugëve - Poemë (Në formën e një koncerti për violë, fagot, ksilofon - kumbonë dhe instrumenta perkuisioni)" asht i komponuem simbas strukturës së sonatës (me hymje, ekspozicion temash, pjesë koncertuese, kadencat solo, reprizë dhe nji coda). Vetëm me këto dy cikle Zorba do të kishte fitue nji vend të dukshëm në modernen poetike europiane.

Zef Zorba asht modernisti i parë genuin dhe njiherit hermetiku i parë i poezisë së re shqiptare, me sa asht fjalë për atë të shkrueme në Shqipni. Përderisa "ndikimi" ungarettian te Martin Camaj, i shikuem nga ma afër, del ma tepër si përfundim silogjistik dhe tekstura e dendun dhe e mbyllun e Camajt duket si element afiniteti që rrajët i ka në hermetikën dhe modernitetin e arkaikes te Camaj si dhe në individualitetin e tij, poezia e Zorbës mundet me u dukë si ermetismo në shqipet, pa qenë ndonji imitim.

Para se me e mbarue manuskriptën, Zorba i përpunonte vjershat e tij - nga nji anë në kuptimin e ngjeshjes tek e shlyente, ashtu si dhe Martin Camaj, atë që ishte e tepërt, tue kërkue me i dendësue tekstet deri në thelb të thelbit, dhe, nga ana tjetër, vjershave që i kishte shkrue gegnisht, ua jepte petkun e letrarishtes së sotme zyrtare tue ruejtë elemente të vyeshme gege. Ashtu lind nji krijesë e re tek përzihen "idiomat tona (të traditës dhe ato që bota krijon të reja çdo ditë)" siç thotë autori në mbasthanien e vet, dhe krijohet nji botë specifike trajtash dhe shprehjesh, nji "fragmentarizëm" i synuem nga autori, nji shprehësi dhe trajtësi që shfaq sharmin dhe magjinë e vet që na e dokumenton bindës fuqinë, pasuninë e ngjyrëshmënisë së hollë si dhe ekspresivitetin e gegnishtes.

Në kujtim të shkrimtarit
Dhimo Tarusha

SHKRIMTAR VËNDËS

Nga Mihal Disho

Në gjuhën vllahe vëndës do të thotë që fjala i ka peshë, pra i zë vend. I tillë ka qënë edhe Dhimo Tarusha, të cilit i kishte peshë e i zinte vend edhe fjala edhe të shkruarit. Në fakt fjala e përdorur në gjuhën vllahe "vëndës" siç duket vjen nga fjala shqipe vendës, pasi ashtu si dhe çdo gjuhë edhe vllahishtja ka marrë nga shqipja dhe e kundërta.

Një vit po kalon nga ndarja fizikisht nga ne, i Dhimos, por shpirtërisht dhe në kujtim të përgjithmonshëm ai do të jetë te bashkëshortja, te fëmijët, te mbesat, te vëllezërit dhe motra, te të afërmit e tjerë, te miqtë dhe shokët, por mbi të gjithë te krijuesit letrarë të Elbasanit dhe më tej. Megjithëse vuajtës në sistemin e kaluar nuk mbaj mend dhe as kam dëgjuar që Dhimo Tarusha të kishte ndonjë armik personal, por veçse shok e miqë. Të dilje me Dhimon nëpër qytet a gjetkë duhet të pranoje "të lodheshe", pasi do të detyroheshe edhe ti t`i përshëndesje të tjerët që ishin me bollëk të njohur dhe shumë të njohur të tij.

Kjo njohje nuk vinte vetëm nga mirësia dhe bamirësia e tij, por jeta e tij ishte trimjeshtërore. Për të kapur Dhimon usta, shoferët nxitonin ose haheshin njëri me tjetrin që difektin e ndodhur ta rregullonin te usta Dhimoja, pasi ai ishte mjeshtër dhe të shkuar mjeshtrit. Mjeshtër ai ishte edhe në përdorimin e penelës për të pikturuar me ngjyra dhe kapur tema të goditura. Në sallonin e shtëpisë së tij rëndojnë nëpër mure piktura nga më të ndryshme dhe mahnitëse. Mjeshtria më brilante për të ishte shkrimtaria në prozë. Dhe me të drejtë një shofer në balloren e ofiçinës së motoristëve kishte shkruar: "Dhimo Tarusha usta motorist dhe usta shkrimtar".

Vepra letrare e vëndësit Tarusha mund ta kategorizojmë në romane, novela dhe monografi ose jetëshkrime. Romanet janë: Lulja e përgjakur, Natë e gjatë, Vllehtë, Buronja e livadhit, Përtej mjegullës, Cigani me def dhe Vajza e valëve. Pra gjithsej shtatë. Ndërsa gjashtë novelat janë: Klithmat e Voskopojës, Xhimo, Elbasani është larg, Vasilla, Ciganka dhe Trajta e mallkimit.

Dhimoja prozator mund të futet me më të mirët shkrimtarë të Elbasanit, pse jo dhe më tej. Ai me penën e tij di të kapë tema dhe nëntema nga më të ndryshme. Përshkrimet dhe peizazhet letrare të tij janë një vizion i gjallë, janë një pikturë e gjallë, janë një film dhe mbi të gjitha jetë e gjallë. Portretizimet, karakterizimet dhe temperantimet e personazheve janë lartësorë dhe jetësorë. Ai di të ta japë në dorë ngjarjen, ndodhirëzën, detajin dhe lëvizshmërinë e personazhit. Dhe të gjitha këto të mbrujtura me një figuracion të përsosur dhe lidhur me jetëzën e secilit veprimtar. Trimjeshtrori është mjeshtër edhe i figurave letrare.

Monografitë apo jetëshkrimoret e tij, të cilat janë katër u kushtohen legjendës së boksit tonë Dhori Gërnjotit, vllahut vuajtës Vasil Zgurit, fisit të Tarushajve – Ruvella dhe shoferit të dalluar Kristo Kristos. Tarusha shkrimtar e gjen veten në gjuhën shqipe, megjithëse si vllah ai e zotëronte shumë mirë gjuhën vllahisht. Në letërsi vëndësi i tij është në gjuhën e bukur letrare shqip, por ai di të vlerësojë edhe gjuhën vllahe, të nënës, megjithëse nuk e përdorte në krijimtarinë letrare. Ai vlerësonte për gjuhën vllahe: "Ne kemi vllahishten tonë, është e bukur, më e zgjedhura nga gjuhët e tjera; është e lehtë si lule aromëëmbla të blirit".

Në kohën kur organizimet letrare i drejtonte poeti i paharruar Milianov Kallupi, Dhimoja ishte ndër të parët që jepte mendime të pjekura për krijimtarinë letrare të bashkëshkrimtarëve, duke i vlerësuar ata e nxitur për më mirë. Pas diskutimeve të librave në kohën e bisedave të lira, ai çohej dhe me një talent të spikatur aktronte duke imituar aktorë të mëdhenj nga filmat tanë. Ai me gjuhën e folur dhe gjuhën e trupit sillte shkëlqyeshëm dhe me vërtetësi episode nga filma të njohur të prodhimeve tona. Veç me fjalën e tij imituese që të sillte aktorin, me imitime gojore e trupore sillte fenomenet e natyrës (erën, stuhinë, shiun e zhurmëra të tjera) si dhe florën e faunën e gjendje të tjera natyrore.

Librat e tij ndodhen në Bibliotekën Kombëtare, në Bibliotekën Publike të Elbasanit, në Bibliotekën e UE e gjetkë. Ato ndodhen në të gjitha bibliotekat personale të shkrimtarëve të Elbasanit e më tutje. Në familjet e të afërmëve të tij apo dashamirësve të tjerë. Këto Dhimoja i jepte me autograf me atë bukurshkrimin e tij me dorën e majtë. Familja e shkrimtarit Dhimo Tarusha veç librave të tij ka trashëguar edhe një bibliotekë shumë të pasur. Ai kurrë nuk u nda edhe nga leximi i librave e shtimin e tyre.

Pikërisht nëpërmjet ndodhjes së librave të tij kudo përmëndëm, ai do të kujtohet gjithnjë dhe leximi i tyre do të sjellë si në film dhe gjallë fisnikërinë e vëndësit, bukurinë e tij fizike dhe shpirtërore, buzëqeshjen e tij, mirësinë dhe trimjeshtërinë e Dhimo Tarushës.

Në foto : shkrimtari Dhimo Tarusha, poeti Milianov Kallupi dhe shkrimtari Mihal Disho.

Romani "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin" i Besnik Mustafajt

JERMI I TRANËS SË VITIT 2020 NËN TRANINË E PANDEMISË

Nga Granit Zela



Romanin e Besnik Mustafajt "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin: Conarium" e lexova në qershor të vitit të kaluar, gjatë kohës së karantinës, kur vazhdonte debati në *New York Times* nëse shkrimtarët do ta kthenin menjëherë në lëndë të mirëfilltë letrare këtë kohë të pazakontë pandemie apo duhej pritur të kalonin disa vite, të krijohej njëfarë largësie, për të patur një vepër të rëndësishme. Ideja që pata krijuar nga ky debat ishte se shkrimtarët e mirë do të vazhdojnë të shkruajnë mirë, dhe kohën në të cilën jeton secili e rrëfen sipas mjeshtërisë së tij, sepse letërsia ka të bëjë para së gjithash me *si* e rrëfen një histori, dhe thelbi i letrares është lidhja e saj me imagjinatën. Romani i Besnik Mustafajt ishte pohim i kësaj bindjeje. Një vit më pas, në qershor të këtij viti, me rastin e 30-vjetorit të Shtëpisë Botuese "Buzuku" në Prishtinë, ky roman u vlerësua me çmimin e parë.

Letërsia e gjendjeve të skajshme njerëzore si mbyllja në një vend të veçuar, kufizimi për të ndaluar përhapjen e diçkaje nuk synon të pasqyroj realitetin mjekësor të sëmundjes por simbolikën, tiparet e qenësishme në vetëdijen e rrëfimtarit i cili përveçse regjistron, rimendon dhe e shndërron historinë në një dështmi letrare. Dështmitari që letrarja i jep zë, është hapësirë në fantazi. Tek "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin" (Toena 2021), autori ka krijuar një tekst që përshkruan jermin e kohës së karantinës, me disa nga fobitë që i zgjon ideja e mbylljes një shkrimtari shqiptar i cili krejt rininë e ka kaluar në një sistem të mbyllur, "pasojat që krijon kjo mbyllje në psikikën njerëzore mbyllja e detyrueshme dhe frika kolektive nga vdekja, domethënë nga asgjësimi".

Shënimet nga kronika e karantinës, përcjellin nëntekste dhe krijojnë analogji me realitetet kombëtare dhe përtej kombëtare duke duke deshifruar kumte më universale. Epigrafi i Zbingiev Herbert, mbijetuesit të traumës së luftës dhe shkatërrimit të qytetit dhe vendit të tij, rimerret dhe bëhet pjesë e romanit, për t'i ndërmenduar lexuesit se nëse poeti polak shkroi duke jetuar "në shtëpinë e thesarit të të gjitha fatkeqësive", si reagim, edhe ai, autori Besnik Mustafaj, një ditë u ul për të përkthyer një përrallë, pasi qyteti i tij ishte në shtetrrethim. E bëri për të dështmuar fatkeqësinë e qytetit të tij nëpërmjet një rrëfimi i cili mbart një lidhje thelbësore me imagjinatën, por ti lexues ki kujdes, këtu nuk bëhet fjalë për raporte ushtarake, letra private, ose dokumente historike por je i ftuar të vizitosh fermën e Zonjës Dumre dhe të udhëtosh në një përrallë me Patokun Dindan, maçokun Piko dhe djaloshi Kolec, tri nga personazhet më të rëndësishëm të rrëfenjës së taksur për t'u treguar pikërisht me 2 mars, 2020, një rrëfenjë nga "366 rrëfenja për të ndjellur gjumin".

Rrëfenja është si një film ku lexojmë për robotët e programuar, projektet e larmishme të Grupit të Dijetarëve dhe ka gjasa që lexuesi të pyes veten, kush e ka shkruar këtë roman, a e ka shkruar shkrimtari Besnik Mustafaj? A e ka shkruar ai sepse në këto përralla, Besnik Mustafaj ka ikur nga të gjitha librat e tij të mëparshëm. E kush priste që të lexonte kronikën reale të shteterrethimit gjatë marsit 2020 të ndërkallur me një krijim me përmbajtje fantastike, një patok, një djalosh dhe një maçok, që u përkasin tri botëve të ndryshme: asaj shpendore, asaj shtazore dhe asaj njerëzore? Edhe ndërmendja e një filozofi francez të shtyjnë të shtyjnë të mendosh krejt të kundërtën kurse këto personazhe flasin e përsiasin me një gjuhë universale, madje edhe për letërsinë, poezinë dhe gjinitë letrare.

E kush mund ta harroj i dashur lexues (shprehje e përdorur nga autori që po e rimarr edhe unë) personazhin e Maçokut Piko, i cili përgjatë tekstit përmendet plot shtatë herë, duke dhënë variante të mimikave të ndryshme të fytyrës që bënin të ngjashëm me personazhin e Tomit në filmat e Walt Disney? Po kështu edhe dijetarët e tjerë që të përhumbin në një parafytyrimesh me idetë e filozofëve dhe ëndërrimtarë janë ura kaluese nga realitetit ëndërror (Cogito) në realitetin jetësor.

Në të vërtetë, më shumë se një qytet i rrethuar, Tirana e vitit 2020 jepet si një qytet i i pushtuar nga policë dhe ushtarë të armatosur deri në dhëmbë, me dekrete që shtrëngojnë rrathët e ekzistencës civile dhe krijojnë një botë paralele ku personazhi i Kryeministrit, me pushtetin e shumëëndërruar jetëson qëllimin e tij për ta sunduar, duke u kthyer në boshtin e nënteksteve letrare.

Rrëfimi faktik bëhet magjik ngase kronikani shoqërohet nga Patoku Dindan dhe episodet reale zëvendësojnë njëra-tjetrën, krijohet efekti që pati kjo gjendje krejtësisht e panjohur më parë për përmasën psikike, kulturore dhe morale të njeriut shqiptar duke e bërë atë të paharrueshme. Në fund të fundit, kjo formë e "narrativës si dështmi" synon që njerëzit të mos harrojnë, s'është thjesht regjistrim i realitetit, por një brendësim krijues i historisë reale.

Përhapja e epidemive dhe pandemive sjell përhapjen e masave tiranike të kontrollit bashkë me ligjërimin për shërimin e saj. Kronikani i "Conarium" na fton ta lexojmë kronikën e tij si analogji me efektet që sjell pushtetit absolut i cili instrumentalizon gjithçka. Fjala kyçe e përrallës është "pushteti i pakufizuar i imagjinatës", kurse tek realiteti i shtetrrethimit cënohen të drejtat civile me anë të frikës dhe teksti romanor krijon analogji të përpikta me pushtetin e pakufizuar policor dhe frikën që ngjallte regjimi totalitar i para 90-ës.

Rishkrimi i tekstit të njohur të Romeos dhe Xhuljetës me anë të palimpsestit, krijon një version tjetër por bën të njëjtën pyetje të vjetër për mënyrën si qeveriset një vend në kohë karantine duke bërë analogji edhe me kohëra më të largëta, me realitete të ngjashme.

Përveç kronikës si analogji, një nga aspektet e tjera të romanit "Conarium" është edhe efekti i pandemisë tek gjuha, e cila mishërohet shkrimi episodemik. Shkurtësia e kësaj metode rrëfimi është në përputhje me ndërprerjen e parakohshme të jetës. Shkrimi fragmentar, episodemik brenda romanit thyen vazhdimësinë dhe mishëron tekstualisht copëzimin e vetëdijes së individit dhe shoqërisë që shkakton shtetrrethimi.

Ky shkrim episodemik që flet me gjuhën e përrallës, është ana metafizike e kronikës, veshja e saj me imagjinatë, dhe kemi edhe lojëra elegante me tekstin duke tërhequr vazhdimisht vëmendjen tek statusi i romanit si artefakt, marrëdhëniet midis trillimit dhe realitetit. Episode të tilla hulumotjnë strukturat themelore narrative, por edhe përmasën e mundshme të trilluar të botës jashtë tekstit letrar imagjinar. Autori bëhet vetëreferencial dhe përsiat mbi gjuhën e poezisë, metodën e shkrimit, titullin e kronikës, formën, stilin, gjuhën, lexuesin, historinë që do të shkruaj, subjektin.

Fija lidhëse e të gjithave episodeve është gjuha e cila është mund të jetë "gjuhë asnjanëse", si ajo e nëpunësve të UNESCO-s, "gjuhë e përrallave" si ajo e (jo)realitetit të dytë që përshkruan shkrimtari, gjuha e autorit që e jetëson këtë (jo)realitet, "gjuha e poezisë" dhe "guha ushtarake" e cila e ka infektuar dhe sëmurur pushtetin i cili kthehet në kërcënim për shoqërinë. Karantina fizike merr gjithnjë e më shumë trajtën e një bunkeri gjuhësor ku e vetmja dritare është ajo e televizionit të propagandës.

Pandemia, në kohëzgjatjen e saj të paqëndrueshme, lind tekste fragmentesh e jo vazhdimesh: një grumbull episodesh, që nuk pranon përmbyllje kuptimesh. Shkrimi episodemik është në të vërtetë një formë e përplotësimit, krijimit të kësaj vijimësie të munguar ku teksti mbushet me lëndë imagjinare.

Të shkruash për një gjendje të skajshme, do të thotë të luftosh kundër saj dhe të tejkalosh efektet shtrënguese që mund të ketë ajo tek gjuha. Në këtë aspekt, efektet e kësaj gjendje sjellin një gjallërim të gjuhës në shumësinë e rrëfimeve që jepen në mënyrë retrospektive nga rrëfimtari. Kjo gjendje e skajshme e përcakton rrjedhën e shkrimit: kur shteterrethimi hiqet, rrëfenja mbaron. Ajo sjell në jetë dështmitarin dhe shkrimin i cili është gjithmonë i lidhur me çështjet e gjuhës dhe fushat sociale dhe politike në të cilat ajo vepron.

Pandemitë që kaplojnë bashkësitë njerëzore na drejtojnë tek domethëniet shoqërore, dhe kësisoj politike e kësaj përmase. Episodet dhe fakte reale të zgjedhura me mjeshtëri, shembullzojnë groteskun e një sipërmarrjes shtetërore për ta tiranizuar shoqërinë, dhe para së gjithash gjuhën kurse personazhet e tjerë, të patrilluar e kodifikojnë këtë realitet bashkëkohor. Tekste të tilla kanë peshë metaforike, simbolike, mbartin tensionet dhe krizat sociale, hulumtojnë se si ato i kanë rrënjët në tirani dhe rikrijohen në realitete bashkëkohëse.

Në fund imagjinata e artistit shpërthen dhe çlirohet me anë të gjuhës së lashtë të përrallës e cila shënon fitoren e krijuesit ndaj pushtetit politik dhe çdo lloj kufizimi. Kalimi nga bota e ëndrrës tek e realiteti kombëtar ndodh vazhdimisht, në mënyrë krejt të natyrshme sa të dyja realitet ngjajnë sikur janë dy përmasa të të njëjtit realitet dhe në këtë flatërim të imagjinatës Besnik Mustafaj fton ta shoqëroj lexuesin e përhershëm bashkë me një lexues i ri.

Shënime për vëllimin poetik "Një e tretë dashuria"

UNIVERSI DHE ZËRI DASHUROR NË LIRIKËN E PREÇ ZOGAJT

Nga Emi Krosi

Dashuria nuk është vetëm një "ushqim" shpirtëror por edhe një "ushqim"poetik. Nje koncetrat i veçantë, që shijon "gatimet" poetike, kur e përdor me masë. Poezia dhe dashuria janë më përtej tundimit, janë përherë në konflikt mes fizikes dhe metafizikes, mes shpirtërores dhe hyjnores, janë si një mahnitje dhe penetrim, një forcë e njohjes shpirtërore dhe e tundimit drejt/ prej së epërmes (zhanri shkrimor i poezisë). Kjo lloj poezie në shtratin e saj ka një thurimë Erosi dhe Psike, që nuk u duhet drita për të prekur shpirtin në errësirë, për të prekur dashurinë si një koncept tokësor (Parker: 2011). Temat e dashurisë të trajtuara nga shumë studiues botërorë në sonetet e Shekspirit (tema soneteve të tij, trajtojnë dashurinë, jo si një koncept tokësor, por si koncept i përjetësisë hyjnore) mes trupores dhe shpirtërores. Kurse, poeti latinoamerikan i dashurisë, Pablo Neruda, është poeti që e skalit trupin e femrës me "daltë", plot bukuri, hirësi, sharm dhe vërtetësi, duke shëndërruar botën e artit, të bukurisë, të ndienjës si një asociacion mes narrativës dhe shijes (Fraj: 1990). Imazhet erotiko-dashurore, që mëtojnë si një bashkim të drejtpërdrejtë me qartësinë dhe tour de force e habitshme, për të përplotësuar dhe vlerësuar poezinë lirike të dashurisë (Zogaj: 2021), se motivet erotike jo vetëm si përcaktesa të objektit krijues, por edhe në trajtimin poetiko-estetik të poezisë shqipe, janë të hershme. Jo vetëm vizioni femëror si emancipim shpirtëror i popullit tonë, por edhe kushtet socio-shoqërore dhe historike, si në diakroni ashtu edhe në sinkroni, tematika e poezisë erotike është zgjeruar në dy rrafshe:

a) rrafshi erotiko-dashuror (një rrafsh i njohur shumë më herët, made që me sibilat e Bogdanit), b) rrafshi erotiko-pornografik, (letërsia shqipe nuk e ka pranuaras si nën/substrat të saj), por dashuria mbetet gjithmonë, një etje asnjëherë e shuar, një etje e zhuritur (Aliu: 1990).

***

Libri më i fundit me lirika dashurore, "Një e tretë dashuria" e Preç Zogaj-t, ndahet në gjashtë cikle:

1. Cikli i parë: një e tretë dashuria, (një imazh dashuror i skalitur imtësisht me 17,

(shtatëmbëshjetë) lirika), me poezitë: "Në qejfin e saj dashuria", "Të herës së parë", "Pjekuria", "Kur e kujtoj sa të kam dashur ty", "Netët tona", "Në këmbë na mbajti dashuria", "Ne na njohu një e tretë, dashuria" etj. Imazhet dashurore të Zogaj-t, përplotësojnë rrethin e kalimi nga vetia tek tjetri, nga Idi tek Libido, duke mos iu frikësuar as kohës, aa moshës, as largësisë, se vetë dashuria, është përditshmëria jonë, pania fizike apo atraktivia (tërheqja), ajo që poeti e quan "të pafajshme" përmes vargjeve: isha i rritur, trembëdhjetë vjeç,/nata i kishte mposhtur të gjithë veç meje/Këndonin gjelat, padisnin, tallnin,/pagjumësinë time të parë, të pafund./.../Në qejfin e saj dashuria/ shtronte qilimin/midis fëmijërisë dhe vdekjes time, poezia: "Në qejfin e saj dashuria", më përtej lëvizjeve të sferave qiellore (cikli natë/ditë), se dashuria mund të kapërcejë thjesht fizikun, por kurrë shpirtëroren. Ata janë bashkuar, se dashuria është e bazuar në pikën qendrore, duke bashkuar dy rrathët e jetës fëmijëria (ciklin e jetës adoleshenca, burrëria) se përmes dashurisë kalon jeta deri në vdekje, çon në bashkimin fundor të përsosur. Vargjet: netët tona...sa u bënë?/ qindra, mijëra si një natë e vetve/nën një tavan nën një jorgan/duke u parë me gishta, duke folur me puthje, nga poezia: "Netët tona" këtu poeti kalon në fushën më intime të dashurisë, një marrëdhënie që duket shekullore. Dashuria shpirtërore e filluar nga "mendja" nuk mund të reduktohet nga distanca fizike se dashuria, fillon të përqendrohet tek "gishtat dhe pudhjet", pra përmes perceptimit mishtor, që mishëron simbolizmin e dashurisë (John:1975). Poezia:"Ne na njohu një e tretë, dashuria" nga ku ka marrë edhe titullin libri, vargjet: ne na njohu një e tretë: dashuria/ajo qëndronte mes heshtjes tonë/kur shiheshim gjatë si dy të pagojë/dhe e dinim para tjetrit çfarë ka në mendje tjetri/dhe flisnim dyshe dhe kur flisnin me vete... dashuria dhe "zëri" i poetit përmes "zërit të tretë", zëri dashuror, i "konceptuar" si i shenjuar dhe imazhi i shenjuesit, (perceptimi i dashurisë si njeri/ individ), sëbashku me të gjitha aspektet e gjuhës për të kuptuar mesazhin e ndienjës.

2. Cikli i dytë: vitet e fundit të nënës, (imazhet e fundit të asaj që na ka dhënë jetën prej 7 (shtatë) lirikash); përmes poezive: "Nëna ime po e kalon mërzinë", "Epilog", "Pashkë në Lezhë", "Histori", "Nuk jam më në kujtesën e nënës", "Nëna dhe qielli", "Vdekja e nënës" etj. Poezia "Nëna ime po e kalon mërzinë", përmes vargjeve: nëna ime po e kalon mërzinë/për burrin e saj që vdiq dimrin e shkuar/S'kemi ç'të bëjmë,- më thotë, -s'kemi ç'të bëjmë/Po ta di se më pret, do të luaja mendsh/që po vonohem... Si mendon ti?, vjen në formë dialogu. Poezitë janë si një porosi për nënën, pasi lidhja e fëmijës me nënën (djali), herë -herë e përmbys strukturën frojdiane të "kompleksit të Eipit", pasi shumë herë Pema e Tamblit (trasmentimi përmes gjirit/qumështit), është dhumë më e fortë sesa Pema e Gjakut (lidhja me babin). Vargjet: ka gjëra që shihen para se të ndodhin/ Këtë këngë e nisa të premten,/nëna u shua të martën/Gishtat e dorës m'u zhdukën/pasi mbaruan së numëruari/ditët e saj të fundit nga poezia: "Vdekja e nënës", përmes shenjëzimit të kohës ciklike, në momentin e pranimit dhe përfaqësimit të poetit me vdekjen e nënës, përmes përsëritjeve (trembëdhjetë herë /13) të fjalës semë nënë na sugjeron: krijimin e njësive të reja leksikore, funksioni i të cilave është të përmbledhin dhe të kondensojnë tiparet kryesore të tekstit (Riffaterre: 1983), që paraqitet në rrafshin sintagmatik me kryesemën shenjë nëna:

nëna si besim
nëna si dhimbje
nëna si grua/femër
nëna si mungesë
nëna si kujtesë/dashuri/bekim

Poeti shpalos të gjitha aspektet subjektive ose fenomenale të përvojës, vetëdijes dhe Unit poetik. Ky përkufizim thekson në mënyrë të arsyeshme strukturimin e poezisë, në vend të subjektivitetit ose emocionit ose koherencës metrike, si "emërues i pareduktueshëm" i lirisë poetike, ku dallohet një lloj evidence strukturore ose përmbajtësore (Bloom: 1982).



3. Cikli i tretë: shpagimi po vjen me fytyrën me të bukur, (njëkohësia dhe njëmendësia e thyer përmes surreales dhe marrësisë tonë shqiptare me 11 (njëmbëdhjetë) poezi), me ciklin poetik: "Baladë trishtimmi për Noçen", "Shpagimi po vjen me fytyrën më të bukur", "Mallkimi", "Aliemët", "Pamje shqiptare", "Gratë nuk na duan më" etj., poeti kapërcen të gjitha "panelet" poetike. Nga lirika dashurore, tek lirika e dhimbjes, mungesës, humbjes së nënës, në kalimin e teknikës postmoderniste duke shpërbërë individualen dhe absoluten, domosdoshmërisht si vizion dhe si dëshmi, përmes pikëpamjeve kaq modreniste, me vargjet: me shpinë nga ekrani duke mërmëritur/duke mbytur lemzat e profecisë.../Vazhdon se s'ka të ndaluar reklamimi/i supërofertave, supërmashtrimeve/ supertralalave, superlarjevelyerjeve, nga poezia: "Shpagimi po vjen me fytyrën më të bukur" poeti, si imazhi e ekraneve (analist dhe panelist në shumë studio të TV-ve), ku fasada e ekranit është vetëm një dukje, por njeriu prapa tij është një shpërfytyrim i surreales, absurdit dhe neverisë shoqërore. Titulli i poezisë, si "një dëshpërim vizionar", që nuk është gjë tjetër, veçse dëshpërimi siç mund ta përjetojmë në jetët tona të përditshme, është dëshmi për të gjitha pikëpamjet poetike moderniste (Ashton: 2005). Mënyra e fjalëformimit të fjalëve me [parashtesën-super] si edhe aliteracioni por edhe aconancat dhe kosonancat,[supërofertave/ supërmashtrimeve/ supertralalave/ superlarjevelyerjeve], duke i dhënë poezisë karaktere si: dehumanizmi, ironia dhe sarkazma ku dukshëm vinë përmes poezisë: "Pamje shqiptare" me vargjet: dielli, i vetmi që nuk u tërheq vëmendjen/ këtyre njerzve/edhe pse kokën lart e mbajnë/dhe të mendosh, të parët e tyre/i dhanë një emër shumë miqësor, përmes togfjalështi: dielli, i vetmi që nuk u tërheq vëmendjen/ këtyre njerzve, ku supërrealia, që do të thotë kuptimi mbi të vërtetën, shenjohet me konvencionin e realitetit si stimulim i të vërtetës.

4. Cikli i katërt; dhe kaloi fëmijëria jote, rreze dielli (kujtimet nga fëmjëria, vendlindja, deti, shokët me 11 (njëmbëdhjetë) lrika), një cikël me poezi kryesisht katërvargorë, gjashtë vargorë por edhe triptikë. Poezi, ku dallohet rrokja e stilit klasik, modern dhe postmodern. Në këtë cikël janë poezitë: "Njëherë tjetër", "Testamenti i gjyshes", "Përbindëshi", "Shokët" e fëmijërisë", "S'ma japin kurorën", "Vuan që është e errët nata", "Dhe kaloj fëmijëria jote", "Bujaria", "Ti je ti", "Bota është rinore", "Dashuria nuk flet" . Poezia triptik "Bota është rinore": bota është rinore/ këtë nuk e dija/ kur isha i ri.

5. Cikli i pestë: dy përjetësi dhe asnjë jetë, (përditësia që "zhvesh" çdo vlerë njerëzore dhe letrare me 13, (trembëdhjetë) lirika) me poezitë: "Pema e natës dhe territ", "Vetëm për ty kalon koha, mbaron koha", "Pjetër Bogdani", "Me Rudolf Markun, në kafe "Çokolatino", "Teposhta", "Çast nudo" "Zgjim

përsëri", "Ecce homo", "Greqia" etj. Janë poezi jo vetëm si poetikë në kuptimin stukturalist të fjalës, që përçon më tej ligërimin letrar, bashkë me njohjen e teorive kulturore të elementeve postmoderniste, ku shumësia e diskurseve, nuk na shfaq përkufizime fikse, por poetikat e stukturave të hapura, shumë herë janë të përceptueshme dhe të ndryshueshme (Culler: 2004). Poezia: "Pema e natës dhe territ", me vargjet: kam kënduar ditën e re duke bërë kryqin/por sot u kujtova të këndoj lavdërimin/e territ që më pruri përsëri/në këtë shtrat, shikim, vetëdijësi/Të falem, o terr, ti më merr n'garkim, triptiku: drita/ dita/terri dhe besimi, përmes metaforës së Kryqit (përtej besimit të poetit), janë zërat që e thërrasin lexuesin për një "lexim të dukshëm", duke e imagjinuar "hapësirën boshe" ku thelbësorja "artikulon poezinë". Poezia propozon, që errësira vizuale nuk mund vetëm të lexohet, por edhe të ftojë në mënyrë aktive dhe të kërkojë një zë: vizatimet e rastësishme, format e errëta, duke u përdorur në qëllimin e përfaqësimit dhe në dukje të parregullta në përmbajtje (Harshav: 2007).

6. Cikli i gjashtë: e skuqura thotë diçka që nuk thuhet, (imazhe dhe copëra kujtimesh ngamiqtë, dhe marrëdhëniet familjare, motra, vëllezërit, miqtë etj., me 13 (trembëdhjetë) poezi). Ky është cikli i fundit, që përfaqësohet me poezi kryesisht në formë dedikimesh dhe me dy balada (nëse mund të quhen ashtu). "Njerëzit me të cilët u rrita", "Krishti dhe unë", "Pikturë fëminore", "Moj bashkëshortia ime besnike", "Porosia", "Lutia për tim vëlla", "Balada e skuqjes", "Kaq shumë plane, kaq shumë mëdyshje" etj. Poezia që hap këtë cikël quhet: "Njerëzit me të cilët u rrita" me dedikim, (Gjergj Kthellës) përmes vargjeve: njerëzit me të cilët u rrita/vdesin, vdesin, më i fundit Gjergji/.../njerëzit me të cilët u rrita po vdesin/, zmadhohet, vjetërohet vetmia ime/O Gjergj, o Pashk, o shokë të fëmijërisë, poeti përmes kujtimeve apo [o-së thirrmore] thërret me emra shokët e fëmijërisë. Folja ata "po largohen" formon çiftin: vdekje/vetmi, që nuk e fragmenton rrëfimin me diskurse të ndryshme poetikash, por nxit aspekte kundërshtie, rastësies, thyerje etj., pastaj përsëri zgjon një double voice, (zë i dyfishtë) si trillim i postmodernitetit, si marrëdhënie, mes raportit të zërit të brendshmëm, (të shenjuarit si kuptimi i jetës njerzore), dendurisht lidhet në raportin e asaj, që mund të kishte qenë ndryshe, strukturë e realizuar e figurimit të lirikës (Paund: 1968). "Naiviteti fëmijëror" i rrëfimit mund t'i referohet veçanërisht, një tjetre mënyre rrëfimi, për të rregulluar lidhjen e vargut me lirinë poetike, dhe përsëritjen në kohë, kemi një ndjenjë déjà vu. Fuqia kohore e retrospeksionit dhe projeksionit varet nga aftësia për të mbajtur parasysh dhe ngjashmëritë, përsëritjet, sekuencat e kujtimeve, nga rimimi i marrëdhënieve që përmbysen dhe zhvendosen në një plan tjetër me kuptueshmëri të përgjithshme. Poezia: "Moj bashkëshortja ime besnike" përmes vargjeve: moj bashkëshortja ime besnike/kërkoj të më falësh flirtet, arratinë/.../kërkoj ndiesë që këta sytë e mi/pahishëm nga prapa gra kanë parë, tregon se poeti "është në borxh" me bashkëshorten, ku përveçse kohës së krijimit, poetët janë "të pabesë", flirtues, por poetët kanë natyrë rebele, dhe u "pranohen" prapsitë por edhe ndiesat e tyre të sinqerta.

BIBLIOGRAFIA:

1.Aliu, Ali. (1990) : Kërkime - Studime, kritika, ese, "Naim Frashëri", Tiranë.
2.Ashton, Jenifer. (2005): From modernism to Postmodernism, Cambridge University Press.
3.Bloom, Harold. (1982): Agon: Toward a Theory of Revisionism: New York: Oxford University Press.
4.Culler, Jonathan. (2004): Supozimi i intertekstualitetit, "Jeta e re", Prishtinë.
5.Harshav, Benjamin. (2007): Explorations in Poetics: Stanford: Stanford University Press.
6.John P. Broderick. (1975): Modern English Linguistics: New York: Thomas Y. Crowell.
7.Parker, Fred. (2011): The devil as muse : Blake, Byron, and the adversary, Baylor, University Press.
8.Perloff, Majorie & Dworkin, Craig. (2009): The Sound of Poetry The Poetry of Sound. University of Chicago Press.
9.Pound, Ezra. (1968), The Spirit of Romance: New York: New Directions.
10.Riffaterre, Michael. (1983): Text Production, New York: Columbia University Press.
11.Zogaj, Preç. (2021). Një e tretë dashuria, "UET PRESS", Tiranë.

SHKRIMTAR I ABSOLUTES SË BRENDSHME

Duke lexuar ZIJA ÇELËN

Nga Oana Anca Mihaela Glasu

Për mua, atë që lexova në tregimin "Ëndrra me pulëbardha" nuk është thjesht një fragment i prozës, por një poemë alkimike. Një transferim shpirtëror, një korrespondencë e mrekullueshme midis niveleve të qenies, në të cilën ëndrra mund të përmbushet. Një trazirë metafizike, në arsyen e plotë ose jashtë saj, përmes së cilës na përgatit Zija Çela.

Dua të them se na mëson. Të dimë se atëherë kur zogjtë e vdekjes ndonjëherë përgjojnë në hije, harmonia e kuptimeve rivendoset gjithmonë nga dashuria. Ajo nuk ka kohë, as moshë dhe as vdekje.

Tani do të ndalem te romani i fundit i autorit. Të dielave zakonisht shkruaj letra. Nga ato të vjetrat, që i vendos në zarf dhe i dërgoj me postë, ose e-maile, ose ndoshta shkruaj diçka të tillë si kjo lloj shprehjeje mendimesh, siç bëj tani. Sapo mbarova së lexuari "Lavjerrësi i qytetit" të Zija Çelës dhe më duhet të shpreh ato gjera në pak fjalë si i ndiej për momentin.

Ky roman ka një „të metë". Dhe kjo është inteligjenca e tij. Një roman për inteligjencën, për përpjekjen për të kuptuar, për të lidhur gjërat së bashku. Me mjeshtëri autori na tregon si të shkruhet romani i një demaskimi. Të një regjimi, të shoqërisë, të nesh, të të gjithëve dhe gjithmonë, pavarësisht vitit kur e ka shkruar veprën, hapësirës në të cilën jetojmë apo kohës që kemi jetuar secili. Një roman për lirinë dhe manipulimin, përmes të cilit dëshiron të ndërgjegjësojë lexuesin se sa i manipuluar, i indoktrinuar, i frenuar është ai për shkak të atyre që i vjedhin kryesisht lirinë e mendimit. Është gjithashtu një roman tragjik, në të cilin Zija Çela tregon se nëse dëshiron të kuptosh, duhet ta lejosh veten të bëhesh i pambrojtur, sepse vetëm atje, në një gjendje të tillë, mund të takohesh me veten tënde. Autori ka ndërtuar me mjeshtëri idenë e një njeriu, i cili duhet të ketë të drejtën të shkojë jo me kokën e përkulur, sepse ky do të ishte pozicioni fizik dhe metafizik, të cilin vetëm një shkrimtar i konceptimit humanist si ai mund ta themelonte. Ky pozicion të lejon të shikosh qiellin, i cili është liri absolute. "Lavjerrësi i qytetit" është shumë aktual, por përmban edhe karakteristika të caktuara të perspektivës apo së ardhmes, të cilat shpallen në të njëjtën mënyrë, pa ndryshime të dukshme. Mendoj se tashmë po jetojmë një nga të ardhmet tona të shumta të dështuara, mbi të njëjtat ide, për të cilat na ka munguar e kaluara e dështuam edhe atëherë.

Zija Çela më ka lënë ndjenjën se përtej gjendjes së narratorit, ka përmbushur edhe funksionin e terapistit, madje edhe të arkitektit të tekstit, për shkak të saktësisë së organizimit të hapësirës, në të cilën synoi të Bukurën, duke arritur të krijojë harmoni për lumturinë dhe dinjitetin njerëzor.

Zija Çela flet për zhdukjen e tij në libër! Besoj se edhe letërsia është një art profecie, diku e barabartë me historinë, dhe detyra më e rëndësishme e artit është të krijojë një kërkesë në shoqëri, për kënaqësinë e plotë të së cilës nuk ka ardhur ende koha. Dhe ai ka nevojë për këtë përmbushje përtej vetëdijes ose të pavetëdijshmes së tij, duke e përfshirë veten në dritë. Më konkretisht, a e dini se si e shoh autorin? Një shkrimtar i absolutes së brendshme. Të cilit i duhet të dalë nga vetvetja për të parë veten. Dhe për këtë ndjeva edhe një melodi të brendshme teksa po lexoja. Ai jo vetëm që zotëron artin e përdorimit të fjalës së gdhendur, por ka gjithashtu një estetikë elokuente të mendimit dhe një ndjenjë të lartë dashurie për mençurinë.

Kjo është arsyeja përse për lexuesit e tij është kaq i dashur. Prandaj edhe unë e dua! E dua Zija Çelën për gjithçka që është, për gjithçka që jep, duke respektuar njëkohësisht lexuesit e shkrimtarit për vlerësimet e shumta. E meriton dhe jua kam zili që e keni këtë kolos të letërsisë suaj kaq afër. Nderojeni, sepse dikush si ai nuk do të lindë më shpejt! Zija, të mbaj në krahë ndryshe, në mënyrë unike dhe primordiale!

E di që do me ndërprisnit dhe do më thoshit përsëri: shkëlqen, shkëlqen, dhe unë do strehohesha në aureolën tuaj te dominuar nga kaq butësi dhe do të përgjigjesha që në të dielën e qenies sime drita nuk prishet, fjala nuk deformon, në ketë ditë nuk ndodh asgjë, përveç këtyre rreshtave për ju dhe shumë dashuri. Pastaj do t'ju thoja se në të dielën e qenies sime bari rritet në gjelbërimin e tij të pastër, megjithëse ndodh një love story nëntori, zogu ngjitet në këngën e tij të pafund dhe mali shpon me brinjë qiellin e paprekur, sepse kjo e diel do të thotë dhe një takim me ju. Sytë e të paditurve do të mund të shikojnë vetëm!



KADAREJA DHE ROMANI MODERN SHQIPTAR

Nga Prof. Dr. Klara Kodra

Kadareja, ky përfaqësues i shquar i avangardës së viteve 60-të, ka meritën e madhe ta ketë rinovuar i pari romanin shqiptar, duke vënë në jetë synimin që s'u realizua dot nga Migjeni, Koliqi, Kuteli që u ndalën në lloje më të vogla.

Lloji i romanit, tepër i vonuar në krahasim me romanin evropian (u shfaq vetëm në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kohë kur ky lloj do të arrinte kulmin e zhvillimit).

Ky lloj më vonë do t'i digjte furishëm etapat për ta rifituar kohën e humbur.

Romani shqiptar nuk e njohu as realizmin e Rinashimentos, as të ashtuquajturin "realizëm iluminist", do ta njihte vetëm sentimentalizmin si pararomantizëm dhe për një kohë të gjatë s'do të çlirohej nga shpërgënjtë e patetizmit dhe skematizmit të tij.

Romanet e para të njohura, ato të Nikajt i përkisnin sentimentalizmit dhe dalloheshin për një "vizion të botës" bardhë e zi. Niveli i tyre qe ai i "romanit të masës".

Arbëreshi Santori, në fakt edhe para Nikajt, kishte arritur t'i çonte romanet e veta në romantizëm dhe realizëm, madje në to shfaqeshin embrione vlerash estetike, disa personazhe të realizuar, disa tablo të gjalla, po për fat të keq këto romane nuk i arritën dot as lexuesit arbëresh dhe aq më pak lexuesit shqiptarë.

Në vitet 30 romani shqiptar pati disa arritje sasiore, madje në të u shfaqën elementët e para të realizmit kritik dhe, për çudi, edhe të modernizmit në romanet "Pse?" dhe "Afërdita" të Sterjo Spasses dhe te "Sikur t'isha djalë" i Haki Stërmillit. Po ato mbetën romane eksperimentale, forma e të cilëve nuk ishte në lartësinë e risive që synonin të arrinin autorët.

Talentet më të fuqishëm të kësaj etape iu kushtuan kryesisht llojeve më të vogla, tregimit, novelës ku patën arritje të ndjeshme.

Po të lihej në rrugën e vet të natyrshme romani shqiptar do të ecte drejt realizmit kritik, duke arritur mbase bashkëkohësit evropianë, ata që u quajtën "realistë të viteve 30-të", mbase edhe drejt modernizimit që po fillonte të jepte frytet e para në romanin evropian.

Po kjo rrugë iu ndërpre në mënyrë brutale në kohën e pasluftës. Romanit iu imponua nga burime jashtëletrare një djegie etapash, një model që s'ishte, as realist, as modernist, modeli i një drejtimi që pretendonte se qëndronte më lart se realizmi dhe romantizmi, duke i shkrirë ato, realizmi socialist, një model që po ndiqej në Rusi dhe në disa vende ballkanike.

Në të vërtetë ishte fjala për një klasicizëm të një lloji të ri, më i ngurtë se klasicizmi historik, me një program krijues të formuluar jo nga shkrimtarë, po nga ideologë, me rregulla në thelb jashtëletrare. Ky drejtim letrar artificial do ta mbërthente romanin e ri shqiptar ende të paformuar plotësisht në rregulla të ngurta që rrezikonin t'ia merrnin frymën.

Ishin vitet 50-të kur determinizmi sociologjik do ta shtërngonte këtë roman në përqafimin e vet të hekurt që kishte rrezik t'i jepte në vend të një jete të re, vdekjen.

Do të lindnin romane racionale që pretendonin për historizëm apo karakter aktual si "Çlirimtarët" e Shuteriqit, "Përmbysja", "Këneta" e Fatmir Gjatës, "Një vjeshtë me stuhi" e Ali Abdihoxhës etj., fëmijë "të lindur të vdekur" apo fëmijë rakitikë që mezi mbaheshin në këmbë.

Motivimi sociologjik, i trashëguar nga realizmi kritik, një lloj që ende s'kishte arritur të afirmohej në letërsinë shqiptare, mbizotëronte në romanet e kësaj kohe, duke u mbështetur në patericat e të ashtuquajturave "rregulla të reja", të frymës revolucionare, të heroit pozitiv, të orientimit drejt romantikës së një të ardhmeje ideale dhe faktikisht të pamundur.

Talentet e dobëta u shtrinë me kënaqësi në këtë "shtrat Prokusti" që u jepte mundësinë të gjallonin, talentet në shpërthim e sipër po asfiksoheshin.

Erdhën vitet 60-të. Erdhi një talent i ri, vital dhje i fuqishëm që do t'i brente nga brenda rregullat asfiksuese. Ai pranoi në dukje të fshihej nën pelerinën e drejtimit letrar të ngurtë që mbizotëronte.

Po që në romanin e parë shkrimtari do të kryente një mrekulli, do t'i falte a më mirë do t'i rikthente llojit të romanit atë tipar që romani evropian e kishte fituar prej disa shekujve qysh me Servantesin, siç do të pohonte me mprehtësi Kundera në "Artin e romanit", relativizmin, ambivalencën, pranimin e disa të vërtetave relative, në vend të një të vërtete absolute.

Romani i "realizmit socialist" që pretendonte se zotëronte përgjigjet e të gjitha pyetjeve nuk mund ta pranonte një dukuri të tillë, po Kadareja me largpamësinë e një talenti të madh, e pranoi.

Po lindte një lloj romani që do të karakterizohej nga "kodi i dyfishtë", një lloj romani që nuk vinte në qendër "heroin pozitiv" artificial, po një antihero, një personazh me thelb negativ apo kompleks.

Motivimi sociologjik po plotësohej apo spostohej nga motivimi psikologjik, personazhet fillonin të shiheshin në një optikë, tashmë jo aq sociale sa ekzistenciale.

Kjo do të ndodhte qysh në romanin e parë të Kadaresë, "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur".

Do të pasonin "Kështjella", "Kronikë në gur", kryevepra estetike të letërsisë shqiptare dhe njëkohësisht perla të krijimtarisë së Kadaresë që vetëm formalisht i përkisnin drejtimit zyrtar të "realizmit socialist", po në të vërtetë ndërthurnin një lloj të ri realizmi me modernizmin.

Këto vepra shfaqin një "vizion të jetës", dramatik në caqet e tragjizmit, ato çmitizonin të ashtuquajturën përmasë "heroike" të fituar nga jeta nën diktaturën komuniste, i bënin vend gjithnjë e më tepër nënvetëdijes, pasqyronin krizën e individit dhe të vlerave në shekullin e njëzetë, tashmë jo në kushtet e shoqërisë borgjeze si Kafka dhe Musili, po në kushtet e një diktature totalitare të majtë që nuk mbetej pas nga diktaturat e djathta.

Këto romane, pra, jepnin një mesazh çmitizues, një mesazh mohimi të realitetit socialo-politik që jepej përmes "gjuhës së Ezopit" dhe pohonte si të vetmet vlera të mundshme disa vlera pannjerëzore si dashuria erotike dhe dhëmshuria njerëzore. Këto vepra ishin gjithashtu novatore nga ana e formës meqenëse në to mbizotëronin risi si sinteza, simbolet e fuqishme, rryma e brendshme e lirizmit e trashëguar nga poezia, relativizimi i kohës i shprehur përmes retrospektivës, monologu i brendshëm që luan rol të veçantë, dramatizmi i dialogëve që afron romanin me dramaturgjinë.

Gjithnjë e më tepër në këto romane që e çorodisnin kritikën zyrtare dhe linin të mahnitur deri në ekstazë publikun e lexuesve, sidomos atë të të rinjve, disidenca estetike shndërrohej në disidencë ideologjike.

Kjo disidencë do të arrinte kulmin te "Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave" dhe "Koncert në fund të dimrit" ku Perandoria Osmane dhe Kina simbolizojnë në fakt diktaturën shqiptare, shtypjen dhe përgjimin policor oruellian të individit dhe varfërimin gjithnjë e më të madh shpirtëror të tij.

S'mund të pranojmë tezën e atyre studiuesve të cilët edhe sot pretendojnë t'i vendosin këto romane në kornizën e "realizmit socialist". Rregullat formale të drejtimit, të brejtura gjithnjë e më tepër nga brenda po shndërroheshin përherë e më tepër në një guackë bosh.

Pamë që shkrimtari do t'i mohonte ato që në fillim duke mohuar heroin pozitiv dhe frymën artificialisht heroike. "Gjuha e Ezopit" do ta ndihmonte shkrimtarin gjithnjë e më tepër për t'i komunikuar lexuesit mesazhin e tij të fshehtë.

Edhe në romane që ngjanin si lartësim i "realitetit socialist" si "Dimri i madh" depërtonte fshikullimi i plagëve kryesore të diktaturës si "lufta midis të aftëve dhe të paaftëve" ku të paaftët dilnin fitues, atmosfera e padukshme e frikës, ndërhyrja brutale e partisë në jetën e individit, shkëputja gjithnjë më e madhe e udhëheqësit diktator nga populli.

Romanet e Kadaresë të shkruara në kohën e diktaturës, ndonëse të mbështjella me pelerinën e "realizmit socialist" janë në fakt vepra që ndërthurin realizmin me modernizmin.

Këto romane dallohen për një respekt tepër të veçantë për lexuesin të cilit ia lenë lirinë e interpretimit, deshifrimin e "kodit të dyfishtë", presin prej tij që të depërtojë në labirintin e formës tepër të lartë, elitare.

Është e vërtetë që ky elitarizëm në disa raste bëhet shkak që në labirintin e kësaj forme kritikët/lexues të humbasin rrugën, duke mos e gjetur dot "fillin e Arianës".

Më vonë Kadareja do të kalonte nga modernizmi në pasmodernizëm në etapën që njohu krijimtaria e tij pas viteve 90-të, etapë në të cilën do të shtohej ironia çmitizuese, pesimizmi në "vizionin e jetës" dhe "kodi i dyfishtë" do të ndërlikohej edhe më. Kjo etapë nuk do të jepte gjithnjë kryevepra, megjithatë në të mund të dallojmë vepra të realizuara, në vazhdimësi me etapën e parë si "Donfermani", "Piramida", "Pasardhësi" dhe dy romanet që shkrimtari i kushtoi vendlindjes së vet "Çështje të marrëzisë" dhe "Darka e gabuar".

Në rinovimin e romanit, Kadareja do të ndiqte një rrugë të vetën, të ndryshme nga ajo që do të ndiqte bashkëkohësi i tij Jakov Xoxa që edhe ai, nën pelerinën e konsumuar të "realizmit socialist" do të fshihte një realizëm kritik të një lloji të ri dhe do t'i drejtohej "sagës familjare", karaktereve të personazheve që dallohen për pasuri e shumëllojshmëri duke i pasur rrënjët në psikologjinë popullore.

Shkrimtari ndoqi atë rrugë që i diktonte individualiteti i tij krijues. Ai nuk e asimiloi modernizmin apo pasmodernizmin për modë, pati idealin e vet estetik. Rruga që ndoqi shkrimtari dha fryt se Kadareja e ngriti me krijimtarinë e tij romanin shqiptar në nivelin e romanit bashkëkohor evropian.

Për sa i përket "realizmit socialist", shkrimtari e pranoi, duke bërë një kompromis vetëm në dukje, për ta tradhtuar më mirë thelbin e tij. Ky kompromis i ngjante marrëveshjes së Faustit me demonin Mefistofel, marrëveshje nga e cila Kadareja do të shpëtonte si Fausti në saje të fuqisë krijuese. Lidhur me këtë mund të thuhet ajo që pati thënë Lunaçarski për Floberin, domethënë se duke qenë shkrimtar borgjez, ai ishte armiku më i madh i borgjezisë. Po kështu Kadareja, në dukje shkrimtar i "realizmit socialist", ka qenë armiku më i madh i këtij drejtimi artificial dhe të ngurtë, një shkrimtar jo vetëm modernist, po edhe modern në kuptimin më të lartë dhe më të plotë të fjalës.

BIBLIOGRAFI

1.R.M.Albérès, Histoire du roman moderne, Michel, 1962.
2.Jean Benoit, Nouveaux problémes du roman, Seuil, Paris, 1978.
3.Tefik Çaushi, Universi i Kadaresë, "Dajti 2000", Tiranë 2001.
4.Tefik Çaushi, Eros - dashuria dhe seksi te Kadareja, Ombra GVG, Tiranë 2004.
5.Milan Kundera, L'arte del romanizo, Adelphi edizioni, Milano, 1988.
6.Littérature et geures lettéraires, Larousse, 1973.
7.Georges Lukacs, La theorie du roman, Edition Gonthier, Berlin Spandau, 1963.
8.Adil Olluri, Romani postmodern shqiptar, UET Press, Tiranë, 2015.
9.Luan Topçiu, Tradita moderne në letrat shqipe, Zenit Editions, Tiranë 2010.
10.Prof. Alfred Uçi, Grotesku kadarean, Onufri, Tiranë, 1999.

Përmbledhja "Në botën magjike të Henrit" e Anila Mullahit (Elezi)

LETËRSI PËR FËMIJË NGA NJË STUDIUESE E NJOHUR

Nga Eni Myrtollari

Letërsia për fëmijë është krijuar, historikisht dhe në masë të madhe, nga të rritur: shkrimtarë të cilët trillin e kanë zeje, mësimdhënës, që e njohin mirë psikologjinë e fëmijëve prej profesionit apo prindër (me të gjitha atributet e pararenditura), të frymëzuar nga kureshtja e fëmijëve të tyre për të zbuluar botën. Ky është rasti i pedagoges Anila Mullahi (Elezi), Profesor i Asociuar dhe pedagoge e Letërsisë së huaj në Universitetin e Tiranës.

Në të vërtetë, përmbledhja me 12 përrallëza të lidhura me titullin "Në botën magjike të Henrit" nuk është e para punë e autores në këtë fushë. Pas përvojës si hartuese e mjaft teksteve shkollore për arsimin 9-vjeçar dhe parauniversitar, ajo ka hedhur bazat e një libërthi të mirëmenduar nga pikëpamja artistike - çfarë duan fëmijët - dhe didaktike - çfarë u duhet fëmijëve. Si studiuese e letërsisë, ajo është njohëse shumë e mirë e llojit specifik të përrallës, çka ka ndihmuar konkretizimin me mjete gjuhësore të situatave të trilluara.

Përrallëzat mund të ndahen lehtësisht në disa grupe, emërtimet e të cilave kanë buruar nga vetë teksti e do të përdoren posaçërisht për të.

Në grupin e parë dallohen *përrallëzat me "nuancë fabulash"*, pra krijime ku mesazhet edukative jepen vetëm përmes kafshëve, të cilave u janë dobësuar apo "zbutur" karakteristikat a tiparet klasike që jemi mësuar t'u vishen. Për shembull, fëmijë e prindër do ta diktojnë sakaq se dhelpra nuk është më dinake, peshkaqeni aspak i frikshëm dhe luani nuk cilësohet mbret i xhunglës. Gjithsesi, "nuanca e fabulës" dallohet ende te mbartja e tipareve dhe sjelljeve njerëzore, që nuk është shmangur si element tipizues. Është e lehtë të renditen këtu: "Dhelpra e kuqe dhe vjedulla", "Delfini dhe peshkaqeni", "Peshku marrok", "Luani që ia mblodhi një kokërr rrodhe".

Grupi i dytë i *përrallëzave me "ngjarje të vërteta"*, përfshin: "Gjembat e iriqit", "Breshka dhe vajza", "Elefanti mëngjarash", "Ketri i vogël që mori sanduiçët e fëmijëve", "Fshatari dhe kërmijtë", ku autorja është kujdesur t'u mëshojë mesazheve të rëndësishme me fjalorin e duhur, si: familja si bërthamë, ndihma ndaj të tjerëve, krijimi i miqësive mes fëmijëve që në moshë të vogël - edhe me shokë/shoqe të ndryshme nga vetja - kujdesi për të pangjashmit etj. Në tetë faqet e përrallës "Kallamari gjigant dhe djali i vogël", vërehet qartazi se autorja Anila Mullahi (Elezi) ka krijuar një dyshe të mrekullueshme personazhesh me cilësi të përkundërta (një Guliver dhe një liliput, ose, me gjasë, metafora që fshihet pas tyre) për të sjellë sërish në vëmendje idenë e pranimit të të qenit apo të të ndierit i dallueshëm nga masa: i vogël në mjedis gjigantësh dhe gjigant mes të vegjëlve. Baraspesha (lajtmotivi) gjendet vetëm te pranimi i tjetrit dhe i vetes.

"Në botën magjike të Henrit" formon një grup të tretë, të fundit, të *përrallëzave me "tis klasik"*, si: "Balloja e madhe nënujore" dhe "Djali që e shpëtoi Babagjyshi". Këto janë krijime të pakoha për shkak të personazheve dhe të skenës ku zhvillohen ngjarjet. Festimet ndodhin si nën ujë, si në dëborë, dhe ekzistenca e Babagjyshit apo e një çifti kuajsh deti që fitojnë konkurse vallëzimi domosdo që s'do të vihet në dyshim nga fëmijët.

Përpos këtyre, duhet theksuar edhe një konstante që cik të gjitha përrallat: natyra si vendndodhje e përhershme, pavarësisht nëse historitë ndodhin nën ujë, në fusha apo mjedise urbane. Thyerja e përmasës së ngurtë të toposeve të mirënjohura nëpër përralla (shtëpi, klasë, kala, kështjellë) u ka dhënë atyre lehtësi dhe hapësirën e nevojshme për të nxitur imagjinatën.

Mesazhet e shkrira nëpër përrallëza, si dhe vetë ky libërth i bukurilustruar duket se ka qëllim kthimin te libri, te natyra, zhvillimin e imagjinatës dhe të aftësive krijuese, krijimin e raporteve miqësore, si mënyrë për të shmangur bulizmin, veçimin e fëmijëve a frikën e tyre sociale.

THESI

Tregim nga Mehmet Elezi

Treni u rras në tunel. Uturima mbi shina ndihet më fort. Kaplon errësirë e dyfishtë, e tutshme. Vajza jonë e vogël cijat: mami! Ndizet një llampë e hajthme në fund të vagonit. Të tjerat me gjasë janë djegur. Ose është dëmtuar rrjeti.

Vagoni ka disa ndarje të vogla, si punë kabinash.

Rrugina mes ndarjeve, e muzgët.

Nëpër rruginë nis me u rrokullisë një hije e stërmadhe, rrumbullake. Hija ndalet te ndarja jonë. Re lëmshore, na e zë edhe atë pikë dritë që kullon prej llampës në fund të vagonit. Shtyn derën, ka vend këtu? Zëri i vorbët. Nuk dihet kah del.

Nga ndarja ngjitur dikush bën dritë me telefon. Hija e stërmadhe qenka thes. I nxirë. Në shpinë të një burri. I është kapur diku nën zverk, mbi një palë shpatulla, që nuk shihen. Nën të duken vetëm dy këmbë të gjera, kërcinjtë e thatë deri afër gjunjëve. Këmbët eshtërore, futur në dy këpucë të çafaretuna, si korita. Përlyer me baltë të vjetër.

Mullar vetëlëvizës.

Ime shoqe zverdhet. Në ngultë këmbë me hy në ndarjen tonë, ky na shtyp të tre. E mbështjell vajzën me krahë, e fsheh në parzëm. Të ka mami shpirt.

Për fat masa e vrugët ndërron mendje. Kthehet shllap-shllup rruginës së vagonit. Në të djathtë shtyn një derë. Aty janë dy studentë të përgjumur, djalë e vajzë, me kufje në vesh. Hija shqipton ka vend këtu? Djali lëviz buzët. Nuk ndihet çka thotë. Ose nuk thotë gjë fare, këndon karaoke. Afron buzët te vajza.

Përmjedis vagonit rrokulliset një send i verdhë, bija jonë përplas duart: portokalle! Kokrrat e verdha shkëputen nga thesi i stërmadh, nga një, nga dy. Rreknehen përmes ndarjeve me udhëtarë të rrallë. Portokalle s'ka tregu qyshkur, nuk gjinden në asnjë shitore. Janë të xhaxhit, thotë ime shoqe. Të blen mami kur të zbresim. Ajo e rren vajzën. Ajo s'ka dëshirë me e rrejtë.

Njeriun nën thes nuk e shqetësojnë kokrrat që pikin. Mos po i hedh vetë? I lehtohet barra.

Treni tundet nëpër tunel. Tuneli tundet nëpër terr. Terri tundet nëpër botë.

Një portokall kapërcen derën e ndarjes sonë. Vajza e vogël zgjatet me e marrë, pasi këqyr si fajtore nga ime shoqe e nga unë. Ime shoqe hap gojën me i thanë prapë jo, janë të xhaxhit. Kokrrat e ndezura rrumbullake vazhdojnë me u rrëzue, hija lëmshore kthehet mbrapsht e largohet. Disa qenie zgjatin duart me i kapë, u shihen vetëm gishtat, lëvizin si hardhuca. Mes duarve portokallet ndërrojnë pamje. Bëhen ngjyrëguri, ngjyrëplumbi. Qeniet i lëshojnë, s'i mbajnë dot. Portokallet bien duke kërcitur në fundshtrojën e vagonit. Njerëzit që i prekën marrin frymë të lehtësuar. Janë shumë të rënda, tepër, apo shumë të nxehta, tepër? S'e vumë re ngjyrën e peshën e tyre, jemi të lodhur e të përgjumur. Jemi të uritur. Kokrrat e rrumbullakëta, të rënda tepër ose të nxehta tepër, hovin si me magji. Drejt e në thes, ku patën qenë!

Treni del prej tunelit. Merret vesh nga zbutja e zhurmës. Zhurmën e thith ajri, si sfungjer. Jashtë tunelit e njëjta errësirë. Zbresin do udhëtarë, hipin do të tjerë. Hija kataroshe afrohet me zbritë, ka vend këtu? Terri nuk përgjigjet. Gjithçka ka ndryshuar, thotë hija. Nuk njoh kurrgjë. Nuk njoh kurrkënd. Dhe nuk shoh.

Treni hyn prapë në tunel. Tuneli është i gjatë.

Mes për mes vagonit një patrullë policie. Hija e hutuar përballë tyre. Ti pse nuk zbret, i thonë policët. E ke kryer dënimin, je i lirë. Nuk e di, thotë hija. Vitet i kam të gjitha këtu. Më kanë zënë përfund. Vitet e burgut leri prapa krahëve, ke mbaruar punë me to. Nuk e di cilat janë të burgut, thotë hija. Më janë përzier. Në këtë thes janë bashkë vitet e burgut dhe vitet pas burgut. Janë bërë njësoj. Lëshoje atë thes dhe fillo nga e para. Ah, po. Po e lëshoj, por nuk po më lëshon!

Thesi i rrumbullakët, i haparavun, afrohet prapë te ndarja jonë. Brumbull i nxirë, fryhet e fryhet, e mbush krejt hapësirën e vagonit. Ka vend? Ku ka vend aty, o rob, ia kthen dikush. S'i ke sytë në ballë? As këtu s'ka vend. Jo, jo, s'ka.

Rrakazhdak treni.

-Zbrit në tokë me tërë atë thes, na lemerise!

-Ku është toka?

Tuneli gjarpër i gjatë.

NE SHPIKNIM PËRRALLA

Cikël poetik nga Shqiponja Axhami

ATËHERË

Ne të vegjël ishim naivë,
Ndërtonim aeroplanë me gazeta,
Pretendonim që në kokë nuk kishim morra
Dhe ushqeheshim me fruta të pabëra.
Kurrë nuk mundëm ta gënjenim
Të verbërin Sh. që shiste karamele
Ku në vend të monedhave i jepnim tapa
birre.
Ne dikur ishim naivë, deri në përsosje.
Kacavirreshim nëpër arra, si lozë kungulli
Dhe shihnim me kokë poshtë, nga
perëndimi.
Naiviteti ynë tani është shpërbërë
I verbëri Sh është shtrirë myshk mbi rrasë,
Ndërsa huti nxjerr mbi të grahmë.
-O perëndim, ti verë e helmët, më thuaj;
Në cilin lum Karonti i vozit të mjerët ?
Duhet të jem aty dhe unë, me një obolus
të vetëm
Për të blerë një biletë të lirë për në botën e
përtejme...

FERMA

Janë të trishtë fshatrat pa pemë.
Fshati im kishte shtëpi akoma të
pandërtuara,
me pemë të sapo mbjella.
Ndërsa një fermë poshtë tij na joshte,
me parcelat plot me fruta.

Pas vjeljes së parë dhe të dytë
parcelat me fruta liheshin të lira
dhe ne mund t'i mblidhnim pa frikën e
rojeve,
degët e larta me frutat e mbetura.
Si shumë të tjerë unë shkova me nënën
Mbushëm një thes plot me kumbulla.
Por një roje teveqel, nga ata zhurmuesit,
erdhi duke ulëritur, na i mori të gjitha
dhe i hodhi në mesin e fierit.
Nëna më qetësonte
"Mos u mërzit , do kthehemi
do i marrim"
Por roja që me sa duket,
po i fshihte për vete, e kuptoi.
I nxori nga fieri, i derdhi,
Dhe filloi t'i shkilte.
Kishte mbathur këbale të rënda ushrie,

Mes lotëve dhe mërzisë
Shihja shkatërrimin e frutave
Poshtë këpucëve të ushtrisë.
Që nga ajo ditë,
Nisa të shkruaj poezinë

RITUAL I PËRJETSHMËM

I

Pranverat ishin kohët e nisjeve, majave.
Të fisit tim jetonin gjysmë viti në stane
Damkosnin me katran lëkurat e deleve.
Çdo shenjë kumtonte simbolin e fiseve
Mbathnin mirë kuajt,
Siguroheshin për misrin.
Në kuajt më të fortë, hypnin të vjetrit,
Ndërsa pas tyre vinte rreshti i mushkave,
gjedhëve, gomerve.

Nuk ishte e rastësishme
Harmonia e këngëve të bilbilave,
Oshëtimës së shpateve, zugatjes së bletëve,
Klithmave të shqiponjave, fëshfëllimës së
pishave
Me tingëllimën e patkonjëve të kuajve,
Zilklat e këmborëve, të qeshurat e fëmijëve
Tingujt metalik të sinive, cingeve,
shtamave,
Të qarën ngazëllyese të ndonjë foshnje.

Ndodhte që ndonjë pelë e re
Nuk i bindej shalimit.
Vraponte e pabindur anash kalvarit,
Krenare, me të voglin e saj të parë në bark.
Vonë kalvari i tyre mbërrinte.

Poshtë kroit të kuq, në ahishtë
Mbi mëndafshin e gjelbërt të një lëndine
Uleshin të lodhur stanexhinjtë.
Nën dritën ngjyrë mushti të muzgu
Shndërrsnin zjarret, duke ngrohur çerepët.
Duhej të piqeshin bukët....

II

Rituali i zbritjes ishte i njëjtë
Vetëm se dhentë i dorëzoheshin
gërshërëve,
Dallimi i shenjave prej zifti humbiste.

Fëmijët vinin të gjithë erë rrëshire.
Të moshuarit fshinin ndonjë lot në heshtje.
Gratë lidhnin me lak të fortë shekat e
bylmeteve.

Ishte po ajo harmoni muzike,
Këngës së bilbilave dhe tingujt të
këmborëve
Ndërsa pela e pabindur urtohej, i gëzohej
Të voglit që e ndiqte pas
Dhe u bindej dy shtamave mbushur plot
më hirrë...

Në vend të një parathënieje

Nga Rudolf Marku

Duke lexuar librat poetikë të viteve të fundit, mund të them se Poezia Shqipe ka dhe një rreth autorësh relativisht të rinj në moshë, zakonisht autorë që janë afirmuar pas viteve Nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, që krijojnë një përpjekje serioze për të shkruar një poezi tjetërsoj nga ajo që është arritur deri më sot. Në këtë rreth poetësh, - për mendimin tim më të talentuarit, më të plotët, më të artikuluarit poetikisht, më të qartët në synimin e krijimit të një poezi bashkëkohore, moderne - janë emrat e Luljeta Lleshanakut, Edvin Hatibit, Arb Elos, Rudian Zekthit dhe Shqiponja Axhami Trotës. Duhet thënë se disa prej këtyre qëndrojnë ende në fazën eksituese të eksperimenteve.

Natyrisht, në këtë bashkësi emrash, secili paraqitet me individualitetin e vet dhe personalitetin e vet poetik. Por të bashkuar në një mohim pohues për hir të asaj çka besohet se është poezia e sotme bashkëkohore.

Shqiponja Axhami Trota vjen me këtë libër të ri poetik, që mban një titull më se të zakonshëm

"Këngë për brezin tim" - pasi ka botuar një libër të mëparshëm të suksesshëm "Zoti zbret mbi Jaseminë" në Anglisht dhe në Italisht.

Këtë radhë poetja, ndryshe nga libri i parë i saj, duket se nuk ka frikë ta shkruaj poezinë me fjalë të rrafshëta, tokësore, antisentimentale. Poezitë janë më së shumti mbresa nga fëmijëria:

Ndaj ne mësuam herët/T'i bënim ballë errësirës

E zakonshmja e përvojës së fëmijërisë gjithmonë kthehet në një përvojë të dhembshme universale. Poezitë e këtij libri kanë një intensitet shpirtëror -gjuha ringjallë kujtimet e fëmijërisë, përmes fjalësh të përulura, por me imazhe dhe detaje që të godasin përnjëherë, shpesh befasishëm, por me një befasi të cilën lexuesi ka qenë në pritje.

Po të parafrazoja një kritik të njohur amerikan, Shqiponja Axhami Trota u përket atyre poetëve të rrallë, të cilët janë në gjendje që ujin ta shndërrojnë në gjak.

DITA E VERËS

Shelgjet, sythet e para të marsit dhe
manushqet
Ishin misoni ynë në Ditën e Verës.
Lëshoheshim si qengja shpatit të kënetës.

Prisnim me biçakë degë të holla shelgjesh.
Kërkonim poshtë dushqeve, manushaqet.
Hapnim me duart e vogla pllakëzat e
dëborës
Dhe zbulonim papritur fole vezëzh.
Një mars, pas një dimri të gjatë, u
stërlodhëm.
Mezi gjetëm degëza me sythe shelgjesh.
Duhej nga një për secilin pjesëtar të
familjes.

I morëm një nga një shpatet e kënetës.
Në fund, duke mbajtur lart krahët e lodhur,
Degët e shelgjeve nuk duhej preknin
tokën,
Ndryshe kurorët e tyre vënë në Ditën e
Verës
Nuk do e merrnin me vete dhimbjen e
kokës,

U ulëm mbi një shkëmb, bri kënetës.
Një zhurmë e tmerrshme na kalli frike.
Zemra na këput, si frut brinjëve
Dhe degët e shelgjeve u shpërndanë mbi
dhé.
Dikush kishte hedhur dinamit në liqe.

Për një copë here nga larg pamë
Një peshkatarin që gajasej duke na thënë,
"Ejani, pa frikë, ka dhe për ju, fëmijë"

Kureshtjes prej fëmije iu afruam, por me
frikë
Rreshta peshqish të mëdhenj, të vegjël, të
pajetë
Me sy hapur, me sy mbyllur.
Kishte prej tyre që ende frymonin.
Në ngjyrë blu të hapur, në vjollcë të
mbyllur,
Barqe të qara plot me vezë.

Mantel i lotëve na u mbështoll syve.
Ia mbathëm duke qarë kodrinave.

Që nga ajo ditë një dhimbje koke
Do na shoqëronte gjithë jetën
Dhe një breg më peshq të pajetë,
Nga forca e dinamitit...

NE SHPIKNIM PËRRALLA

në ditën e varjes së poetit H. Nela

Të qeshura si zilka i trondisinin
mollëkuqet mbi sherbelë.
Duart e vogla si turma peshqish
koloviteshin gjetheve.
Duhej mbledhur ajo bimë përpara së një
erë kërcënuese
T'ia shkërmoqte gjethet, ndaj zgjoheshim
herët,me natë
Kështu niste misioni ynë më i vështirë;
Mbledhja e luleve,
Ndarja në tufa të barabarta
Lidhja e tyre me njërin prej kërcejve
Palosja butë në togje,
Renditja pa shumë forcë në fund të
thasëve,
Dhe zbritja në qyetet për shitje.
Ishte gusht.
Atë ditë nuk shitëm asnjë tufë.
Dyqani ku shisnim lulet ishte mbyllur.
Nisëm rrugën e kthimit kokëvarur.
Në mes të qytetit shtangëm.
Pamë një njeri të varur, në një pemë.
Mes lotëve, shkoqitëm gjithçka;
Trupin e pajetë, kokën e anuar,
Pak shkumë mbi buzë.
"Ç'duhet të ketë bërë"
Theu heshtjen e vogla Marë,
E gënjyem;
"I ka hequr karrigen mësuesit - i thamë
Dhe u larguam të mpirë
Të nesërmen ne zbritëm prapë në qytet
Për të shitur sherbelen.
Njeriun e varur nuk e pamë më.
E vogla Marë pyeti prapë
"Ku e paskan çuar"

Atëherë unë nuk durova më...
U ula në gjunjë pranë saj dhe shpika një
përrallë;

"Atë njeri e kanë marrë disa zana të
bardha.

E kanë vënë mbi një tufë dëllinjash të thara.
Me zjarrminë e një ylli në rënie, kanë ndezur një zjarr të madh.
Hirin e tij e kanë futur në një trastë mëndafshi
dhe e kanë shpërndarë mbi një fushë të madhe me sherbelë…”
Mara shikoi nga trasta,
Atë ditë ne i shitëm të gjitha...

BURRAT E RAKISË

Moskokëçarës ndaj frazave biblike,
Riteve pagane, Budës, Solomonit,
Lëvrinin si një tufë luanësh
Breda hekurave të kurthit.
Nuk e mësuan që nuk e mësuan teorinë e Marksit.
U fishikullonte në veshë,
Thupra ndër duar e njerzve me uniformë
Por nuk deshën t’ia dinin, pinin.

Rreth një tavoline lyer me bojë të kuqe.
Mbulesë vinin gazetën “Zëri i popullit”
Dhe mbi karrige shtronin lëkurën e qengjit.
Pinin, flisnin për librat e ndaluar,
Gratë e bukura dhe vetëvrasjet.
Pinin, pinin, qeshnin, shanin.
I mburreshin malit përballë.
I premtonin njër-tjetrit që do i ngjiteshin,
Burimet do t’i shkallmonin kraharorit

Ne mbështetur mbi duart në formë V-je
I shihnim nga poshtë, ulur në dërrasat,
Që pritnin për t’u bërë dyer.
Tulipanë të flirteve të tyre me gratë e ndrojtura
Ishim kaq të thjeshtë, kaq të mahnitshëm,
Gjysmë të dehur, gjysmë protestues
Mali përballë përpëlitej, si një elefant i injoruar
Ndërsa mbi burrat e rakisë,
Binte polen i luleve të kumbullës…

MBATHËSI I KUAJVE

Shtati i tij i imët përkulet poshtë,
Kuajt e tij janë të fortë, të lartë.
Merr me delikatesë këmbët e tyre,
Pastron me kujdes thundrat.

Vendos patkojtë, saktë, në qendër.
I mëshon danës,
Ngul një nga një thumbat.
Herë pas here hedh sytë nga udha.
I vogli i tij do të vijë.
Ai i sjell çdo mesdrekë bukën.
Bie shi.
I vogli futet në guvën e lisit
Duke shtërnguar fort trastën,
Bukën e elbit dhe dhallën.
Ai sheh prapë nga udha
I vogli shfaqet, i lagur,
Hundskuqur, por i qeshur.
I vogli përkulet si ai, e ndihmon.
Ka mbetur dhe një këmbë.
Ai përtyp bukën e elbit,
Duke kundruar të voglin, kalërimin e tij,
Paepërsinë ndaj erërave.
Ndihet i ngopur,
Sa nga brinjët e tij
Shpërthenjë kallinjë elbi
Dhe shtrihet i lumur fushnajë…

VDEKJA E BABAIT

Im atë bënte me një saktësi të mahnitshme
Shpënzimet e shtëpive, mureve, avlive
Dasmave, morteve.

Ditën që vdiq m’i nguli sytë thellë.
Më pas i hodhi mbi një shkrepse mbi tavolinë
Në kapakët e së cilës kishtë bërë llogarinë
E mbjellës së një parcele me hardhi
Pajisjeve të një kantine vere dhe ndërtimit
Të një lundre…

Shazim Mehmeti

Vera e fluturave

(fragment romani në proces)

1.

Këmbët e mia janë të thara, si dy degë karthie.

Përtej dritares, n’oborr, ka çelur trëndafili i kuq, por unë nuk e shikoj atë. Unë e shikoj, atje lart në qiell, atë trëndafilin e bardhë prej réje, dhe ndër mend më vjen një gjë: gjithë kujtesa ime fillon me një ëndërr...

Lart, në katin e dytë të shtëpisë së vjetër, në katin ku ishte vetëm një dhomë fjetjeje dhe një çardak i madh e i hapur, në një kënd të të cilit ishin të vendosur hambarët e drithit, gjithë verën e verës, im gjysh, ime gjyshe dhe unë, gjumin e bënim atje. Dyshekun e grisur me katrorë të kaltër, e shtronim mbi hambarët, syprina e drunjtë e të cilëve shtrihej horizontale, nja një metër e ca mbi nivelin e dyshemesë së katit. Nga përpara, gjithë çardaku ishte i hapur, në drejtim të jugut.

Anësh ishin muret e trasha të shtëpisë, të muruara me do gurë, që kishin një ngjyrë të gjelbërt në të përhime. Po në drejtim të jugut, shtrihej edhe oborri i shtëpisë sonë, oborri i rrëpijtë e i gungaftë, që, po në jug, kufizohej me oborrin poashtu të rrëpijtë e të gungaftë, të fqiut tonë, dinakut A.

Dy oborret i ndante rrjedha e lakadredhtë e përrockës, që kushedi ku niste diku, në kodrinat e malit TH.

Shtëpia jonë e vjetër, në katin përdhesë kishte vetëm një dhomë katër me katër, një hajat të gjërë, si dhe ahurin e lopëve, kalit dhe buallicave.

Dera e dhomës së vogël dhe dera e ahurit, ishin aq afër njëra tjetrës, sa, kur hanim darkë në dhomën e vogël, përtej murit ndarës, tutje nga ahuri, i dëgjonim edhe lëvizjet më të vogla, që bënin kafshët n’ahur. Nuk di për të tjerët, por unë, edhe aq i vogël sa isha, arrija që, nga ahuri përtej murit ndarës, ta dëgjoj e ta ndijoj edhe lëvizjen më të vockël të kafshëve. Madje, shpesh më bëhej, sikur arrija ta kapja edhe fërfëllimën më të vogël të lëvizjes së bishtave të tyre, por edhe buzëqeshjen e ëmbël të viçave tanë.

Asokohe, klima nuk ishte e përzier si tani. Asokohe, stinët e vitit ishin të ndara si me brisk, dhe rrallë ndodhte, stina stinës t’i huazojë një javë a dy. Pranvera ishte pranverë, vera ishte verë, vjeshta ishte vjeshtë, e dimri dimër. Verat, ditët i kishin të nxehta, dhe dielli mbi ta, piqte si me saç të hekurt.

Por netët, mbi hambarët në çardakun ku flenim, unë, ime gjyshe dhe im gjysh, ishin të freskëta e të këndshme për gjumë, ndaj ky ishte shkaku, pse treshja jonë gjithë verën e verës flenim atje.

Tashti të kthehem te ëndrra, ku, siç thashë, fillon gjithë kujtesa ime.

Do kem qenë, atëherë, rreth gjashtë vjeç. Kishim rënë në gjumë, në çardak, unë gjyshja e gjyshi. Kishim fjetur, nuk e di sa, kur befas, para syshë më dolën pesë shpezë të bardha e të bukura, që nuk di ç’ishin. Kishin një ndërtim anatomik si të patave, por nuk ishin pata ato shpezë. Ishin ca më të mëdha se patat, dhe gagatnin lëvizshëm mbi dërrasat e çardakut.

Ja, po them se ishin pata. Pendlat i kishin prej një bardhësie të paparë, dhe këmbët të një verdhësie të dendur. Kishin ca sqepër, poashtu të verdhë e të gjatë, por disi më të gjërë.

Ndjeva, në zemër, një mrekullim ngazëllyes, dhe fillova t’i ndjek. Patat, lëvizën teposhtë shkallëve të drunjta, drejt hajatit, në përdhesë. Shkallëve rrëshqita edhe unë, duke i ndjekur këmbakëmbëz. Poshtë në hajat, u gjeta tamam midis të pestave, por ç’e do, kur, për një çast të vetëm, të pesë krijesat e bukura u zhbënë e u tretën në thellësinë e territ.

Ky qe çasti kur mua më doli gjumi, i gjetur fillikat i vetëm, përpara derës së ahurit. U frikova shumë, dhe as vet nuk di si arrita të ngjitem shkallëve, këmbadoras. U ngjita disi edhe mbi hambarët, dhe i frikësuar, u futa nën jorgan, si mi. Atje, nën jorgan, i shtrirë në kokërr shpine, e dëgjoja zallamahinë e tamtumeve të zemrës sime të frikësuar, që rrihte pa pushim.

I frikësuar tejmase, nuk mund të flija. I shtrirë në kokërr shpine, rrija pa lëvizur, që të mos i zgjoja pleqtë. Gjithkah përreth, zotëronte një qetësi e shtrirë, që shoqërohej me fërfëllimën e natës, kurse tutje, përtej anës së hapur të çardakut, e përtej oborrit të fqinjit A, larg si në përtejjetë, vetmonte një copë e kuqe hëne, dhe një ré e bardhë dhe e largët në formë trëndafili, që mezi dukej në hapësinë e natës.

Atë natë, gjithë anësitë e qiellit, ishin të veshura me një të përhime të plumbtë.

Nuk më vinte gjumi, dhe mendja më fluturonte, herë te krijesat e bardha që pashë në ëndërr, e herë te shkaku, pse më quanin trubuall. Nata më bëhej, e gjatë e gjatë, si asnjëherë më parë.

Në një çast të lodhjes së gjatë të pagjumësisë, sikur m’u lëvarën qepallat, dhe vërtet do të kisha fjetur, por nuk kishte pas qenë e shkruar.

Ja ç’ndodhi:

Së pari, dëgjova fëshfëshin e jorganit dhe fëshfëshin e mustaqeve të gjyshit, pastaj pashë një lëvizje nën’jorganshe të tij drejt gjyshes, pastaj pashë hënën si i hapi sytë e i lëpiu buzët, pastaj pashë uljengritjen e shpeshtë të jorganit shushuritës, pastaj sërish e pashë hënën e buzëqeshur, pastaj e pashë sërish ngritjeuljen e jorganit dhe e dëgjova rrënkimin e ëmbël të natës, pastaj pashë ca rrëshqitje rrafsh mbi rrafsh të petëzave të natës, pastaj dëgjova kollin e njohur të gjyshes, pastaj pashë qafën e gjatë të gjyshes që u zgjat drejt natës, pastaj pashë gojën e saj që u hap e u stërzgjat drejt qiellit, dhe o Zot, o Zot, në fund pashë edhe një grumbull fluturash, që i dolën gjyshes nga goja, dhe me krahët e tyre të jargavantë, fluturuan drejt jugut.

Atë natë, nuk fjeta gjatë, gjithnjë duke e parë hënën e kuqe dhe atë rénë e bardhë e të vogël të trëndafilit në qiell, dhe duke e vrarë radaken time për fluturat e gjyshes, për fluturat që i dolën nga goja, e që ishin të një ngjyre të jargavantë, bile shumë më të jargavantë se vetë e jargavanta e luleve të jargavanit tonë, në oborrin e rrëpijtë.

Pas gjithë asaj ç’pashë, ç’ndjeva e ç’përjetova atë natë, më në fund, kisha fjetur si këlysh.

Por, të nesërmen, i merakosur fort, sapo e takova gjyshen me duart bardhë me miell e me kallmin e piteve ndër duar, ia bëra këtë pohim: “Gjysheee, ti je e sëmurë nga një sëmundje fluturash!... Të duhet mjek!...“

2.

Kujtesa është si një kënetë në ranishtë, që ditë për ditë zhbëhet, nga dielli i madh i stinës së gjatë të jetës. Ose, edhe si fletët e atij trandafili të kuq n’oborr, që ditë për ditë vyshken, e zbehen, e bien përtokë.

Kështu më vjen e zbehur dhe e zhbërë edhe kujtesa ime, teksa qëndroj prapa kësaj dritareje, i tharë jashtash e brendash, si një cung. Pastaj dhe kjo erë, që frynë e frynë pandalur brenda meje, e që s’më lë dot t’arrij, t’i mbledh ato dromca të pakta kujtese, që kanë mbetur pa u kalbur brenda meje.

A nuk është jeta si vetë toka, që kalb brenda vetes gjithë ç’jep vet ajo?

E tillë është, është tamam e tillë: jeta është ajo tokë, që na e jep e na e ushqen kujtesën, por është edhe po ajo tokë, që na e kalb kujtesën. Por, përgjatë jete, janë edhe ca kujtime, që janë me ca veti, tamam si të kockave: nuk i kalb në tërësi as toka jetë.

Në tokën e kujtesës sime, dita kur i thashë sime gjysheje se i duhet një mjek për sëmundjen e fluturave, më ka mbetur e pakalbur, si një copkë ashti.

Ja pse: atë ditë ndërroi jetë stërgjyshi im. Sot, si në një shirit të dëmtuar filmi, unë e kujtoj fytyrën e tij të holluar e të zbehtë, mjekrën e bardhë si lule bore, krahët e hollë që iu lëvarën në çast, trupin kockë e lëkurë, që iu këput e ra si një zambak i vyshkur.

Dhe ia kujtoj atë nur, që i doli për goje e për syshë, në çastin që e la fryma: ishte diç, që doli e u shkëput prej tij, diç si një ré e rralluar dhe e derdhur, që i dilte, krejt e pangjyrë, por e ndieshme sa s’bëhet, ca prej goje, ca prej syshë, ca prej krahërori, ca prej këmbësh e ca prej duarsh.

Gjithë ai burrë, gjithë ajo jetë, për një çast të vetëm, u ndal e pushoi, si një orë e prishur.

Nga ky kënd dhome ku dergjem tani, unë pohoj zëshëm, se jetët tona s’janë gjë tjetër, veçse ca orë që punojnë, shërbejnë e vjetërohen, në një rrugëtim të pakuptimtë e të pafat, ku nuk ka asnjë orëndreqës; jetët tona janë orë, që në mungesë orëndreqësish, e kanë detyrimin, të prishen, me domosdo.

E, pra?... Dergj’ja është vdekja që jeton. Vdekja është prishja që s’ka të ndrequr.

Në ditën që vdiq stërgjyshi im, nuk lotuan njerëzit, por sikur lotuan qiejt. Lulet e sadojës në parmakun e çardakut, u lëvarën me kokë teposhtë. Edhe trëndafilat e kuq e të bardhë, gjethekrahë, u lëvarën me kokë teposhtë. Edhe mani i vjetër, poashtu. Oborri i rrëpijtë e i gungaftë, u mbush me njerëz. Dita mori një ngjyrim të përhimtë. Qiejt, edhe ata, sikur u rënduan përposhtë. Një shi i imët e i dendur binte pa pushim.

Mendoja atëherë, se ato pika shiu të pandalshëm, ishin lotët e qiejve, që qanin atë ditë, për njeriun e dobishëm, që ikte përjetë në përtejjetë.

Së paku, kështu më dukej mua. Kisha dëgjuar se shpirtrat e njerëzve të vdekur, nuk shkojnë kund tjetër, pos në qiell. Dhe i mendoja qiejt atëbotë, si një përbërje të gjatë e të gjërë pa fund, si një përbërje shpirtërash, të ikur atje lart, përgjithnjë. Dhe thosha me vete, se bota e shpirtërave të ikur atje lart, qajnë për stërgjyshin tim, në mungesë të një qarjeje njerëzish.

Për një çast, se si m’u duk se në një cep të oborrit e pashë edhe stërgjyshen time, stërgjyshen time që kishte vdekur qëkurë, kushedi sa vite para lindjes sime.

Kuptohet, do ketë qenë vetëm imazhi që kisha krijuar për te, nga një foto e vetme letërnjoftimi, që kisha parë. Por, unë sikur e pashë vërtet: ishte imazhi i saj, që qante e derdhte lotë, veçuar nga të tjerët.

Nuk di pse, por atë ditë, varrosjen e stërgjyshit tim, unë e shikoja, si punën e një farëze luleje që e mbjellin në tokë. Ose, si mbjelljen e një fidani, që, një ditë, domosdo do rritet, do çelë e do lulojë, si shumësia e bimësisë që mbillen në tokë. Ose, edhe më pak se kaq: si një trup të vogël, të mbetur më shumë asht se mish, që do ta plehërojë tokën, i shkëputur përfundimisht nga aureola e shpirtit të tij, atij shpirti që ik e struket atje lart në qiell.

Vonë vonë, në këto vite dergj’jeje, se si shkrova një ese të vogël...

ARBËR V.: NJOLLAT E HIRIT PAS SHIUT TË AKULLT

Në kushtim të Prindit dhe 17 Janarit

Tregim nga ***Enver S. Morina***

V (O) PARATHËNIA

Në çdo shkëputje të këpucës nga toka dhe vënies së tjetrës në tokën me barë të thinjur, ndieja herë një lehtësim e në çastin tjetër frikë përzier me akthin e hapit të mëpasmë. Ku do të shkel këmba tjetër! Mos të ftohtit e madh kishte ngrirë gjithçka? Kthimi i ç'akullt më i rrëshqitshëm! Një boshllëk muror i katandisur në gërmadhë. Pa çati mbi vete, shtëpia, ishte shndërruar në një humbëtirë të pakapshme. Dera e daljes i largohej shikimit! Kapërceva shkallët e rrënuara. Mbajta veten për murin plotë grafite. Munda të hyj në korridorin e parë, pas zikzakës jo të zakonshme të ecjes së këmbëve. Mezi u futa në dhomën e pritjes! U ktheva mbrapshtë me shpresën e një të përhumburi. Në pragun e kthinës, një çelës rënë nga varësja, kishte humbur identitetin. Gjithëçkaja thellohej në dromca intrige. Dhoma e martesës bashkë me studion krijuese ishin njëjtësuar në një shtresë madhësish të ndryshme nga mbeturinat e hirit të zjarrtë, pas shiut të akullt. Hyra në vetvete.

IV (I) EPILOGU I FILLIMIT

Dymbëdhjetë orë para mesnatës, kur ndërroheshin tre nëntëshe me tri zero, për të shkrirë numrin më të madh njëshifror në numrin e brishtë, kur njëshi me mund mijëvjeçar ngritët në dy, apo avullimi i 11 vijave e 2 gjysmërrathëve në vetëm 8 kunja (alias 1111+999) si frekuencë e daljes nga një shekull, nuk ka natë më unikat në historinë e njerëzimit (kjo llogaritje nuk vlen as po t'i kthehemi vitit 112 p. e. s. sepse vlen parimi i minusit), pas njëzet muajsh ecejakesh nëpër At(ë)Dhe mbërrini në fshat. I kishin mbetur vetëm disa çaste dhe Ai do të futet në oborrin e shtëpisë pa mundur kurrë më të hyj në të, siç ka hyrë gjithmonë me buzëqeshjen mahnitëse rinore. "Kurrë s'ia bëj hallall zemrës, pse s'më lëshoj, kur pashë fshatin e djegur!" - iu kujtua të ketë shkruar në një ditore bashkëvendori i tij, gazetar televiziv, Sadri Morina.

Frika nuk e mahniti. Ankthet e hapësirës e kishin djersitur. Tokës së kalldrëmtë i mungonin rrezet e acarta. Bunari i Madh lëshonte avullin sikur në të, të ishin futur disa duhangjinjtë që thithnin nikotinë nga më të egrit. Ishte këputur nga lodhja e syve. Shikimi i errësohej. Preku flokët. E kotë të përcaktonte vetveten se ku mund të arrinte nëse nuk e humb vetëdijen! Qershiza, në mes shitores, ishte shndërruar në një pikturë moderne që asnjëherë nuk e ëndërroj në peizazhet e tij. Me shpresën se do ta thërriste dikush, për ta nëmur edhe atë, u gjend në vendin e studios së kahershme. Nxitoj nga të gjitha anët për ta shterur sa më shpejtë vizitën si mysafirë në dhomën e tij të gjumit. Dëshmitarin e vetëm e kishin nxjerr me dhunë nga Bunari i Madh. Të qullur e sollën në vatrën e panjohur të dëshmonte djeg-jen. Në bisedë herë-herë përhumbej dhe harronte se ndoshta kishte qenë disa herë në atë shtëpi të veçantë nga të tjerat në fshat.

III (II) MONOLOGU I DIALOGUT

Për një çast u mësua me ngushëllimet e përtej harresës. Nuk ndjente keqardhje.

- Isha e vetmja shpresë për atë labirint kohor. Shkëputja nga studioja personale i ngjante një lindje foshnje nga shtatzënësia.- i dyfishohet zëri i shterur - *Ndoshta kam qenë i mahnitur me dozën e frikës apo nga një vegim që nuk ndieja dhembje për një kohë të gjatë.*

- Dardan Vita, a kush jeni Ju, me dy apo asnjë gjini (?!) -e ndërpreu- *harresa tek foshnja disamuajshe nuk ekziston!*

- Nuk më kuptoni se ky është krahasim?!

- Ndjehem i mahnitur se keni shpëtuar!

- Habitem se si u kthyet me vonesë kur kemi ikur tepër herët!

- Vetëm e vetëm që ti shpëtojmë sytë.

- Pse ende nuk i keni shitur?!

Për një çast pushoj, për të filluar:

- Gjeta këto fletë!

- Është nga ditari ditor. E vura re kopjen në hyrje të portës.

E shfletoj. Me zë ia kumtonte gjithësisë së zbrazët:

- "Pas dosjeve 22, të një fillimvitit A D G R K që shpërthej me vrasje konform një lufte të pashpallur kërkohet nëpër arkivat e mykur Dosja H. Sekretet futeshin në kthinat me të errëta. Zbulimi i ecejakeve fluturuese nxori deshifrimin paranoik se në Gadishullin Ballkanik të shpeshtën e herëve bashkëdyzoheshin copëzat e pasqyrave hijore në të njëjtin arkiv. Pikat e lotit të gjakut vërshuan platenë e WHITE HOUSE dhe Beli-Dvori-t! Mishi ishte hirnosur në imtësinë mikroskopike. H Hulumtonte Herë *Hipertekstin, Herë Hierarkinë Hijore të Humanizmit Homerikë në Humbjen Heroike të Helenës së Hamendur dhe të Historisë së Hiperbolizuar Holokaustiane!..."*

- ...Edhe si individ, edhe si kolektiv, edhe si çështje, edhe si trill në Ballkan, rreth tij dhe për të kishte humbje! (lëvizte duart) *... Eskili... Shqiptarët... Serembe... Historia... Rugova, në kuptimin toponimik. Darka e diplomacisë ShpresëKëputur.* (gishtin tregues e drejtoj në qiell) Më shumë se lodhja e muskujve e kishte mynxyrosur nxitimi i këshillave të diplomatit të huaj. Viktimat nuk numëroheshin! (ecte skaj me skaj oborrit) *Shokët iu kishin vrarë të gjithë kur u ul në karrigen lëvizëse të studios së improvizuar. Mendoj se humbiste shpresën e ringjalljes së këngës. Rapsodi së pari ngjyrosi sytë, më pas gjeti gruan e kërkuar dhe në fund u vra në pritë! Xhylërrushëhanëmi (Lizëantigonëzonja) rritë fëmijën në barkë dhe në nëndhe, vajton kurthin e zhurmës së armatosur dhe pret shpresën e humbjes antike. Të tëra këto në faqet e librit të ardhshëm të bashkëshortit. Palimpsestet shpëtuan nga djeg-ja e trurit të Mikut.* (me mimikën e çartur të fytyrës përshkruante tërë dialogun) *Lexonte pandërprerë romanin "Robinson Kruzo". E humbiste përcaktimin e fillimpërfundimit* të romanit. Siç tha një vizitor i përhershëm i Tij, ai shprehej se romani tashmë nuk kishte as fillim as përfundim! Ishte njëjtësuar leximi. Aty ku e ndërpriste leximin përkohësisht, aty e konsideronte se fillonte rrëfimin. *Bashkëdyzohej faqja e fundit me të parën dhe secilën herë në brendësi gjente diçka të re sa që Miku i të vrarit thoshte: "**Ne lexuesit jemi humbës të veprës aq sa autorit i ka munguar rrëfimi universal në poetikën e krijimit! Njëherazi jemi rindërtues post scriptum-"mortum" të veprave antike ...**"* (vërehej se nuk lodhej nga ecejakeja) *Me mijëra e miliona shtesa shpjegimesh, studimesh e kritikash do të ketë vepra e Homerit, Eskilit, Shekspirit e Getës aq sa humbja e mundshme e njërit prej tyre. As vet krijuesit* (nënkuptohet për së gjalli mendonte- vër. e A. V.) *nuk e besuan një simpati të tillë... Dëgjoni këngën!* (ndërroj zërin bashkë me mendimin) *I vdekuri apo Besa e Shtëpisë e solli Doruntinën!* (bërtiste) *Intriga e fictionit* të *Lorkës* për *Bernarda Alban dhe vajzat e saj në Shtëpi të mbyllur!* (mori frymë thellë) *Dorë(sh)krimi i kufomës, të verbuarit dhe Odiseut mbetën zvarrë nëpër shekuj për ta ndriçuar memoria e sotme dhe për t`i nxjerrë nga labirintet e Shtëpisë... Po mjaft! U lodha! E kotë tortura! Laookonti është kthyer në mermer! Ne që ikëm nga shtëpitë, që shpëtuam nga mesazhet e grafiteve* nëpër mure, nuk kanë me na *k'nue... Kanë me na kujtue!* (u bë sikur e kreu monologun)

II (III) DIALOGU I MONOLOGUT

Arbër Varri arriti nga kryefshati i qytetërimit t'At(ë)Dheut.

- Pikërisht kopja origjinale e deshifrimit nga shkrimi i dorës në një shkrim makine të pyetjeve të intervistës kishte qenë shkak për

djeg-jen tërësisht të shtëpisë. Autori i intervistës ishte në 64 fotografi. Menduan se bashkë me pyetjet zhduken edhe përgjigjet! Një dehje e çastit e kryepolicit, një antroponim i kapshëm real ekzistues i kërkuar nga i lëçituri, një antikë e vjedhur mijëravjeçare e gjetur në cep të fshatit (arkeologët hermanacionalitetesh hetuan se në arkivat e Beligradit mungonte një unikat i tillë), një çast momenti vegues nga fotografia e kalendar i Vitit 1981, nga një shkak i kësillojtë, vetëm e vetëm se shtëpia gjendej në fshatin që duhet djegur edhe përkundër propozimit të pronarit, para fillimit të luftës, që forcat e NATO-s të vendosen këtu, se monoteistet partiak shkrinë kohërat dhe mohuan një kuvend bashkimi ndërnjerëzor, çka banoret i futi në ankthet e frikës nga liria, qenë shkak?! Apo një...

Dardan Vita ndërpreu të folurit e ngarkuar me dyshime. Tretja e kuptimit të fjalëve kishte humbur në mendësinë e ndriçimit të se paku një ç'thurje varianti kritik.

- Urdhëroni! Uluni! - tha qetësisht.

- Fal'nderit! - ia ktheu Arbëri duke u ulur në një cung.

- Ishte fatalitet i vështirë, vdekje e thjeshtë për të besuar për shpëtim! - shpjegoj prezencën.

- Ç'i shtyri që ta djegin?! - pyeti çuditshëm.

- Zëri sikur dilte nga brendësia ime. Zhurma dhe zjarri tretej nga qenia jashtë kohës e vendit. Veten e projektoj si skelet, - rrëfente qetazi - *disi si piktor që i mungojnë ngjyrat e vizatonte eshtra. U mahniten nga kalendari i para 17 vitesh. Imazhi i vashës i çlironte nga ankthi kriminal. Grilat ishin errësuar nga vjetërsia e pluhurosur. 64 fotografi përballë saj sfidonin jetën 32 vjeçare të njëfarë Arbër Varrit, që e thërrisnin të dëshmonte fundin. Por e kotë. Mjaftonin ato fotografi që autori të ishte prezentë.*

- Ato ishin arsye të mjaftueshme bindëse?!

- Assesi! I dehuri erdhi rrëmbimthi. Urdhëroj e doli me shpejtësi prej të marri. Shfletonte disa fletë të daktilografuara duke i hedhur në ajër.

- Bije Vokshi nuk kaloj asnjë doganë për të marr pjesë në Bujan. Kohë pa itinerare. Postblloqet kurdiseshin në mendje! Në 60 vjetorin e Vitit të Ri të Rezolutës së firmosur nga shenjëvdekja, banorët heshtazi lëvizin nëpër galeritë e gjetura nëntokësore. Vizitorët iu kthyen shpellave antike. Puthja e Romeos dhe Zhulietës në mermerin ballkanik ishte ngrirë bashkë me pikat e lotit që kishin rrjedhur në mijëra vjet. Edhe para dashurisë së mileniumit të dytë! Pas gjithë mishit të djegur, ekzaminimeve, lojës me arkivole, vjedhjeve e obduksioneve, asnjë kufomë nuk u ngjallë. I mbuluari me qefin erdhi me dhunë, për herë të parë, në *kryefshatin P.! Të tjerët*

nuk mund të i iknin! Asnjë s`mund të varroseshin as në tokën e dheut të lindjes! DitëZi edhe nesër! - fliste pa shikimin e syve.

I (IV) PROLOGU I FUNDIT

- Hej, Ti i verbuar, pse ikni?!

- Një çast nxitimi është humbje ëndërrimi. As tash s'mund të besoj se si të 17 skedat arkivore të zhdukeshin si një shkrim me 17 vargje. Ashtu ndodhi në të kaluarën: Vdekja e Skënderbeut, Atentati në Undergrubenbah (18 janar: Jusufi vdiq nga plagët. Një gjysmë-vrasje-vdekje: tek intelektualet gjenial ndodh një gjysmëvdekje në fundin e tyre për një shkrirje fizike të një vazhdimësie shpirtërore! Prekja e eshtrave të Homerit, Jezusit apo Gërvallës: Ne e mveshim me të gjitha atributet krijuese intelektuale ndërsa përkundrazi veten e ç`veshim me klithjen: Eshtrat nuk flasin!), *Vdekja e Ndrek Lucaj, Fataliteti i irakianes së bukur në rrugën e natës dhe Vrasja misterioze në fiction e Kë De-së! Më vonë se ikjen nga kjo dynja Ata kishin humbur sytë bashkë me gjumin. Ëndrrën ia lënë trashëgim pasardhësve.*

- Ku gjenden skedat?!

- Të 17 vargjet poetike u dyzuan vetvetiu në 17 skedat arkivore të studios personale. Truri trandi përkohësisht perceptimin e jashtëm të errësirës së akullt ndriçuese!

Në mendje lexon skedat në një qetësi kuptimi të pazakonshëm:

17. Gjurmët e mitikes trojane *me* ***palimpsestet pas Apokalipses***

16. Foshnja në djepin e parë *me* ***letrën e diplomatit azilant***

15. Polisemia Jam shqiptar e kosovar *me* ***pjesën e Tretë të Poetikës***

14. Deshifrimet e mbrapshta kryqëzore IHO e HIZNOSYXV *me* ***hijen e klithmave të Ilirëve***

13. Rilindja e Alternativës së Botës Sot *me* ***Diellin e Sheshit të Republikës***

12. Follow me në Titanic *me* ***zanin e Naim F. në thepin e Bjeshkëve të Nemuna***

11. Toposet e murimit të dashurisë *me* ***heshtjen e krismave në gurë***

10. Emblemat e varreve *me* gëzhojat e lapsave në lëvozhgën e drurit

9. Gjenealogjia e Zotit tokësor *me* ***cullakun e lëkurës së Vashës***

8. Dialogët në amfiteatrin e brishtë *me* ***ligjëratat e censurës së fëlliqtë***

7. Duelet e shekullit vicioz *me* ***stenogramet e ndëshkimit të sportistëve***

6. Mërgimi i bacit Salih *me* ***prangat e UDB-së në alarmin e 59-të të shekullit***

5. Syri i Tretë në mumie *me* ***siluetat e errëta të sarkofagut***

4. Shkëlqimi i notimit fals *me* ***Vuk-un e gozhduar në*** çirilicë

3. Krutani i Mërguar në dyzimin e kohës *me* ***eristikën demokratike të odave***

2. Zhurmat e njollave të carbonit *me* ***shkronjat ujore të Gutenbergut***

1. Fëmijëria e kujtueme *me* ***larminë e ëndrrave të vetmisë***

Vetja e zgjati dorën. Ndjeu se preku dikush. Klithi:

-Më zgjove nga vegimet! Hahaha, haha, ha! Aaaaaha?! Kërkoje Ishullin e humbur, lexoje dorëshkrimin e Robinson Kruzo-s, deshifroje labirintin e poetikës së pashkruar, ec e betohu në të gjitha cepet e At(ë)Dheut, zhvarrosi heronjtë e flijimeve, takohu me Helenën, bisedo me Mefistofelin, vërja sytë Borges-it, nderoje armikun fisnik, përkulu në zërin e ëndrrës dhe vrite zbrazësinë e kohës! Asnjëherë mos ik nga liria! Më pas do t'i njohësh që të 17 porositë fictive të poetikës së vargjeve humbëse në njollat e hirit pas shiut të akullt...

O (V) PASTHËNIA

Rrëfimi i fundit i mesazheve pas gjithë monologut të Arbër Varrit: TINGUJT E TË GJITHA ALFABETEVE TË PLANETIT DILNIN NGA NJË GYP ALARMI! ZËRAT VININ, SIÇ U DESHIFRUA MË VONË, NGA GJUHËT E VDEKURA. DIKUSH DYSHOJ SE MOS ISHIN JASHTËTOKËSORËT APO GJUHA QË FLISNIN TROJANËT?! HELENA ASNJËHERË NUK KISHTE PYETUR SE Ç`FARË MENDOJNË VENDORËT NËSE TRADHTOHEN?! PLANETI I ZVETËNUAR NGA VETVETJA E HETON ZBULIMIN E TRADHTISË VONË! TEPËR VONË!

P. S.

- Po, pse autor Arbër Varri?! - sikur filloj monologu i dialogut të redaktimit.

- Përpjekjet për të ç'thurur bashkëdyzimin e Unit të subjektit të autorit me rrëfimin e realitetit dhe të një autori të vdekur me fuqinë e shkrimit të tij imagjinativ më binden që autori i tregimit të dal me një emër e mbiemër *fictiv. Nuk është pseudonim, por rrëfimtari që është shkëputur nga krijuesi i vetvetes. Autori, në të vërtetë është pjesë e qenies fizike njerëzore, është pjesë që lind e në fund vdes, kurse arketipi personazh jeton. Dostojevski ka vdekur ndërsa Raskolnikovi tashmë ka hyrë si personalitet i ngulitur në literaturën letrare. E njohim Hamletin aq sa Shekspirin, Faustin aq sa Gëten, Anën aq sa Tolstoin, Adsonin aq sa Ekon, Santiagon aq sa Markesin... A mund të themi se Dostojevski jeton apo se Raskolnikovi ka vdekur?! Përderisa e dimë se Dostojevski lindi, jetoj vdiq dhe eshtrat i prehen në varr s'është e vështirë të konstatojmë se Dostojevski nuk ekziston. Apo e kundërta: Raskolnikovi, si arketip personazhi mund të jetoj edhe sot me një emër tjetër! Një Dostojevsk assesi. Prandaj edhe fillimi: E krijoj mendimin autorial Arbër Varri.* - sikur përfundoj dialogu i monologut të shpjegimit.

Është ky trill apo...?!

Shpjegim 1: Autorin e kërkoni kot! Eshtrat e tij të vrimuara mund t'i gjeni në cepin e skajshëm perëndimor të Atdheut. Pesë hapa në jug të Varreve të Krushqve, në të majtë të Lisit më të moshuar. Një metër e 72 cm nën tokë. Thuhet se ende njollat e gjakut fshehën afër varrit sepse në lëkurën e këmbës së djathtë kishte gërvishtur me gjilpërë testamentin si amanet epitaf në kokëgurin e mortit. Fijet e barit për-rreth zvetënoheshin çdo ditë. Bashkë me "Trandafilat e Marrisë". Thashethemet mateshin me minuta. Rapsodët kërkuan gjatë të verbrin e krisur. E takuan në një kasolle të vetmuar, majëbjeshkëve të Nemuna duke hedhur në ajër fletë dorëshkrimesh. Arkeologët dyshonin në varrimin e viktimës mbi skeletet, ndër me të vjetrat në Dardani. Kolumnistet e legjendave të semiotikës nën rrënoja kishin spastruar eristikën e kuluareve mbi intertekstualitetin e monografisë së pashkruar. Autori i Tregimit, thuhet, se para botimit, u gjend i vrarë. Pas disa motesh në një dit'zie n'pik'dite pëshpëritej se autori kishte klithur frikshëm, në prag të rënies: "Ah Koshare, të daltë flaka!"

Shpjegim 2: Këto dromca rrëfimi në 5 pjesë të cunguara që përbëjnë një (gjysmë) tregim të (pa)përfunduar ka mundur të këtë titull të gjatë "NJOLLAT E GJURMËVE TË HIRIT PAS SHIUT TË MERMERTË E TË AKULLT, TË MUROSURA NË PERGAMENET E PALIMPSESTEVE NË KUPTIMIN MESJETAR" me nëntitull: "Rilindja e gjysmëvdekjes së Arbër Varrit tek një cep i At(ë) Dheut" ...

"E redaktoi" dorëshkrimin
parabotues: Enver S. Morina
Prishtinë, dhjetor 1998 - janar 1999

TJETRI

Tregim nga Flurans Ilia

Në jetë të jetëve mbetem vëllai i dy motrave të mia më të rritura. Femrat më të bukura të qytetit tonë të vogëlith. Në qoftë se dashuria ime për këtë qytet duhet të ketë një imazh, atëherë ky imazh mbart veç fytyrat e tyre Rita dhe Zamira, dy yje që ndriçojnë përherë sa herë që në mbrëmje shëtisim shëtitores së vetme monotone të qendrës së qytezës tonë. Unë isha i vogël. Motrat e mia në lulëzim e sipër, më merrnin për dore saherë duhej të kërkonin leje nga babai për të dalë ditëve të verës. Ato ishin e gjithë dashuria ime për qytetin tonë që sapo filloja të eksploroja. Unë ngelesha alibia e tyre e pafajësisë në këtë qytet. Babi ndërsa më tërhiqte mënjanë për të më dhënë si zakonisht pesëlekëshin e akullores, më pëshpëriste: "Kujdes motrat. Sytë katër. Je bërë burrë tashti." Po. Pohoja me kokë duke u munduar të shkëputem prej asaj arome barnash mjeksore që karakterizonte lëkurën e duarve të tim eti. Gishtat e tij të verdhë nga përpunimi i tetraciklinave. Gishtat e tij të verdhë si të kishin prekur push mimozash. Pastaj si rrasja pesëlekëshin e akullores në xhep lëshohesha në krahët e dashurisë së motrave të mia të bukura dhe të tre së bashku krejt të lumtur e të lirë lëshoheshim drejt shëtitores së qytetthit tonë. Nga pas na ndiqte shikimi vrojtues i babait. Shikim i thellë. Depërtues. Zhbirues. I ftohtë, përtej atyre syzeve të veta të holla skeletmetaltë që i jepnin një hije të rëndë, na vështronte prej së largu i heshtur babi. Sepse ishte dhe ngelet «njeri nobel» babai. Këtë e pohojnë të gjithë banorët e këtij qyteti. Kështu ka ngelur në kujtesën e të gjithëve që e kanë njohur. Mund të zgjedhësh edhe të përdorësh cilëndo fjalë për të karakterizuar një njeri. Por kur vjen puna te babi, fjala «nobel» ngelet më e përshtatshmja. Kjo ndoshta ngaqë pas kësaj fjale qëndron e lidhur përsosmëria gjer në art. Ose ndoshta ngaqë për mua ajo fjalë vazhdon ta ketë të lidhur spirancën në shpirtin tim pikërisht ngaqë babi kishte shumë libra. Kishim shumë libra në shtëpi, më shumë se të tjerët. Sa herë që babi vinte në kryeqytet do të kthehej prej andej me një turrë librash. Gjithmonë kërkonte dhe gjente libra, në një kohë kur jo çdo libër që kërkoje gjendej kollaj. Ishte kohë krize. Krizë librash. Babi ishte barnashitës. Si e pohonte vetë ai në antagonizëm me fjalën farmacist. Një burrë i sjellshëm. I pashëm. Serioz. Profesionalist. Burrë i ndriçuar ishte babai. Vdiq në të hyrë të marsit kur mimozat shpërthejnë papritur përmes brymës së pemëve. I urrej mimozat sepse janë lule budallaqe. Vijnë shumë shpejtë në lugun e stinës dhe si rrjedhojë po aq shpejtë ikin. I urrej mimozat. Ngaqë në kujtesën time tani, ditën e varrimit të babit, më kanë ngelur në mendje tufat dhe kurorat e mimozave mbi pllakën e mermertë dhe të ftohtë ku prehet babai.

I mbështetur tek banaku i dyqanit të akulloreve, ca nga padurimi e ca nga të shtymat e fëmijëve të tjerë në rrëmujë e sipër, si për të kërkuar ndihmë i rrotullova sytë nga motra ime dhe me vështrim mu poshtë banakut të akulloreve ndesha kofshët gjysmë të zbuluara të Zamirës. Në mes të tyre dorën e fortë të Zanit posht fustanit të saj. Zani ishte shoku i ngushtë Zamirës. I isha betuar motrave se: "Gjallë në këtë botë nuk do i thosha asnjë fjalë babait". U shtanga. U shtanga ngaqë gjithmonë kisha menduar se ata ishin vetëm shokë. Por jo. Jo. Ajo dorë e fortë. Mu atje poshtë banakut të dyqanit të akullores, mes kofshëve të motrës time, kishte një forcë tunduese që e bënte gjuhën të më ngjitej si mastiç plot nervozizëm pas kremës së bardhë të akullores. "Ku *është* Rita?" Ia trasha zërin gjithë inat Zamirën. "Ka vajtur gjer në bibliotekë për të kërkuar ca libra. Do vemi ta marrim tani së bashku, ja dy minuta shpirti motrës." Tha, edhe i shtrëngoi fshehtas në shenjë pasionesh të flakta gishtat Zanit. Zani nga ana e tij për të më bllokuar pamjen, ballas meje dhe motrës time, më fërkoi balluket me dorën e tij të djathtë ndërkohë që e majta e tij pas shpine fërkonte gishtat e Zamirës. U ndjeva si një qenush i bindur nga pesha e fatit. Ai vazhdonte njëtrajtësisht të më ledhatonte kokën. "Zagari!" Thashë me vete. "Kujton se jam budalla dhe nuk kam marrë vesh se ç'ngjet?!" Rrugës drejt bibliotekës në kërkim të Ritës, nuk munguan tekat dhe pickimet e mia që ia nxinë krahun Zamirës. Duroi motra ime dhe "plaff" ma pëlciti një shpullë mu në turi! Xixa më dolën nga sytë! U hakërreva por e kuptova që e kisha të kotë. Se ç'kishte një shpirt dominues Zamira. Tundonte dhe sundonte me mënyrën e saj të gjitha ndjenjat e mia. Urrejtje, xhelozi, dashuri, pasiguri, gjithçka. Akoma edhe më i pasigurt u ndjeva kur te biblioteka gjetëm Ritën me Nerin, shokun e saj për të cilin isha gjithashtu në dijeni por që u isha betuar motrave se: "Gjallë në këtë botë nuk do i thosha asnjë fjalë babait". I kapëm në befasi duke u puthur në një nga sallat e boshatisura të leximit ndërsa ai zuzar i fërkonte gjokset motrës time. Edhe kujt pale? Ritës time si shpirt. Ai fragment ngelet shpulla e dytë që merrja brenda asaj dite. Dy shpulla flakëruese për një ditë të vetme ishin ca si shumë për një qytet me hapësirë aq të kufizuar.

Nafija ishte pastruesja e shkallëve të pallatit tonë parafabrikat. Kishte një qerre me kalamaj dhe nuk i ngopte dot me bukë me atë palo rrogë të cfilitur që i jepte Komunalja. Për ta ndihmuar përgjatë orëve të pastrimit të shkallëve të panumërta të apartamenteve

merrte vajzën e saj më të rritur në të njëjtën moshë si unë, Lela. Kur Lela na fshinte shkallët, një kat më sipër, unë nga poshtë shkallëve ia kisha parë kushedi se sa herë shalët. Pamja e tyre sa herë që mbyllesha në dhomë më bënte të shihja imazhe të bukura që ushqenin çdo ditë pubertetin. "Lela." I them një ditë i vetëm në shtëpi. "Do vish të shohësh librat e mi?" Lela nguron dhe buzëqesh njëherazi. Lela qesh, dridhet ndërsa kapërcen pragun e shtëpisë. Lela sheh me ndrojtje dhe frikë ndërsa mundohem t'ia mbërthej shalkat e bukura si kofsha pule të shvoshkura nga puplat, të bëra mornica mornica nga dora ime, si dora e Zanit në kofshët e Zamirës. Lela prek me gishta që i dridhen nga emocioni kapakun e «Kësulëkuqes» ndërsa i ledhatoj gjokset, si dora e Nerit mbi cicat e Ritës. Lela shfleton «Kësulëkuqen» ndërsa përpiqem t'i heq rrobën e saj të basmës së Kombinatit, mbushur me toptha të verdhë mimozash, duke e bindur të qëndrojë e qetë poshtë fustankës që rrëzohet petale petale mbi dyshemenë e pllakave të freskëta. Pushi i butë i mimozave të thërmuara mbi pllakat e dhomës time, më ka ngelur ndër gishta duke më ushqyer edhe sot ndjesi të turbullta. Ky ka qenë kontakti im i parë. Nuk e kuptoj përse i urrej mimozat?

Mbetem gjithmonë vëllai më i vogël i dy motrave të mia më të rritura, Rita dhe Zamira. Dy kurvave më të mëdhaja që ka parë në krejt historinë e vet qytetuci ynë i vocërr. Në qoftëse epshi i meshkujve të rëndomtë, si vetë ditët zvarranike të këtij qyteti duhet të ketë një imazh të asaj kohe, atëherë ky imazh mbart veç fytyrat e dy motrave të mia. Ato që dikur kishin qenë e gjithë dashuria ime për këtë qytet që sapo filloja të eksploroja, pas vdekjes së babit, ishte pothuajse e pamundur t'i bindje, t'i shtroje, t'i kontrolloje. Si rrjedhojë, dashuria ime e parë për qytetin tim të lindjes mund të përkufizohet edhe si urrejtja ime e përjetshme për qytetet e tjera ku do të jetoja më pas. Përmes ankthit dhe pasigurisë kërkoja më kot një alibi ku të justifikoja karshi atit të vdekur të gjitha veprimet e mia të mëtejshme si njeri imoral, kurvar i egër, i pacipë, elastik, strateg, zotërues, manipulues, shpirtrash e ndjenjash, epshor, agresiv, pushtetkërkues e pushtetmbajtës. Ndihesha mirë edhe pse përshkoja linjat shpirtërore të një njeriu krejt pa ndjenja, pothuajse me një shikim të ftohtë në këtë botë të cilën e shkelja me një kënaqësi vrastare, nën këpucët e mia të llustrafinta. Nuk merrja vesh nga më vinin të gjitha këto ndjesi ndërsa ngjisja një e nga një me mundim shkallët e karrierës sime të tanishme si avokat i proceseve më të mëdhaja politike në vend. Nuk kisha për ta kuptuar asnjëherë përsenë. Ngjitja ime në sferat e politikës ishte e beftë dhe spektakolare. Si femrat që kisha kaluar dhe kaloj ende nëpër duar. Përgjersa ndjenja për të shkërdhyer motrën apo gruan e cilitdo ishte shumë herë më e fortë brenda meje. Më e fortë se bota. Më e fortë se ekzistenca. Më e fortë se unë. Më e fortë se figura e atit. Më e fortë madje edhe se ato librat e tij të pafuqishëm për ta ndryshuar botën. Gjersa një ditë krejt rastësisht në një qoshk të humbur librash, u përplasa me shikimin e tij. Ai pi kafe të fortë. Pa sheqer. Ka vështrim zhbirues prej vrasësi. Ka sy të kaltër që ndryshojnë shpesh nën ndikimin e dritës. Mjekrën e ka të parruar. Pi cigare të panumërta. Dhe thonjtë kanë tendencë drejt zverdhjes si mimoza të kalbura. Ajo çka shfren prej gjoksi, tymi i cigares së vet, vjen në sytë e mi të mjegulluar si me qenë vetë dhimbja ime e panjohur për qytetin ku kam lindur. Ky është takimi im i parë me autorin. Një njeri i zhveshur nga çdo lloj tundimi dhe ambicje karshi botës që na rrethon. Pothuajse një njeri i tejdukshëm. Më saktë i padukshëm. Tym. Një tip i heshtur që zhbiron botën time ashtu si është, në heshtje. I vetmi që më sodit lakuriq. Veçori që askush nuk ka mundur ta bëjë më parë me mua. Ndihem mizerabël karshi atyre syve. Kjo më pëlqen në vazhdim. Veç t'i kesh ndeshur ato sy ndërsa rrëkëllen frazat e mia? Dy ullinj mbi një degë të paqtë? Nuk është e thjeshtë ta pohosh. Kush e njeh në brendësi forcën hipnotizuese të syve të gjarprit mbi një degë ulliri? Nuk kam pasur rast ta ndesh asnjëherë gjer në këtë çast fatlum a fatkeq këtë pamje lakuriqe e të përgjumtë hipnoze. Ky është njeriu përballë meje. Thotë se quhet F.I. Por ç'rëndësi ka emri? Megjithëse është zëri im ky që po ju flet. Autori i vërtetë i këtyre rreshtave që po ju rrëfej për veten time, ngelet ai. Dhe më duhet t'ju rrëfej edhe dy gjëra më tepër për të. F.I. është i ndershëm gjer në atë pikë sa nuk më lë asnjëherë të paguaj. Paguan gjithmonë ai. I hapët në ndershmërinë e tij të vobektë gjer në idiotësi. Thjesht një njeri i cili zor se mund të bëjë hajër në kryeqytet. "Shtrydhe jashtë vetes vetveten," më thotë, teksa çliron prej gjoksit tymin e cigares së vet. E urreja merhumin po aq sa më vinte keq ndërsa me kokëfortësi me një durim prej bualli më shtyn fort e më fort butësisht e njëtrajtësisht ta shtrydh veten jashtë vetes. Dhe i flas për femra. Histori me Femra. I tregoj histori epshtronditëse e flakndjellëse. Ai më dëgjon me atë pasivitetin e vet të pagojë e soditës teksa i rrëfej se si kam shkërdhyer jo vetëm të gjitha gratë dhe motrat e armiqve të mi realë dhe imagjinarë, por edhe të gjitha motrat dhe gratë e kolegëve të mi. E urrej njëkohësisht sepse e ndjej që ngelet njeriu i vetëm që njeh symbyllur përmasat e kockave të mia shtazërore. Nga çasti kur ndahem prej tij, nga çasti kur i nxitoj hapat për të mbërritur tjetrin, tjetrin jashtë meje, tjetrin brenda meje, një puhizë e lehtë më ledhaton ballin. Një ndjenjë çlirimi. Një farë lirie. Një biçim shkërdhatërie. Nervozohem një çast i kapur në grackën e autorit. Klith në errësirë: "Djall o punë!" Por qetësohem pak më tej duke qeshur. Po po, duke qeshur, i kënaqur. "Tek e fundit, kafetë i pagoi ai!" Dhe nuk jam aq i ligë sa mos ta dua autorin. Përkundrazi, çmendem pas atyre gishtave të tij të zverdhur nga nikotina. Duke paguar kafetë e bisedave tona, sikur ta kishte kuptuar, me një akt të vetëm vendimtar kishte zëvendësuar imazhin e munguar. Autori më tërheq mënjanë dhe më pëshpërit, "Je bërë burrë tani." Po. Pohoj me kokë, dashur pa dashur si atëherë fëmijë, duke u munduar të iki prej asaj arome barnash mjekësore që karakterizonte duart e tim eti. Kanë ende ngjyrë të verdhë nga përpunimi i tetraciklinave gishtat e tij të zverdhura si push mimozash. Pastaj, si e siguroj pesë lekëshin e akullores në xhep, lëshohem në krahët e dashurisë së motrave të mia të bukura, dhe të tre së bashku krejt të lumtur e të lirë, vërshojmë drejt shëtitores së vetme të qytetit tonë të brishtë në jetë të jetëve.

Tiranë - Montréal, 2010-2020

FANTAZMA E ÇMIMIT NOBEL

Nga G.G. Márquez

Përktheu Artur Spanjolli

Çdo vit, gjatë kësaj periudhe, një fantazëm trazon shkrimtarët e mëdhenj: çmimi Nobël për letërsi. Jorge Luis Borges, i cili është një nga më të mëdhenjtë gjithashtu edhe një nga kandidatët më të zellshëm, (paepur), një herë protestoi në një intervistë për gazetat për shkak të dy muajve të ankthit, kur atij i duhej të vuante prej shanceve dhe parashikimeve. Është e pashmangshme. Borges është shkrimtari që meriton më shumë artistikisht në gjuhën spanjolle, ndaj nuk mund të pretendojë që ta veçojnë, veç për mëshirë, nga parashikimet vjetore.Gjëja më e keqe është se rezultati final nuk varet nga e drejta e kandidatit, as nga gjykimi i zotave, por nga vullneti i pahetueshëm i pjestarëve të Akademisë suedeze.

Nuk kujtoj asnjë parashikim të qëlluar në shenjë. Fituesit e çmimit në përgjithësi, duken vetë ato, personat e parë që habiten më shumë. Kur dramaturgu anglez Samuel Beckett mori telefonatën e lajmit për çmimin, në vitin 69 klithi i zhgënjyer: "Zot i Madh, ç fatkeqësi!" Pablo Neruda, në vitin 1971, e mori vesht tre ditë përpara se lajmi të dilte nëpër gazeta, falë një mesazhi konfidencjal nga ambasada suedeze. Ndaj mbrëmjen e ditës tjetër ftoi për darkë një grup miqsh në Paris, ku në atë kohë ishte ambasador i Kilit, dhe asnjë nga ne nuk e mori vesht motivin e asaj feste, derisa gazetat e darkës nuk e publikuan lajmin. "Fakti është se nuk besoj asgjë derisa mos ta shoh të publikuar në gazetë!" na shpjegoi më pas Neruda me atë të qeshurën e tij të parrezistueshme. Mbas pak ditësh, tek hanim në një restorant plot zhurmë në bulevardin Montparnas, u kujtua se akoma nuk kishte shkruar fjalimin që i duhej të mbante gjatë ceremonisë së dhënjes së çmimit, i cili do të zhvillohej 48 orë më pas në Stokholm. Ndaj ktheu nga ana tjetër letrën e menusë, dhe pa pushuar fare, pa e vrarë mendjen nga zhurma, me të njëjtën natyrshmëri me të cilën merrte frymë dhe me të njëjtën bojë jeshile, pa i bërë syu tërr, shkroi aty për aty fjalimin i cili do ti vinte kurorën e lavdisë.

Versioni më i dëgjuar mes shkrimtarëve dhe kritikëve është se akademikët suedezë vihen dakord në maj, kur bora fillon të shkrijë, dhe studjojnë veprat e pak finalistëve gjatë vapës së verës. Në tetor, akoma të pjekur nga dielli i jugut, shprehin vendimin e tyre. Simbas një versioni tjetër, Borges ishte i përzgjedhuri qysh në maj të '76, por nuk e votuan gjatë votimit final në nëntor. Në të vërtetë fituesi i atij viti qe i mrekullueshmi dhe zhgënjyesi Bellow, i zgjedhur me ngut në çastin e fundit, edhe pse shumë çmime të atij viti në fusha të tjera i kishin fituar amerikanët.

Fakti është se me 22 shtator të po atij viti – një muaj përpara votimit final, - Borges kishte bërë një gjest i cili nuk kishte fare lidhje me letërsinë e tij madhështore. I kishte bërë vizitë gjeneralit Pinochet. "është nder të cilin as nuk e meritoj të pritem nga ju, zoti president", u shpreh në fjalimin e tij fatkeq. "Në Argjentinë dhe Kili dhe Uruguai po shpëtojnë lirinë dhe rregullin" vazhdoi edhe pse nuk e pyeti askush. Pastaj e mbylli pa e vrarë shumë mëndjen: "E gjitha kjo ndodh në një kontinent minuar nga anarkia dhe komunizmi". Ishte e thjeshtë ta kuptoje se kaq shumë marrëzi thënë, njëra mbas tjetrës, nuk ishin gjë tjetër veç dëshira për t'u tallur me Pinochetin. Por suedezët, nuk e kanë ndjenjën e humorit të banorëve të Buenos Airesit. Që nga ai moment, emri i Borgesit ishte zhdukur nga lista e të përzgjedhurve. Tani, në fund të një pendese të padrejtë, u ka rishfaqur, dhe nuk na pëlqen aspak neve që jemi edhe lexuesit e tij të palodhur, por edhe kundërshtarët e tij politikë, ta dimë më në fund si ta çlirojmë nga ankthi vjetor. Rivalët e tij më të rrezikshëm janë dy romancjerë në gjuhën angleze. I pari ishte ngjitur deri atje pa shumë zhurmë gjatë viteve më parë, tani ishte bërë objekt promovimi plot zhurmë nga gazeta "Newseek!" e cila e ka vënë në kopertinë me datë 18 gusht, si mjeshtër i madh rrëfimi; dhe me motive të padiskutueshme. Emri i tij i plotë është V.S. Naipaul, është 47 vjeç dhe ka lindur këtu afër. Në ishullin Trinidad, me babë indù dhe nënën karaibike, dhe konsiderohet nga disa kritikë si shkrimtari më i madh aktual në gjuhën angleze. Kandidati tjetër është Greene, pesë vjet më i ri se Borges, por me të gjitha meritat, edhe pse me më shumë vite mbi shpatulla për të fituar këtë kurorë dafine në pleqëri.

Në vjeshtën e 72, në Londër, Naipaul nuk ishte aq shumë i ndërgjegjshëm se ishte shkrimtar karaibik. Ia bëra të qartë gjatë një takimi mes miqsh dhe ai mbeti pak si i befasuar. E mendoi për një çast, dhe një buzëqeshje e re i ndriçoi fytyrën e heshtur. "Good claim", më tha. Ndërsa G. Greene, i cili ka lindur në Berkhamsted, nuk kish hezituar as edhe një çast kur gazetarët e kishin pyetur nëse ishte i ndërgjegjshëm që ishte shkrimtar latinoamerikan. "Natyrisht!" u përgjigj. "Dhe jam i lumtur, sepse në amerikën latine, tani për tani gjenden shkrimtarët më të mirë si për shembull Borges". Pak vite më parë, duke folur mbi shumë gjëra, i shpreha Green-it, pakënaqësinë time që një shkrimtari si ai, me një vepër aq të gjerë dhe aq origjinale, akoma nuk i kishin dhënë çmimin Nobel. "Nuk do ma japin kurrë" më tha shumë serioz, "sepse nuk më konsiderojnë një shkrimtar serioz."



Akademia suedeze, e ka për detyrë të japi çmimin Nobel për letërsi. Ajo dhe vetëm ajo, u themelua në vitin 1786, pa asnjë pretendim tjetër veç atij që t'i ngjante Akademisë franceze. Kur u krijua, asnjë nuk e imagjinonte, se me kalimin e kohës ajo do të jepte çmimin më prestigjoz dhe shenjtërues në botë. Ajo është e përbërë nga 8 pjesëtarë të përjetshëm në moshë të thyer, të seleksionuar nga vetë Akademia, mes figurave më të shquara të letërsisë suedeze. Është e përbërë nga dy filozofë, dy historianë, tre specjalistë të gjuhëve nordike dhe vetëm një grua. Por nuk është vetëm kjo sintoma e maskilizmit; gjatë viteve 80, çmimi iu ka dhënë vetëm gjashtë grave, karshi 69 burrave. Këtë vit do të jepet pak ndryshe sepse një nga akademikët e çmimit, profesor Sten, vdiq me tre shtator. Plot 15 ditë më parë.

Si e kanë proçedurën, si vihen në ujdi, kush janë akordet e vërteta dhe se si vendosin, është një nga sekretet më të mëdha të kohës tonë. Kriteret e tyre janë të paparashikueshme, plot kontradikta, i paprekur deri edhe nga oguret, dhe ajo që vendosin është sekrete, e mbrojtur nga ato vetë dhe ajo është e pacënueshme. Po mos të ishin kaq të rendësishëm, mund të mendohej se janë të ushqyer nga një dëshirë çapkëne për t'u tallur me çdo profeci. Asnjë si ata nuk i shëmbëllen më shumë vdekjes.

Një tjetër sekret i ruajtur me shumë kujdes është ai se si investohet kapitali që prodhon kaq shumë çmime. Alfred Nobel, (me theksin tek e-ja dhe jo tek o-ja) e krijoi çmimin në vitin 1895 me një kapital fillestar prej 9.200.000 dollarësh, interesat vjetore të të cilit duheshin ndarë për çdo vit, jo më larg se 15 nëntori, në mes të pesë pjestarëve fitues. Ndaj dhe shuma ndryshon çdo vit, varet nga fitimet e investimit. Në vitin 1901, kur çmimet u dhanë për herë të parë, çdo fituesi iu dhanë 30.160 korona suedeze. Në vitin 1979, i cili ishte edhe viti me interesa më të majme, çdo fitues mori nga 160.000 korona.

Thashethemet thonë se kapitali është investuar në minjerat e arit në Afrikën e Jugut, dhe si rrjedhojë, çmimi Nobel ushqehet me gjakun e skllevërve të zinj. Akademia suedeze e cila nuk ka bërë kurrë deklarata publike, as edhe nuk u ka përgjigjur kurrë fyerjeve, mund të mbrohet shumë mirë duke pohuar se nuk është ajo që merret me atë punë, por është Banka e Suedisë e cila administron paratë. Dhe bankat, siç dihet dhe siç e thotë vetë emri i tyre, nuk kanë zemër.

Enigma e tretë është kriteri politik që dominon brenda Akademisë suedeze. Në shumë rrethana, çmimet kanë lejuar të mendohet se anëtarët e saj janë liberalë idealistë. Incidenti i tyre më i famshëm

dhe më i nderuari është ai i 1938, kur Hitleri i ndaloi gjermanët ta tërhiqnin çmimin Nobël duke thënë se nismëtari i tij ishte një hebre. Richard Khun, gjermani që atë vit meritoi çmimin për Kimi, u detyrua ta refuzonte. Për bindje o për kujdes, asnjë nga çmimet nuk u dha gjatë luftës së dytë botërore. Por sapo Europa e mori disi veten nga fatkeqësia, Akademia suedeze bëri një lëvizje që ia shtoi prestigjin. Ia akordoi çmimin për letërsi zotit Winston Churchill vetëm sepse ishte njeriu më me prestigj i kohës së tij dhe nuk ishte e mundur të jepej asnjë çmim tjetër, as edhe atë për paqjen.

Ndoshta raportet më të vështira të Akademisë suedeze kanë qenë ato me Bashkimin Sovjetik. Në vitin 1958 kur çmimi iu dha të mrekullueshmit Boris Pasternak, ky i fundit e refuzoi nga frika se ndoshta nuk e lejonin të futej akoma në atdheun e tij. Por ndodhi që, kur në vitin 1965 çmimi iu dha Mihajl Shollohov, shkrimtari më zyrtar nga shkrimtarët sovjetikë, të njëjtat autoritete që i bënë presion Pastërnakut, tani festuan ngjarjen plot gëzim. Ndërsa, pesë vjet më vonë, kur ia dhanë çmimin disidentit Aleksander Solzhenicin, qeveria sovjetike e humbi fare dhe nuk hezitoi të shprehej se çmimi Nobel ishte një vegël e imperializmit. Kisha konstatuar gjithashtu se mesazhet më të ngrohta, pasi kishte marrë çmimin Nobel, Pablo Neruda i kishte marrë nga sferat më të larta të qeverisë Sovjetike. "Për ne", më tha, duke buzëqeshur një mik rus, "çmimi Nobel ja vlen vetëm kur ai i jepet një shkrimtari që na pëlqen. Dhe nuk ia vlen kur ndodh e kundërta". Shpjegimi nuk është aq i thjeshtë sa ç mund të mendohet. Ne të gjithë, thellë zemrës, ndjekim të njëjtat kritere.

I vetmi pjestar i Akademisë suedeze që lexon spanjisht, dhe e bën atë në mënyrë të përkryer, është poeti Artur Lundvikst. Ai është i vetmi që njeh veprat e shkrimtarëve tanë, që propozon kandidaturat dhe që lufton për to gjatë përleshjes sekrete. Dhe ky fakt e ka trasformuar, edhe pse nuk i pëlqen ky rrol, në një hyjni të largët dhe enigmatike, nga i cili varet deri diku edhe fati universal i letërsisë së shkruar në gjuhën spanjolle. Në jetën e përditshme ai është një zotëri i moshuar, me një ndjenjë humorizmi pak latin dhe me një shtëpi aq modeste sa duket e pamundur ta mendosh se nga ai varet fati i ndokujt.

Disa vite më parë, mbas një darke tipike suedeze në shtëpinë e tij – me mishra të ftohtë dhe birrë të nxehtë, - Lundvikst-i na ftoi të merrnim një kafe tek bibloteka e tij. Mbeta krejt i habitur. Ishte e pabesueshme të gjeje një sasi aq të madhe librash spanjisht. Nga më të mirët deri tek më të këqijtë, dhe gati të gjithë me dedikim nga autorët e tyre akoma të gjallë, në agonizi ose që kishin vdekur ndërsa prisnin. I mora leje poetit të lexoja disa dedikime, dhe ai ma dha lejen me një buzëqeshje të mirë plot bashkëpunim. Shumica e dedikimeve ishin plot mirëdashje dhe zemër për të mos thënë lajka, disa ishin aq direkte sa në momentin që po shkruaja dedikimin tim mu duk se edhe veç firma ishte e tepërt. Gjithkush ka komplekset e veta, dreqi e mori!

8 tetor 1980

PËRSE VAZHDON TË RIBOTOHET ROMANI "TË ÇMENDUR NË PARAJSË" I VIRION GRAÇIT?

Nga Ermira ALIJA

Të jep një kompleks ndjesish romani "Të çmendur në Parajsë " i Virion Graçit. Stuhia e mendimeve dhe e emocioneve që provokon, i ka rrënjët e thella dhe ti si lexues e kupton se ato mbartin shumë gjëra mbas vetes.

Gjithçka fillon me lirinë. Ajo provokon tek personazhet e romanit standardet e tyre të vlerësimit për disa realitete të jashtme dhe të brendshme; provokon një krizë të raporteve të vetjeve të tyre: vetjes ekonomike, familjare, shoqërore, kombëtare...

Ku po shkoj unë? Unë!?
Pa vendin tim, pa gjuhën time, pa shokët e mi. Pa gruan time, pa djalin tim, pa emrin tim, pa ...

Kriza e fortë ekonomike i shtyn personazhet e romanit të shkelin rregulla, të shkojnë për të punuar në një vend të huaj ilegalisht. Kjo i bën të ndeshen me një realitet ndryshe, të pambrojtur nga ligji, në dorë të njerëzisë. E kështu, edhe liria e njerëzisë së huaj (si individë, si opinion shoqëror, si institucion), vihet nën provokim.

Ky është ambienti në të cilin zhvillohen ngjarjet e romanit, ambient që hap mundësi për shumë shfaqje, përtej emërtimeve:

Polici shqiptar na shtyn me shkopin e gomës ...
Duhet ta lirojmë xhadenë... të kalojnë makinat shumëtonëshe. Makinat e tregtarëve, doganierëve...

Panajoti dhe Rexhepi u pëlqyen shumë shpejt midis tyre.
Madje unë jam tërhequr ca para kësaj miqësie bashkëmoshatarësh të ndryshëm.
Secili bisedon në gjuhën e vet pa e kuptuar tjetrin dhe kështu vazhdon ky komunikim shembullor dhe komik.

E shikoj në bebëza në mënyrë pyetëse. Me ankth. Ai pohon...
Një avull i ngrohtë më djeg lëkurën e zverkut.

Romani flet për të çmendur. Zakonisht çmenduria perceptohet si mungesë e pavetëdijshme e dëshirës për ta pranuar realitetin. *Të çmendur në Parajsë* guxon ta prekë atë realitet, të shfaqë caqe të pacekura të tij, ndoshta tabu. Luan me të kundërtat e valencave dhe parapëlqen të paraqesë skaje njerëzore, duke refuzuar pozicionimin:

Merina fiton shumë. Mbledh para ... i ngelen dhe për veten ...
Sa shumë ngjan me Lorën. Si dy pika uji. Lora u shpërbë.
U nda në disa pjesë: një djalë, një kufomë, një varr dhe një braktisje.

(Lora) Është një planet pa jetë. Një planet që kërkon orbitë.
Kërkon një orbitë të shuar. Një orbitë që nuk ka ekzistuar.
Një orbitë që nuk ka ekzistuar kurrë ...
Një orbitë e imagjinuar.

Sana shikon si fajtore. Nuk ka se ku të mbështetet. Gjithçka rrafsh. Rrafsh.

Gjithçka që ndodh në roman vjen tek lexuesi si e vërtetë subjektive, që lëviz:

Nuk di të sillem. Jeta s'gjendet në trupat tanë. Jeta gjendet në lëvizje. Në shtegëtim të pandërprerë.
Gjithandej, asgjëkundi, gjithandej, asgjëkundi?!

Autori rrëfen duke provokuar me fjalë ndjesi, që nuk është e lehtë t'u vihet emër:

Lëshohem i tëri në një humnerë vdekësie.
Në një humnerë të shtruar me mjegull dhe shkurre të gjelbërta.
Në fund të saj është një yll i bukur. Turrem drejt tij. ...
I afrohem pafundësisht. Ai ndalet. Ndahet. Coptohet.
Në qindra pjesë. Në tre pjesë. Qindra yje me të njëjtën fytyrë. Një lloj. Qindra.
Shkas pambarimisht në thellësirat e mistershme të humnerës.
Mjegulla ngjishet dhe forcohet, kurse shkurret më mbajnë copa lëkure.

Psherëtij. Dhe pres sopatën e mprehtë të më godasë në shenjë, në gjoks, në kokë.

Majat e pemëve mbajnë mbi krye zymtësinë e qiellit. Yjet janë shuar.

E çuditshme se si ndjesitë në roman e tejkalojnë mendimin. Të shtrira përgjatë romanit, duket se fitojnë një lloj pavarësie, si një lloj e vërtete që është e paaftë për të qëndruar vetëm. Dhe kjo e vërtetë nganjëherë shfaqet si haraç i lartë i prishjes së raportit konvencional të vetjeve:

– *Ju doni të më vrisni, – thotë më pas fare qartë.*
– *Jo. Lora. Unë të dua.*
– *Ti ike.*
– *Ika të blinim shtëpi më të madhe.*
– *Ti ike.*
– *Ika por nuk ju harrova. Gjithmonë mendoja për ju.*
– *Ti ike.*

Herë shfaqet si haraç i një psikoze shoqërore, që e paguan preja e radhës:

– *Spiro ti nuk ke bërë asgjë të keqe, apo ke bërë? – më pyet ai me inat.*
Sytë e kaltër i shkrepëtijnë. O njeri i mirë. O njeri.
– *Po. Kam punuar, kam punuar si skllav, kaq. Ky është faj i rëndë Panajoti.*
Ai nxehet kurse unë prisja të qeshte me të madhe. Bërtet:
– *Ah, pushtat, – pastaj zbutet. – Rri urtë se të vrasin. Kjo është puna e tyre.*

Herë si limit ekstrem i çbërjes së njeriut deri në mbijetesë:

Sana përdhe përkrah Fationit. Ky i fundit nuk është përmendur ende.
Dikush i ka futur midis këmbëve të mbathurat e gruas së tij, të njomura e të mbledhura shuk.
Sana fle me sy hapur. E shokuar.
Shpirti merr fytyrën e fatit.

Romani flet për të çmendur. Zakonisht çmenduria perceptohet si mungesë e pavetëdijshme e dëshirës për ta pranuar realitetin. E si mund të mos pranohet Parajsa? Apo edhe Parajsa ka honet e saj?!

Gjithsesi romani nuk lexohet për të marrë përgjigje. Ai tejkalon limitet e kuptimësisë në favor të një letrariteti gati poetik:

Tani që Lora ka ikur, më lumturon optika e saj prej të çmendure. Më quajti ... djalin ... e saj... më quajti ... djalin ... tim... më quajti ... Tori. Dhe unë rashë në duart e saj ... i lehtë ... si pupël ... dhe i turbullt ... si kjo ... dritë neoni ... rashë në duart e saj ... dhe pashë si vdesin shekujt në konstruktet femërore... si vdesin teoritë dhe përgjithësimet ... si vdesin vdekjet dhe lindjet, si vdes gjithësia dhe vdekja e gjithësisë ... si vdes njeriu dhe vdekja e njeriut.

Autori vë në gojën e rrëfimtarit: ...*unë gjendem në sipërfaqen e gjithësisë. Tapë pluskuese...*

Kjo është ndoshta arsyeja që romani përkthehet e vazhdon të ribotohet.

Shkodër, më 7/12/2021

Ivan A. Bunin

IDA

Përktheu nga origjinali: Agron Tufa

Një herë për kërshendella, ne të katër, - tre miq të vjetër dhe njëfarë Georgij Ivanoviç, - e hëngrëm sillën në "Balshoj Moskovskij".

Për shkak të festës "Balshoj Moskovskij" qe i zbrazët dhe i freskët. Ne përshkuam sallën vjetër, të ndriçuat dobët nga dita e ftohtë dhe e irnosur dhe ndaluam në dyert e një të reje, duke kërkuar ndonjë vend më të rehatshëm për t'u ulur, teksa këqyrim tavolinat, të saposhtruara me mbulesa borë të bardha e të sheshta. Përgjegjësi i lokalit, gjithë duke rrezëllirë pastërti e mirësjellje, bëri një gjest të hijshëm e modest në një tavolinë rrotullare para një divani gjysmërrethor. Shkuam andej.

- Zotërinj, -tha kompozitori, duke iu avitur divanit e duke mëshuar në të me torsin e tij shpatullgjërë, - zotërinj, tashti dua të gostitem se ashtu e kam sebepin, dhe dua të kremtoj me bujë e bollëk. - Shtronani, pra, kamarjer, mësallën magjike sa më bujarisht, - tha, duke kthyer nga ai fytyrën e gjërë prej muzhiku me syçka të ngushta. - Ju m'i dini huqet e mia mbretërore.

- Si nuk i ditkam, përmendësh duhet t'i kisha nxënë, - buzëqeshi i përmbajtur kamarieri, një plak i vjetër e i urtë, me një mjekër të pastër e të argjendtë, teksa u vinte përpara një tavllë duhani. - Mos u merakosni, Pavël Nikollajeviç, do të përpiqemi. . .

Fill pas një minute para nesh u shfaqën gotat dhe kupat këmbëgjata, shishet me vodka shumëngjyrëshe, peshq salmone të trëndafiltë, balikel të zeshkët, një pjatancë me molusqe të hapura ndër copëza akulli, një kuadrat i portokalltë cesteri, një partinë të zezë të mrekullueshme havjari të presuar, një legen oval llamarine me vega, plot shishe shampanje të bardhë e të djersitur nga të ftohtit. Ia nisëm me vodkë speci. Kompozitorit ia kish qejfi të na i mbushte vetë gotat dhe pasi mbushi tri gota, ngadalësoi prajshëm për gallatë:

- Po juve i shenjti Georg Ivanoviç, pranoni t'jua mbush? Georg Ivanoviçi, i vetmi pasion i të cilit ish - të jetë mik i shkrimtarëve, piktorëve dhe artistëve të dëgjuar, - njeri krejt i paqtë dhe me gjendje shpirtërore pandryshueshmërisht të shkëlqyer, u skuq pakëz, - ai skuqej prore para se të thoshte ndonjë gjë, - dhe u përgjigj me një farë moskokëçarje gjuhëzgjidhur:

-Ta mbushësh që ç'ke me të, o mëkatari Pavël Nikollajeviç. Dhe kompozitori i hodhi dhe atij, cakrroi lehtë gotën e tij me tonat, e zbrazi atë me fund me fjalët: "Të faltë zoti!" dhe, duke fryrë në mustaqet e veta, iu kthye mezeve. Morëm dhe ne, dhe vazhduam kështu për një copë herë të gjatë. Pastaj porositëm supë peshku dhe pimë nga një cigare. Në sallën e vjetër gramafoni ia kish marrë një kënge të butë e të trishtë që kuiste qortueshëm. Dhe kompozitori me t'u pështetur në shpinoren e divanit, thithi cigaren dhe sipas zakonit të tij, duke e mbushur me ajër gjoksin e tij të lartë e të ngritur, tha: - miq të shtrenjtë, pa marrë parasysh kënaqësinë gaztronomike te stomakut, sot jam i trishtuar. Dhe jam i trishtuar tash, ngase sot në mëngjes, sapo u ngrita, m'u kujtua një histori e vogël, e ci1a i bëri vaki një mikut tim, siç e tregoi veten më vonë, gomar bidevi, këtu e tre vjet më parë, në ditën e dytë të kërshëndellave. . .

- Një histoi e vogël, por pa pikë dyshimi, amur, - tha Geogij Ivanoviçi me buzëqeshjen e tij prej çupërline.

Kompozitori e pa vëngër.

- Amur? – tha ftohtë e shpotitës ai. - Ah, Georgij Ivanoviç, Georgij Ivanoviç, si do të shfajësoheni para gjyqit të tmerrshëm për blasfemitë e pamëshirshme të mendjes suaj? Epo, Zoti ju dh dhatë hajërin. "Je veux un tresor qw les contIent tous, Je veux la jeunesse!" 2. - këngëtoi ai nën taktin e gramafonit që po luante Faustin dhe, duke ngritur vetullat e duke u kthyer nga ne, vazhdoi: - Ja se si ka bërë vaki o miq. Para do kohësh, në një farë mbretërie, hynte e dilte në shtëpinë e njëfarë zotnie njëfare vajze, shoqe kursi me gruan e tij, aq e thjeshtë, aq e ëmbël, saqë ky zotëri na e quante atë, thjesht, Ida, domethënë vetëm sipas emrit. Ida këtu, Ida atje, ai madje as atësinë e saj s'ia dinte mirë. Dinte vetëm që ajo rridhte prej një famileje të mirë, por me pasuri të pakët, vajzë e një muzikanti, dikur ish-dirigjent i dëgjuar, që rronte me prindërit, dhe pret, siç merret me mend, të fejuarin e mundshëm - dhe asgjë më shumë. . . - Po si t'jua përshkruaj juve këtë Idë? Zotëria ndjente për të shumë simpati, por t'i biem drejt, vëmendja e tij, e përsëris, vazhdonte të mbetej zero. Sapo vjen ajo - ai i drejtohet: " Aha -a, Ida, ti je o engjëll! Tungjatjeta, tungjatjeta, më gëzohet shpirti që po ju shoh!" Kurse ajo vetëm se vë buzë në gaz, fsheh shaminë e hundëve në manshon, hedh një vështrim të kthjellët, vajzërishte (paksa të pakuptimtë): "Masha është aty?" -" Aty, aty, kini mirësinë. . . " - A mund të hyj tek ajo?" - Dhe kalon e qetë pëmes sallës së ngrënies te dyert e Mashës: "Masha, mund të hyj?" - Një zë gjoksi, që drithërohet gjer në pejëzat më të holla, shtojini këtij zëri gjithë të tjerat: brishtësinë e moshës, shëndetin, kundërmimin vajzëror, të sapo hyrë në dhomë nga thëllimi. . . pastaj, shtatin e gjatë, të përpiktë, harmoninë e rrallë dhe lëvizjet e natyrshme. . . . Edhe fytyrën e kish të rrallë, në vështrim të parë, thuajse krejt të zakonëshme, por po të përqëndroheshe - të ngulitej në shpirt: nuanca e lëkurës - e njëllojtë, e ngrohtë, mu si cilësia e ndonjë varieteti më të mirë molle, - ngjyra e gjallë dhe e manushaqtëe syve, plot. -Po vetëm ta shohësh dhe të ngulitet në zemër. Kurse ai trapi, d. m. th, heroi i rrëfimit tonë, e këqyr, bie në një ngazëllim viçi, dhe thotë: "Ah, Ida, Ida, ju nuk ia dini vlerën vetes!" - pikas buzagazin e saj gjegjës, të ëmbël, kinse krejt të pavëmendshëm - dhe mbyllet në kabinetin e tij, rishmi për t'u marrë me do fare dokrrash, të quajtura krijimtari, që e piftë dreqi me gjithsej. Dhe rrodhi kështu koha, saqë ky zotëria ynë nuk e çoi ndërmend, madje as Idën vetë, pak nga pak seriozisht - dhe mund ta përfytyroni, ai me nuk e kish vënë re, se si ajo Ida, në një ditë të bukur, se ku u zhduk. Thjesht, Idë më nuk ka, bile atij as që i bje ndërmend ta pyesë gruan: po ç'u bë pra Ida jonë? E kujton prapë dhe ndien në vetvete diç të mangët, ëndërron trallisjen e ëmbël cfilitëse me të cilën mund të kish përqafuar kurrmin e saj dhe, me sytë e mendjes dallon manshonin e saj të bardhë, ngjyrën e fytyrës dhe sytë e manushaqtë, dorën e hirshme, fundin anglez, përmallohet për momentin - dhe prapë e harron. Kështu shkoi nje vit, kaloi dhe një tjetër. . . Kur, befas, njëherë atij iu desh të udhëtonte në viset e perendimit. . .

- Kjo rastisi mu për kërshëndella. Po pavarësisht nga kjo, ai qi shtrënguar të udhëtojë. Dhe ja, me t'u përshëndetur me robt e shpisë dhe shërbetorët, zotëria ynë shaloi kalin e tij azgan dhe u nis. Ec ditë e ec natë dhe, me ne fund, mbërriti gjer në stacionin hekurudhor, ku duhej të hypte. Por duhet thënë se mbërriti me vonesë të theksuar ndaj, sapo treni nisi të lëvizë përgjatë hyrjes së platformës, kërceu nga vagoni, zuri për jake hamallin e parë që i kapi dora dhe i vikat: -"Nuk ka kaluar ende andej treni ekspres?" Kurse hamalli i buzëqesh mirësjellshëm dhe i thotë, duke shpënë buzë ne gaz: "Tashi sapo iku zotëri. Sepse ju i lejuat vetes të vonoheni një orë e gjysmë të tëre" - "Ç'thua ashtu mor horr? Tallesh? Po tashi si t'ia bëj? Në Siberi do të të çoj, në internim, do të ta vë kokën ne satër! " - "Faji im është, faji im, përgjigjet hamalli, po koka e fa1ur nuk pritet, shkëlqesi. Kijni durim të prisni trenin e pasagjerëve. . .

"Dhe udhëtari ynë fisnik, i heshtur e kokëvarur u sorollat në stacion. . . .

- Në stacion na qe kallaballëk i madh, ngrohtë dhe rehatshëm. Tash një javë frynte tufani dhe gjithçka në shinat hekurudhore qe bërë lesh e li, të gjitha afishet e orareve i kish marrë dreqi dhe në godinën e stacionit qe dëng me njerëz. Po e njëjta gjë ish, sigurisht, edhe këtu. Gjithkund njerëz dhe plaçka dhe, gjithë ditën e lume bufeja punonte, gjithë ditën kundërmim gjelle, samovari dhe, ta pret mendja, në thellim e tufan kjo s'ka të sharë. Dhe përveç kësaj, ky stacion qe i pasur dhe i hapësirte, kështu që udhëtari ynë ndjeu saora, se nuk do qe ndonjë fatkeqësi e madhe të qëndroje aty, madje edhe për njëzetekatër orë. "Ta zbus paksa pamjen time të jashtme, pastaj të ha e të pi mirë" - mendoi ai me kënaqësi, teksa mori të hyjë në sallën e pasagjerëve, dhe sakaq, u vu të përmbushë atë ç'ka kish bërë nijet. U la e u rrua, veshi një këmishë të pastër, doli nga dhoma e tualetit i rinuar në njëzet vjet dhe iu drejtua bufesë. Aty ai hodhi një gotë, hodhi një tjetër, hëngri një lloj byreku, pasta shcuke hebreje 3 dhe ndërsa bëj gati të pinte edhe një gotë tjetër, kur befas ndjeu pas shpine një zë të mrekullueshëm femre, tmerrësisht të njohur. Atëherë, ai, sigurisht, u kthye "vrullshëm" - dhe, a ua rrok mendja se kë pa para tij? Idën! - Nga gëzimi dhe mahnia, ai, së pari, nuk mundi të bëjë gëk, por qëndronte si një dash në dyer të reja dhe vetëm vështronte atë. Kurse ajo - meqë ua kam fjalën, more shokë, hajde se ç'zonjë e rëndë! Mor as qimja s'i luante vendit. Ta pret mendja, edhe ajo s 'kish si të mos habitej, madje impovizoi në fytyrë një grimë gëzimi, po neutralitetin ama, e ruajti. Të pa ndryshuar. . . "I dashur, i thotë, ç'farë fati të përplasi këtej? Ja se çfarë takimi i këndshëm!" Dhe nga sytë dukej se thoshte të vërtetën, porse e thoshte disi mjaftë të thjeshtëzuar dhe fare pa atë nianierën, me të cilën dikur, dhe ç'ka është më kryesore. . . paksa me shpoti, mbase. Kurse zotëria ynë mbeti keqas i shituar ngase ajo, qe shndërruar megjithsej në një Idë krejt tjetër: sesi qe lu1ëzuar, aq mahnitshëm, siç çel ndonjë lu1e e mrekullueshme në ujë të pastër brenda ndonjë kupë të tejdukslune kristali dhe qe veshur në po atë lartësi të denjë: me modesti të madhe, koketeri të madhe: një kapele dimërore që kushtonte një djall e gjysmë si dhe me një pelerinë njëmijë rrubëlshe supesh prej kunadhje Siberie. . . Kur zotnia me sforcim e përulje i puthi dorën me gishtat e saj verbues, ajo i bëri shenjë me kapele prapa, përmes supesh, dhe i thotë e shkujdesur: "Njihuni me këtë rast me burrin tim" - dhe sakaq, që prapa saj, u paraqit ushtarakisht një student i ri, por me thjeshtësi. -Ah, faqeziu! - klithi Georgij lvanoviç - Student i rëndomtë? - Po aty është gjithë sekreti, i dashur Georgij Ivanoviç, që na qe aspak i rëndomtë, - tha kompozitori

me një buzagaz të pakënaqur. - Më duket se zotëria ynë kurrë në jetë s'qe ndeshur me atë që e quajnë fytyrë të mermertë djaloshare, me të tilla tipare të mrekulluueshme fisnikërie. I veshur shik: me një bluzë prej të tillë shajaku të hollë, ngjyrë gri të hapët, të cilin e mbajnë vetëm kokoroshët e mëdhenj dhe, e cila, i vinte grenxë, puthitur pas torsit të tij hannonik, me pantallona të kapura me mbajtëse tek këmbët, me një kasketë të stilit prusian dhe me një mantel elegant kastori të modës nikollajevjane. Dhe përveç këtyreve, mjaft modest e simpatik i rrallë. Ida murmuriti emrin e njërës prej familjeve më të dëgjuara ruse, ndërsa ai hoqi me të shpejtë kasketën me duart e kredhura në manshon të bardhë dhe, në fundin e brendshëm të kasketës, shkëndriti muari i kuq; e kaloi atë në dorën tjetër delikate, të zbehtë në të kaltëreme, të munduar disi nga shtëmgimi i dorezës, përpoqi thembrnt dhe përkuli me nderim gjer në krahëror kokën e tij mesatare e të krehur bukur. "Ja se çfarë cope!" - mendoi edhe më i habitur heroi ynë, duke vështruar sërishmi si guak Idën - dhe saora e kuptoi nga vështrimi që ajo ia hodhi rishtazi studentit se, sigurisht, ajo ish mbretëresha, ndërsa ai, skllavi i saj, por, megjithatë, jo skllav dosido, po i tillë që e pranonte me kënaqësi të madhërishme skllavërinë, madje, me kreni. "Gëzohem shumë, shumë, që u njohëm! - tha me gjith shpin ky skllav dhe, me një buzëqeshje zemërgjerë e të hijshme drejtoi shtatin. - Jam admiruesi juaj, Ida më ka folur shumë për ju", - tha ai miqësisht, duke e vështruar në sy, madje, desh të hynte dhe më thëllë në kuvendim, që t'i jepte sqimë, porse papritur e ndërprenë: "Hesht Petrik, mos më shashtis" - i tha Ida me të ngutur dhe, duke iu kthyer zotërisë: "I dashur, u bënë njëmijë vjet që s'ju kam parë! Dëshiroj të bisedoj pambarimisht me ju, por në prani të tij nuk është aspak me vend. Atij nuk i interesojnë kujtimet tona, veçse do mërzitet dhe nga mërzia s'do të ndjehet mirë, prandaj ejani të kalojmë nga platforma. . . " Dhe me të thënë këto, i futi krahun udhëtarit tonë dhe e shpuri në platformë, përgjatë së cilës ecën pothuaj më shumë se një vjorstë, ku bora mbërrinte gjer në gjunjë dhe, papritur, i shprehu atje dashurinë zotërisë. . .

- Çfarë? dashurie? - pyetëm ne njëzëri.

Kompozitori në vend të përgjigjes mbushi sërishmi gjoksin me frynë, duke shfryrë e ngritur supet. Ai rrëzoi sytë përdhe dhe, duke u ngritur paksa kaba, nxorri nga legeni i argjendtë shishen mes kërkëllimës së copave të akullit dhe mbushi kupën më të madhe. Mollëzat e tij qenë skuqur, qafa e shkurtër gjithashtu. Duke u gërmuqur e duke gjakuar të mbulojë turbullimin, ai e piu kupën me fund, duke e zgjatur pirjen nën taktin e gramafonit: "Laisse moi, laisse contempler ton visage!" 4, porse sakaq, e ndërpreu dhe, duke ngritur i vendosur mbi ne sytë e tij edhe më të ngushtë, tha: - Po, pikërisht dashurinë. . . Dhe shfaqja e saj qe, për fat të keq, krejtësisht e vërtetë, krejt seriozisht. E marrë, e egër, e papritur, e pabesueshme? Po, sigurisht, porse, - fakt. Ndodhi mu ashtu siç ua përshkrova. Ndërsa po ecnin përgjatë platformës, ajo me të shpejtë nisi ta pyes me një gjallëri të shtirë për Mashën, si po ia çon ajo, si ia çojnë të njohurit e tjerë të përbashkët moskovitë, çfarë të rejash ka nga Moska e kështu me rradhë, pastaj i bëri të ditur që ajo është e martuar tash dy vjet, që në këtë kohë jeton me burrin në Petërburg, shpesh jashtë Rusie dhe shpesh në pronat e tyre afër Vitebskit. . . Zotëria ,mezi e ndiqte prara dhe tanimë parandjeu që diç nuk shkonte në terezi, që tanimë do të ngjiste ndonjë marrëzi, diç e pabesueshrne dhe, me sytë katër shihte në pirgjet lëbyrta të dëborës prej madhesish të pazakonta, të shpërndara kudo e gjithkund përreth nëpër platformë, udhët, çatitë e ndërtesave dhe vagonëve kuq e gjelbër të furur lëmsh në të gjitha udhëkryqet . . . vështronte dhe mee zemër lemerisht të ngrirë kuptonte vetëm një gjë: që gjatë gjithë këtyrë viteve, ai ashiqare, kishte dashur kafshërisht veçse një femër: Idën. Po a ua rrok truri, se ç'ngjau më pas? Më pas, në skajin më të largët të platformës, Ida iu avit ca arkave, shkundi prej tyre dëborën me doreza, hypi mbi to dhe, duke ngritur kundruall zotërist fytyrën e saj paksa të zbehtë, sytë e saj të manushaqtë, të beftë gjer në marrarnendje, i tha me një fryrmë: "Dhe tashi, i shtrenjtë, përgjigjuni dhe një pyetjeje: a e keni ditur vallë dhe, a e dini ende, që ju kam dashur tash pesë vjet me rradhë dhe se ju dashuroj edhe tani? Gramafoni që gjer në këtë kohë pati kuisur mbyturazi e papërcaktueshëm, gjëmoi me një ton heroik, triumfal dhe kanosës. Kompozitori heshti dhe na shtiu sytë disi të çuditur. Dhe pastaj shqiptoi pa e ngritur zërin: - Ja, pra se ç'farë i tha ajo. . . Dhe tani, më lejoni t'ju pyes: Si mund të shprehet gjithë kjo skenë me fjalët budallaqe të gjuhës njerëzore? Si mund t 'jua përshkruaj, përveçse me fjalë vu1gare, këtë fytyrë të ngritur, përndritur me zbehtësinë e asaj bore të veçantë, e cila rastis pas tufanit, apo brylltësinë dhe nuancat e papërsëritshrne të kësaj fytyre, gjithashtu të ngjashme me atë borë, përgjithësisht per fytyrën rinore të kësaj gruaje hirplote, e cila në lëvizje e sipër frymëmerr ajër të dëbortë dhe, befas, ju shpreh dashurinë e pritur prej kohësh, ndërsa pret prej jush përgjigje? Si thashë unë për sytë e saj? Të manushaqtë? Jo, tamam, sigurisht, jo tamam ashtu. Po buzët gjysmë të hapura? Po shprehja, shprehja e të gjitha këtyreve së bashku, d. m. th, fytyra, sytë, buzët? Po gëzofi i saj prej zibelini, në të cilin kridheshin e duart e saj? Po gjunjët, të cilët ravijëzoheshin pënën kuadratet blu-të gjelbër të një atofe skoceze? O perëndi, po a është vallë e mundur madje të ciket me fjalë e gjitha kjo! Dhe kryesoja, kryesorja: me çfarë mund t'i përgjigjeshe kësaj befasie trallisëse, tmerrit dhe lumturisë së pranimit, kësaj fytyre të ngritur në këtë çast të volitshëm gjithë mirëbesim, të zbehtë dhe të përndritur (nga trazimi, apo nga ndonjë buzëqeshje e ngjashme)?

Ne heshtnim, pa ditur gjithashtu ç'tu përgjigjeshim pyetjeve të tilla, duke parë të habitur sytë vetëtitës dhe fytyrën e përskuqur të mikut tonë. Dhe vetë ai iu përgjigj vetes: - Më asgjë, më asgjë, fare më asgjë! Ka çaste, kur asnjë lloj fjale nuk duhet nxjerrë. Dhe, për fatin dhe nderin e madh të udhëtarit tonë, ai nuk nxorri asnjë fjalë prej goje. Dhe ajo e kuptoi shtangimin e tij, ajo e vështroi fytyrën e tij. Pasi pritën edhe një copë herë, duke qëndruar palëvizur mes asaj heshtje sikletosëse, e cila pasoi pas pyetjes së saj të tmerrshme, ajo u nigrit dhe, duke xjerrë dorën e saj të butë nga manshoni i ngrohtë e i pushtë e përqafoi atë dhimbshëm e fort dhe e puthi me një nga ato të puthura, të cilat pastaj të kujtohen jo vetëm gjer në dërrasë të varrit, por edhe në varr. Po zotërinj, dhe kaq: e puthi dhe shkoi. Me kaq mbaron dhe historia. . . Dhe në përgjithësi, mjaft më me këtë, - tha me zë të lartë kompozitori, duke ndërruar befas ton, dhe me një hare fallse shtoi: -Hajdeni pra të pimë me këtë rast për kokëhumburit! Të pimë për të gjithë ato që na deshën, për gjithë ato, që ne, idiotët, nuk i çmuam, për gjithë ato me të cilat qemë të lumtur, të kënaqur dhe që pastaj u ndamë, të cilat i humbëm në jetë përgjithmonë dhe, me të cilat, prapëseprapë jemi të lidhur përjetësisht me lidhjen më të tmerrshme në botë! Dhe le të biem në ujdi: atij që do tu shtojë qoftë dhe një fjalë gjithave sa thamë më sipër, do t'ia vesh për kaplloqje, ja, me këtë shishe shampanje. - Kamarjer! -gjëmoi zëri i tij në tërë sallën. - Na sill supë peshku! Dhe heres, heres, një butë me heres, që të mund ta zhysë brenda tërë surratin tim me gjithë brirë!

Silla jonë atë ditë zgjati gjer në orën njëmbëdhjetë të natës. Kurse pastaj shkuam në Jar 5, dhe nga Jari në Strjelna 6, ku para agut, hëngrëm petulla, porositëm vodkën më të thjeshtë, me nga një kokërr të kuqe qepe dhe u sollëm në përgjithësi të rrebeluar: kënduam, u çorrëm dhe, madje, vallëzuam edhe kozakçe. Kompozitori kërcente heshturazi, egër dhe solemnisht, me një lehtësi të pazakontë për figurën e tij. Dhe u kthyem në shtëpi me trojkë, kur kish plasur agsholi, të skuqur për tmerr nga të ftohtët. Dhe kur kaluam ndanë Strastnoj Manstirit, u ngrit përmbi çatitë e akullta një diell i kuq dhe, kur nga kambanorja u shkëput tingulli i parë, nga një goditje e rëndë dhe madhështore si të donte të zgjonte gjithë Moskën e ngrirë, kompozitori bef hoqi shapkën dhe me sa kishte në kokë, piskati i përlotur tejendanë sheshit:

-O dielli im! O e dashura ime! Urra-aa!

Primorskie Alpi, 1925

(*Shënimet janë të përkthyesit*)

J -Balik -një lloj peshku i kuq, që krypet dhe thahet.

2 -*Je veux un tresor qui les contient tous, je veux la jeunesse* -(Fr) -Unë pëlqej thesarin, i cili nxë gjithçka në vetvete, unë pëlqej rininë.

3 -Shçuka -lloj peshku grabitqar e petashuq që jeton në thellësi të detrave: në shqip quhet raja.

4 - *Laisse moi, laisse moi contemler ton visage!* (Fr) - Lermë, lermë të ngopem duke ta parë fytyrën!

5 - Jar - emër restoranti.

6 -Strjelna -emër restorani.

Ivan A. Bunin

SMERALD

Përktheu nga origjinali: Agron Tufa

Bluja e errët e qiellit të natës në qetësinë pluskuese të reve, gjithkah të bardha, ndërsa përqark hënës – të kaltëreme. Përqëndrohesh dhe – as retë lëvizin – as hëna lundron, por bri saj, bashkë me të pikon loti i artë i një ylli: hëna lundron prajshëm lartësish të paskaja dhe e merr me vete gjith e më lart këtë yll.

Ajo shtrihet brinjazi në pezulin e çelur të dritares: me kryet anuar këqyr lart – koka i endet rrotull nga lëvizja e qiellit. Ai qëndron në gjunjët e saj.

- Çfarë ngjyre është kjo? Nuk mund ta përcaktoj dot! Po ju, Tolja, mundeni?

- Për çfarë ngjyre, Kisa?

- Mos më thërrisni më kështu, njëqind herë ju kam thënë. . .

- Si urdhëroni, Ksenia Andrejeva.

- E kam fjalën për këtë qiell ndërmjet resh. Çfarë ngjyre mahnitëse! Dhe e tmerrshme dhe magjepsëse. Me të vërtetë qiellore, se në tokë të tillë nuk ka. Thuajse smerald.

- Përderisa është në qiell, sigurisht që qiellore është. Vetëmse smerald ç'ne? Dhe ç'do të thotë smerald? Kurrë gjallë s'më kanë zënë sytë smerald. Juve, thjesht, ju pëlqen kjo fjalë.

- Po. Nuk di si të them, - ndofta nuk është smerald, por rubin. . . Porse vërtet i tillë, që vetëm në parajsë e gjen, engjëjt, fron perëndish. . .

- Dhe dardha majë plepit. . .

- Uf, sa cinik që je, Tolja. Mirë e ka Maria Sergejevna, kur thotë se edhe çupa më budallaqe është më e mirë se një djalë.

- Vetë e vërtetë gurgullon në buzët e saj, Kisa.

Ajo është veshur me një fustan pikëlor basmaje, këpucë fare të lira; pulpët dhe gjunjët e saj janë të plota, vajzërore, koka e saj e rrumbullt me një gërshet të hedhur prapa aq lezeçëm. . . Ai vë dorën mbi gjunjët e saj, tjetrën ia hedh përqafe dhe si me shaka e puth në buzët gjysmë të hapura. Ajo çlirohet ngadalë, ia largon dorën nga gjunjët.

- Ç'pate? U fyeve?

Ajo ngjesh zverkun pas shtalkës së dritares dhe ai, dallon se si ajo duke kafshuar buzën, përmban lotët.

- Po ç'keni pra kështu?

- Oh, lermëni të qetë. . .

- Por çfarë pra ndodhi?

Ajo pëshpërin:

- Asgjë. . .

Dhe teksa kërrcen nga parvazi, lëshohet me vrap.

Ai ngre supet:

- Budallaçkë gjer në shenjtëri!



PSIKIKA E RINGJALLUR NGA PUTHJA E KUPIDIT E ARTISTIT VENEDIKAS ANTONIO CANOVA

Dr. Bledar Kurti

Psikika e Ringjallur Nga Puthja e Kupidit, (1787-1793) e artistit venedikas Antonio Canova (1757 – 1822), është një ndër veprat skulpturore më elegante në historinë e artit. Edhe pse është e gdhendur në mermer, arrihet të ndjehet mishi, lëkura, pulsimi i trupave, e madje edhe fryma që lidh femrën e bukur e të përgjumur me Kupidin e dashuruar me krahë engjëllorë.

Psikika dhe Kupidi është një histori e cila e ka origjinën tek vepra *Metamorfoza,* e njohur edhe si *Gomari i Artë*, shkruar nga Lucius Apuleius në shekullin e 2-të pas Krishtit. Kjo është një histori mbi sprovat dhe vështirësitë e dashurisë midis Psikikës që do të thotë "Shpirt" or "Frymë Jete" dhe Kupidit që do të thotë "Pasion,""Dashuri," ose "Eros," dhe bashkimin e tyre në një martesë të shenjtëruar.

Në këtë histori, Psikika ishte një princeshë aq e bukur saqë njerëzit kishin filluar ta trajtonin atë porsi një perëndeshë, madje duke i dedikuar asaj edhe oferta dhe lëvdata. Venusi, perëndesha e dashurisë, u bë mjaft xheloze për bukurinë e Psikikës, kështu që e shtyrë nga xhelozia dhe inati ajo i kërkoi djalit të saj, Kupid, që ta shponte me shigjetë e ta bënte Psikikën të binte në dashuri me një njeri të shëmtuar. Megjithatë, përpara se Kupidi të qëllonte me shigjetën e tij, ai aksidentalisht gërvishti veten dhe ra menjëherë në dashuri me Psikikën.

Ndërkohë, Psikika mbetej aq e bukur, sa që meshkujt kishin frikë të kërkonin dorën e saj. Prindërit e saj u shqetësuan dhe kërkuan ndihmën e zotit Apollo i cili u kërkoi prindërve të Psikikës që ta linin atë mbi një shkëmb. Aty Psikika u morr dhe u transportua në një pyll ku e kaloi kohën me një admirues të fshehtë i cili e vizitonte atë vetëm natën, por të cilin ajo nuk lejohej ta shihte. Pas një farë kohe, e shtyrë nga kureshtja, Psikika arriti ta shihte të dashurin e saj dhe kuptoi se ai ishte Kupidi, i cili menjëherë u largua dhe u kthye në botën e perëndive.

E dëshpëruar, Psikika u përpoq të bindte Venusin që ta ndihmonte atë të fitonte sërish Kupidin. Venusi pranoi por i dha Psikikës të kryente një seri detyrash e sprovash. Një prej tyre ishte se Psikika duhej të shkonte në Botën e Nëndheshme (Hades) nga ku duhet të sillte një qyp të mbushur me bukurinë hyjnore. E shtyrë nga dashuria e madhe për Kubidin, Psikika zbriti në botën e Nëndheshme dhe e mori qypin, por u udhëzua nga Venusi që të mos shikonte brenda enës. E shtyrë nga kureshtja, Psikika pa brenda duke shpresuar që të merrte një pjesë të asaj bukurie hyjnore për vete. Megjithatë, në vend të bukurisë, ena përmbante "gjumin e errësirës së thellë". Sapo u hap kapaku, tymi i errësirës së thellë u shpërnda menjëherë tek fytyra e Psikikës, ndaj ajo ra pa ndjenja dhe e zuri një gjumë i thellë porsi vdekje. Kupidi erdhi për ta shpëtuar dhe e zgjoi atë me një puthje.

Pasi Psikika kaloi me sukses të gjitha sprovat e Venusit, ajo u lejua të martohej me Kupidin dhe u shndërrua në një perëndeshë. Dhe ata lindën një fëmijë emri i të cilit ishte Kënaqësia. Dhe në këtë vepër, ne arrijmë të ndiejmë dashurinë e Kubidit, frymën e jetës së Psikikës, duke bërë të lindë brenda nesh një lloj kënaqësie e pa përshkruar e cila të ysht e të fton të bëhesh dëshmitar i atij momenti të zgjimit dashuror.

Kjo vepër është tejet sensuale dhe pasionante. Trupat janë të zhveshur por nuk janë ndjellës. Përkundrazi, dallohet një fisnikëri dashurie në përqafimin e tyre. Me njërën dorë Kupidi mban butësisht fytyrën e Psikikës ndërsa me tjetrën prek gjoksin e saj, por më shumë si shenjë përqafimi sesa ledhatimi. Psikika ka ngritur kokën lart për nga i dashuri i saj dhe me të dyja duart ka mbështjellë kokën e tij duke i kërkuar ta puthë përsëri. Kubidi ia ka ngulur vështrimin plot ëmbëlsi, i lumtur që ajo po zgjohet në krahët e tij prej gjumit të vdektë. Aq e ëmbël është kjo skenë sa që dashuria nis e merr një kuptim tjetër edhe për shikuesin. Një perëndi që dashurohet me një femër njerëzore, e cila zgjedh të shkojë edhe në botën e nëndheshme vetëm për t'u bashkuar me dashurinë e saj. Dy krahët engjëllorë të Kubidit janë të pozicionuara lart e shpalosen me forcë duke treguar epërsi dhe vetëkontroll, e duke e theksuar më shumë dorëzimin e butë të trupit të Psikikës.

Vepra nuk ka një kënd të caktuar vështrimi. Ajo mund të shihet përballë, në të majtë, në të djathtë, e madje edhe nga pas. Ajo është krijuar për të qëndruar në qendër të një dhome dhe shikuesit mund të vërtiten rreth saj për të shijuar çdo fragment e çdo element. Pas këmbëve të Psikikës, gjendet ena që ajo solli nga bota e nëndheshme, ndërsa Kubidi ka hedhur pas krahëve trastën me shigjeta. Canova e ka ndarë veprën në katër materie: trupat mishor; rroba që mbulon belin e Psikikës e cila gjarpëron nga pamja e përparme dhe shtrihet edhe pas trupave; krahët e Kubidit; dhe shkëmbi i vrazhdë i palëmuar. Të katër elementët janë në shërbim të kompozimit, por edhe theksojnë më shumë butësinë dhe brishtësinë e trupave të zhveshur të cilët janë të trajtuar me një delikatesë të jashtëzakonshme.

Canova e merrte frymëzim nga skulpturat e lashta të antikitetit, megjithatë ai gjithmonë krijonte një version të ri në veprat e tij. Në një letër të vitit 1806 për mikun e tij Quatremère de Quincy, Canova shkroi: "Artisti përpiqet ditë e natë të ndjekë shembullin grek duke u përpjekur të kuptojë stilin e tyre. Por, artisti duhet të shtojë natyrën e tij, e të ofrojë nga vetja e tij . . . "

Kjo është një vepër neoklasike. Canova arriti të rikthente finesën dhe elegancën klasike edhe në shekullin e 18-të dhe 19-të. Stili neoklasik i kësaj vepre shpaloset në një moment të mbushur me emocion të fortë. Kjo ishte karakteristikë e lëvizjes romantike e cila kishte nisur të përhapej në të gjitha artet dhe fushat krijuese. Emocioni që shpalos vepra, kompozimi i shtrirë gjerësisht i balancuar me ngritjen



e fortë vertikale të krahëve të Kupidit, me trajtimin e mrekullueshëm të lëkurës së butë e të shndritshme të trupave të zhveshur, e bëjnë këtë vepër ndër më të magjishmet në historinë e skulpturës dhe artit botëror.

Skulptura mund të shihet nga të gjitha anët, megjithatë ajo e ka një pikë qendrore referimi: hapësira midis buzëve të Kubidit dhe Psikikës. Canova e ka organizuar kompozimin bazuar mbi një ndërthurje komplekse të formave gjeometrike, të cilat i shërbejnë pikës qendrore. Canova dëshironte që të gjitha shqisat tona të drejtoheshin tek fryma midis buzëve, tek puthja e rikthimit të jetës e cila është e tërthortë në formë X. Të dy trupat janë në mënyrë të tërthortë duke e bërë të gjithë veprën të marrë formën e piramidës.

Vepra u porosit nga Kolonel John Campbell, një politikan britanik dhe koleksionist arti, në vitin 1787. Ekzistojnë dy kopje të kësaj vepre, njëra në muzeun e Luvrit në Paris, dhe tjetra në muzeun e Hermitazhit në Shën Petersburg në Rusi. Canova ishte shumë i njohur në kohën e tij dhe krijoi vepra si për Vatikanin ashtu edhe për Napoleon-in, të cilin plot admirim e krijoi të zhveshur e vetëm me një rrobë romake mbi sup. Ai gjithashtu kreu porosi edhe për Mbretin e Anglisë, dhe aristokratë të rëndësishëm të Evropës, sikurse krijoi edhe monumente të figurave të rëndësishme të botës siç ishte ajo e presidentit amerikan George Washington, i cili shpalosej i veshur me një parzmore romake, vepër e cila fatkeqësisht u dogj në vitin 1830. Një nga veprat e tij më të famshme të personazheve të shquara të kohës është ai i motrës së Napoleonit, Pauline Borghese, e cila është e mbështetur pothuajse lakuriq në një shtrat me pozën e *Venus Victrix* (Venusi Fitimtar) një bashkim i perëndeshës klasike dhe portretit bashkëkohor të Pauline-s.

Statujat dhe reliefët monumentale të Canova-s janë plot hir, ngrohtësi dhe pastërti të kontureve. Talenti i tij artistik ishte i padiskutueshëm. Por, Canova shërbeu edhe si diplomat. Pas disfatës së Napoleon-it në Waterloo, krerët e vendeve evropiane u takuan në Paris për të zgjidhur rrëmujën që Napoleon-i kishte lënë pas. Papa Pius VII dërgoi Canova-n në Paris për të ndihmuar në rimarrjen e thesareve të artit të rrëmbyera nga francezët në vitin 1797. Falë këmbënguljes së Papës dhe të ambasadorit të tij të posaçëm, Antonio Canova, në takimin e tyre, krerët e shteteve evropiane u detyruan të diskutonin se çfarë duhej bërë me veprat e shumta artistike që kishte vjedhur perandori Napoleon nga vendet e tjera gjatë pushtimit. Canova provoi se ishte një diplomat simpatik, por tejet i vendosur dhe frymëzues. Për inat të francezëve dhe me ndihmën e anglezëve, pothuajse të gjitha veprat e artit u kthyen atje ku e kishin vendin. Për punën e tij të shkëlqyer diplomatike Papa i dha artistit titullin Markez i Ischia, si edhe një pension vjetor prej 3,000 scudi, të cilat artisti ia dhuroi disa akademive të artit.

"Sublime," "e shkëlqyer" dhe "e mrekullueshme" ishin fjalët më të përdorura për veprat e Canova-s në kohën e tij. Skulpturat e tij janë plot hijeshi dhe trupat e mermertë kanë një ngrohtësi të pashoqë. Canova iu referua skulpturave klasike me misionin për t'i përmirësuar ato, e madje duke i bërë ato më heroike, dhe në rastin e veprës *Psikika e Ringjallur Nga Puthja e Kubidit*, më romantike dhe sensuale. Por, ai nuk kënaqej vetëm me finesën e jashtme, ai synonte të shpaloste edhe bukurinë e brendshme, dhe të transmetonte emocione të thella tek shikuesi.

Emocionet e thella që na transmetojnë Psikika dhe Kupidi janë aq magnetike saqë edhe ne përfshihemi plotësisht në atë skenë. Përqafimi i tyre është një moment i ngrirë i gdhendur në mermer por shikuesi ndien një përndezje emocionale prej frymës rigjallëruese që shkëmbehet përmes buzëve të dy të dashuruarve.

Përmes të gjithë veprave të tij Canova shpalos vlerat plot hijeshi të artit. Në fakt, arti flet atëherë kur fjalët e kanë të pamundur të japin shpjegim. Kjo vepër nuk ka nevojë të përshkruhet me shumë fjalë. Ajo është krijuar të komunikojë me zemrën e shikuesit, dhe nuk ka patur asnjë zemër që ka qëndruar përpara kësaj vepre pa u prekur dhe pa u transformuar.

VIRION GRAÇI

të çmendur „ë parajsë

OnufriRoman